

NJOHURI ISLAME

PËR TË RINJTË MYSLIMANË



NJOHURI ISLAME

për të rinjtë myslimanë

- Libri 1 -



Titulli i librit
“Njohuri Islame për të Rinjtë Myslimanë”

Përktheu
Teuta XEKA

Kontrolloi
Abdullah NABOLLI

Redaktimi gjuhësor
Sara FAHEM

Ballina & Faqosja
Pelegrini



Boton: “Udha e Besimtarëve”

Botimi i parë
Tiranë, 2020



Parathënie

Lëvdatat i takojnë Allahut! Paqe e përshëndetje çojmë mbi prijësin e profetëve, mbi familjen dhe mbi gjithë shokët e tij!

Në vijim:

I dashur djalosh mysliman!

Ky libër përmbledh një seri broshurash edukative nëpërmjet së cilës do të njihesh me Islamin, fenë tënde në të cilën ke lindur dhe nën rregullat e së cilës je rritur. Nëpërmjet tyre do të mësosh gjërat më të rëndësishme që t'i ka bërë detyrë krijuesi yt i madh, Allahu, dhe do të njihesh gjithashtu me historinë dhe traditën e profetit tënd të shtrenjtë, Muhamedit, dhe çdo gjë që ka lidhje me to: besime, marrëdhënie, adhurime dhe morale.

Vlera e kësaj serie qëndron te bashkimi i saj mes cilësisë së njohurive dhe thjeshtësisë së stilit në shkrim, çka të bën ta kuptosh mirë atë pa pasur nevojë të kërkosh ndihmën e familjes, apo të afërmeve, veçse në ndonjë rast të rrallë.

Së fundi:

Lus Allahun e Madhëruar që të bëjë dobi me të, sepse Ai është dëgjuesi i lutjeve dhe Ai që u përgjigjet atyre.

Autori





Besimi në Allahun e Lartmadhëruar

Dije se njohja e Allahut të Madhëruar, besimi i Tij, adhurimi i Tij dhe besimi i asaj që ka ardhur prej Tij, janë gjërat më të rëndësishme të cilat myslimani i ka detyrë t'i mësojë, t'i njohë dhe t'i kuptojë.

Ndërsa ai i cili nuk e njeh Allahun: krijuesin, poseduesin dhe kujdestarin e tij, ai jeton në jetën e kësaj bote si kafsha: ha, pi, fle, zgjohet e kështu me radhë, derisa i përfundon jeta duke mos e ditur se pse u krijua e si jetoi.

Allahu i madhëruar në Kuranin famëlartë thotë:

“Ata që mohojnë dhe kënaqen e hanë siç hanë kafshët, do të kenë zjarrin për vendstrehim.”¹

Ata kështu shkatërrojnë dhe dëmtojnë në tokë me punët dhe veprimet e tyre, sepse ata nuk i njohin punët e mira, nuk i dinë punët e këqija, nuk e dinë çfarë e zemëron Allahun dhe nuk mund ta imagjinojnë se çfarë e kënaq Atë.



Kështu, askush nuk mundet të njohë rrugët e së mirës për ndonjë veprim vetëm se me udhëzimin e atij që është më i njohur se ai. Si mundet njeriu në këtë botë ta luaj rolin e kërkuar prej tij pa zbatuar

¹ Suretu Muhamed: 12.

urdhrat e Allahut të madhëruar dhe obligimet e tij kur Ai është krijuesi i njeriut dhe krijuesi i kësaj bote? Siç thotë Allahu në Kuran:

“E si të mos dijë Ai që krijon, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!”²



Pra, ai që nuk e njeh Allahun, Krijuesin e tij do të sillet keq dhe do të shkatërrojë me veprimet e tij për shkak se nuk ka njohur udhëzuesin për në rrugën e drejtë, rrugën e fitores dhe të shpëtimit dhe Ai është Allahu i madhëruar dhe i lartësuar.

Nuk janë sëmundjet e përhapura sot në botë dhe as shthurja e madhe që gjendet mes njerëzve vetëm se për shkak të largimit nga udhëzimet e Krijuesit të krijesave dhe të distancimit nga zbatimet e urdhrave të Tij.



Pastaj mbaron jeta e atyre që nuk e njohin Zotin, Krijuesin e tyre në një kohë kur as nuk e kanë ditur se pse ka filluar!! Dalin prej saj duke mos e ditur se pse kanë ardhur në të!!



Kurse kush e njeh Allahun e madhëruar, e beson Atë dhe beson atë që ka ardhur prej tij, atë do ta ndihmojë Allahu i madhëruar.

Allahu i madhëruar në Kuranin famëlartë thotë:

“Vërtet, Allahu do ta ndihmojë këdo që e ndihmon Atë.”³



Njeriu, kjo krijesë me gjymtyrë si: dora, këmba, koka etj. duhet të dijë detyrat e kërkuara prej tij që t'i aktivizojë këto gjymtyrë (në punë të mira), gjë e cila nuk realizohet vetëm se me njohjen e urdhrave dhe obligimeve me të cilat Allahu i madhëruar e ka ngarkuar atë.

Çdo njeri ka logjikë dhe funksioni i logjikës është të menduarit. Nëse

² Suretu el-Mulk: 14.

³ Suretu El-Haxh: 40.

pushon së punuari ky funksion, prishet veprimtaria më e rëndësishme e logjikës dhe për rrjedhojë shkakton largimin nga e mira dhe afrimin nga e keqja.



Allahu i lartësuar, Krijuesi ynë na ka ftuar në Kuranin famëlartë që të mendojmë në gjendjen tonë dhe ka thënë:

“Thuaj, a barazohet i verbri me atë që shikon?! Si nuk mendoni?!”⁴

Gjithashtu ka thënë:

“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete?”⁵

Allahu i lartësuar përderisa i ka ftuar njerëzit tek të menduarit do të thotë se kjo aftësi është në mundësinë e logjikës.

Ai na ka ftuar të vështrojmë se çfarë ka krijuar në qiell e në tokë, në vetet tona e në gjithë njerëzimin. Na ka ftuar të vështrojmë te kjo botë e gjerë e cila është e gjitha krijim dhe shpikje e Allahut të lartësuar.



Nëse njeriu mendon dhe vështron, do të arrijë në përfundimin e prerë se kjo gjithësi e gjerë, e madhe dhe e pafund ka një krijues të plotfuqishëm dhe një shpikës bujar dhe Ai është Allahu, Zoti ynë i lartmadhëruar:

Krijuesi i njeriut, bimëve dhe kafshëve.

Krijuesi i qiejve i tokës dhe deteve.

Krijuesi i çdo gjëje që shohim në këtë botë të madhe.



Allahu i lartmadhëruar është përshkruar me cilësi të larta. Ai me to e ka përshkruar veten në Kuranin famëlartë dhe me to e ka përshkruar krijesa më e ditur e Tij, i cili është i fundit i të dërguarve dhe i nderuari ynë, Muhamedit -alejhi selam-.

⁴ Suretu Fatir: 19.

⁵ Suretu Err-Rrum: 8.

Prej këtyre cilësive janë:

- mëshira,
- krenaria,
- falja,
- ngadhënjimi.

E shumë të tjera që kanë ardhur në Kuranin famëlartë, apo në hadithet e profetit -alejhi selam-.

Synimi themelor i njohjes me këto cilësi është të mësojmë për madhësinë e Allahut të lartësuar dhe fuqinë e Tij. T'ia bëjmë të ditur veteve dobësinë tonë dhe nevojën tonë për këtë Zot të plotfuqishëm, i lartësuar qoftë.



Zoti ynë i lartësuar na e ka qartësuar qëllimin e krijimit të të gjitha krijesave dhe shkakun e shpikjes së jetës së dynjasë me gjithë çfarë përmban ajo.

Allahu i lartësuar thotë:

“Nuk i kam krijuar njerëzit dhe xhindët vetëm se për të më adhuruar.”⁶



Pra, adhurimi është qëllimi që na duhet të arrijmë siç kërkohet, si bindje ndaj Allahut të lartësuar dhe si falënderim për të mirat e shumta dhe dobite e panumërta që na ka dhuruar.

Allahu i lartësuar thotë:

“Nëse i numëroni të mirat e Allahut, nuk do t'i përfshinit.”⁷



⁶ Suretu Edh-Dharijat: 56.

⁷ Suretu En-Nahl: 18.

Nëse e kuptuam atë që shpjeguam, atëherë na duhet ta adhurojmë Allahun e lartësuar më adhurim të saktë dhe të jetë ky adhurim për Allahun e vetëm e të pashoq:

T’i lutemi Atij.

Të kemi frikë prej Tij.

T’i kërkojmë ndihmë Atij.

E kështu me radhë të gjitha adhurimet të mos jenë vetëm se për këtë Zot të madh, krijues, furnizues, i plotfuqishëm, krenar dhe i përshkruar me të gjitha cilësitë e larta e të plota.





Profeti Muhamed -alejhi selam-

Që Allahu të na informojë me atë që do prej nesh dhe të na qartësojë se çfarë na bën dobi në jetën tonë, ka dërguar disa njerëz, të cilët kanë cilësi të larta dhe morale të lavdëruara që t'u përcjellin urdhrat dhe gjykimet e Tij njerëzve të tjerë prej të afërmve, shokëve, fqinjëve dhe gjithkënd që i rrethon.

Këta, të cilët i zgjodhi Allahu i lartësuar, i ka quajtur të dërguar dhe pejgamberë.

I fundit i këtyre të dërguarve dhe pejgamberëve është i dërguari i Allahut te krijesat e tij dhe i nderuari ynë Muhamedi -alejhi selam-, të cilin Allahu i madhëruar e dërgoi si mëshirë për botën e njerëzve e të xhindëve.

Kështu, dërgesa e profetit tonë nuk është vetëm për njerëzit dhe popullin e tij, por është për të gjithë njerëzit që t'i përgëzojë dhe t'i përkujtojë.

Allahu i lartësuar thotë:

“Nuk të kemi dërguar ty, veçse mëshirë për të gjitha botët.”⁸



⁸ Suretu El-Enbija: 107.

Që të jemi sa më të sigurt në këtë çështje duhet të dimë patjetër diçka nga jeta e këtij të dërguari fisnik -alejhi selam-.

Emri i tij është: Muhamed, i biri i Abdulmutalibit, i biri i Hashimit, origjina e të cilit është nga një fis i madh prej fiseve arabe, fisi Kurejsh.

Ai lindi në Mekë, e cila bie në gadishullin Arabik dhe është një nga qytetet e Mbretërisë së Arabisë Saudite në kohën e sotme.

U rrit jetim për shkak se i vdiq i ati që kur ishte në barkun e nënës. Atë e rriti e ëma Emineja e bija e Uehbit, e cila u mirëkujdes ta edukonte sipas zakoneve origjinale të arabëve, të cilat shumë prej tyre i kishin trashëguar nga feja e babait të pejgamberëve Ibrahimit -alejhi selam-.

Pastaj i vdiq e ëma në moshën gjashtë vjeçare dhe atëherë për atë u kujdes dhe e edukoi gjyshi i tij Abdulmutalibi, i cili ishte nga paria kurejshite para islamit. Pas dy vjetësh i vdiq edhe gjyshi dhe për atë u kujdes xhaxhai i tij Ebu Talibi.



Ai që në fëmijëri u dallua për çdo cilësi të mirë. Ishte guximtar, thoshte të vërtetën, kishte moral të lartë sa edhe njerëzit e quajtën me llagapin “i Vërteti dhe Besniku”.



Në fëmijëri, ai ruajti bagëtitë, gjë që ia shtoi pastërtinë e zemrës, orientimin për tek e mira dhe largimin nga e keqja.

Në rini, ai punoi me Hadixhen të bijën e Huejlidit, njëra nga gratë kurejshe, e cila ishte e pasur. Ajo e dërgoi atë për tregti në Sham dhe ai u kthye me fitime të mëdha.

Kur arriti moshën njëzetepesëvjeçare, xhaxhai i tij e martoi me Hadixhen, e cila ishte pesëmbëdhjetë vjet më e madhe se ai.



Në moshën dyzetvjeçare Allahu i lartësuar e përgatiti atë për dërgesën dhe kjo nëpërmjet ëndrrave të vërteta në gjumë. Nuk shihte ndonjë ëndërr gjatë natës, vetëm se i vërtetohej në mëngjes.

Pastaj Allahu i lartësuar ia bëri të dashur qëndrimin vetëm për të menduar dhe medituar. Në çdo vit kalonte një muaj të plotë në një shpellë në afërsi të Mekës, emri i së cilës është Hira.



Pas një farë kohe jo shumë të gjatë, Allahu i lartësuar i dërgoi atij një engjëll të madh prej engjëjve të Tij, i cili quhet Xhibril dhe i përcolli ajetin e parë nga Kurani famëlartë:

“Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi!”⁹

Kështu, ai nga të gjitha këto kuptoi se Allahu i madhëruar e kishte zgjedhur për të qenë i dërguari i këtij ymeti dhe pejgamber i Zotit të tyre për ta.



Pastaj, profeti -alejhi selam-, filloi t’i thërrasë njerëzit përreth tij në këtë fe të re. Kjo thirrje ishte fshehurazi për t’u ruajtur prej mohuesve, të cilët adhuronin idhujt dhe gurët.

Të parët që iu përgjigjën atij ishin: bashkëshortja e tij Hadixhja, i biri i xhaxhait të tij Ali bin Ebi Talibi, shoku i tij besnik Ebu Bekri dhe një grup i vogël nga populli.



Pastaj Allahu i lartësuar e urdhëroi atë të deklaronte hapur thirrjen për në Islam, fenë e Allahut të lartësuar, të cilën e zgjodhi të jetë feja e fundit.

Allahu i madhëruar thotë:

“Feja (*e pranuar*) tek Allahu është Islami.”¹⁰

Ai gjithashtu thotë:

“Kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do jetë prej të humburve.”¹¹

⁹ Suretu El-Alak:1

¹⁰ Suretu Ali Imran: 19.

¹¹ Suretu Ali Imran: 85.

Kjo fe ishte ndryshe nga ç'ishin zakonet e baballarëve dhe të gjyshërve të tij. Ai thirri në adhurimin e vetëm të Allahut dhe në thyerjen e idhujve e copëtimin e tyre. Atëherë kurejshët e përqeshën atë dhe e munduan, por ai duroi shumë.

Atë e mbrojti nga mundimet e kurejshëve dhe sprovat e tyre xhaxhai i tij Ebu Talibi. Ai ia largoi atij të këqijat e tyre edhe pse vetë Ebu Talibi nuk e pranoi Islamin dhe vdiq jobesimtar.



Islami filloi të përhapej me shpejtësi dhe atë e besuan edhe disa prej banorëve të “Jethribit”¹², të cilët u kthyen atje me këtë fe. Më pas prej Jethribit i erdhën dymbëdhjetë burra të cilët besuan dhe ai dërgoi me ta disa nga shokët e tij për t’iu mësuar atyre gjykimet e islamit dhe ligjet e Kuranit. Pas një periudhe të shkurtër u përhap Islami në “Jethrib” dhe profetit i erdhën prej atje një grup njerëzish nga banorët e saj. Ata e ftuan atë dhe shokët e tij për të emigruar tek ata duke i premtuar atij mbrojtje dhe përkrahje.



Profeti -alejhi selam- iu përgjigj ftesës së banorëve të “Jethribit” dhe i urdhëroi shokët e tij për të dalë nga Meka, pastaj u nis edhe vetë drejt tyre. Kur kurejshët e morën vesh lajmin e emigrimit, dërguan njerëz për ta vlarë, por Allahu i madhëruar e shpëtoi prej tyre.

Kur hyri në “Jethrib”, i cili më pas u quajt “Medina e Ndritur”, atë e pritën banorët e saj dhe ai ndërtoi aty xhaminë e tij të njohur si “Xhamia Profetike” ku deklaroi thirrjen për përhapjen e Islamit.

Kurejshët u përpoqën shumë ta pengonin përhapjen e thirrjes së tij duke përdorur forcën për këtë qëllim, por Allahu i lartmadhëruar e ndihmonte kundër tyre.



Beteja e parë mes tij dhe kurejshëve ishte në Bedër, (vend pranë Medines) ku Allahu i dha një fitore të madhe kundër tyre.

¹² Emër i vjetër i qytetit të Medinës.

Betejat e profetit -alejhi selam- dhe luftërat me jobesimtarët filluan të shtohen me fuqizimin e Islamit dhe ndodhën: beteja e Uhudit, beteja e Hendekut, beteja e Hunejnit etj.



Në përpjekje të përhapjes së Islamit, profeti -alejhi selam- dërgoi ftesa te Kisra, Çezari, Nexhashi e mbretër të tjerë të mëdhenj për t'i ftuar në Islam.



Në vitin e tetë të hixhretit, myslimanët çliruan Mekën, e cila ishte fillimi i mesazhit islam, por që banorët e saj e luftuan të dërguarin e Islamit dhe ia kufizuan shumë veprimtarinë, dhe ajo në atë kohë ishte nga vendet më të mëdha të grumbullimeve të idhujtarëve dhe jobesimtarëve prej kurejshëve dhe të tjerëve.

Pas çlirimit të Mekës erdhën delegacione arabe te profeti -alejhi selam- në Medine dhe njerëzit hynë grupe-grupe në fenë e Allahut.

Allahu i madhëruar thotë:

“Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi. Dhe të shohësh njerëzit të hyjnë grupe-grupe në fenë e Allahut. Madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërkoji falje se Ai është pranues i faljes.”¹³



Në vitin e dhjetë, Profeti -alejli selam- kreu haxhin e lamtumirës dhe dha një ligjëratë të famshme, e cila konsiderohet nga ligjëratat më të gjata të tij dhe më gjithëpërfshirësja për çështjet e fesë, për gjykimet dhe ligjet e saj.



Më dymbëdhjetë të muajit Rabi el-Euel të vitit të njëmbëdhjetë të hixhretit, Profeti -alejhi selam- vdiq nga një sëmundje që e preku dhe u varros në shtëpinë e tij, e cila sot është te pjesa e zgjeruar e xhamisë së nderuar profetike.

¹³ Suretu En-Nasr: 1-3.



Nga jeta e tij: fjalë dhe vepra, dije dhe punë, na ka mbërritur Islami, feja e Allahut të lartësuar.

Duke iu bindur atij arrihet udhëzimi, fitimi dhe shpëtimi, siç thotë Allahu i lartësuar:

“Nëse i bindeni atij, udhëzoheni.”¹⁴



¹⁴ Seretu En-Nur: 54.



Islami

Kur Allahu i lartësuar e zgjodhi profetin e tij Muhamedin -alejhi selam- për të qenë vula e profetëve, atëherë feja e tij, Islami, të cilën ia dha Allahu u bë vula e feve.

Kështu, kjo fe përfshiu:
udhëzimin,
kthjelltësinë,
mirësinë,
shpëtimin.

Allahu i madhëruar thotë:

“Feja e pranuar tek Allahu është Islami.”¹⁵

Dhe gjithashtu thotë:

“Kush kërkon fe tjetër veç Islamit, nuk do ti pranohet dhe ai në botën tjetër do jetë prej të humburve.”¹⁶



Fjala “fe” do të thotë “metodë dhe orientim”.

¹⁵ Suretu Ali Imran: 19.

¹⁶ Suretu Ali Imran: 85.

Allahu i lartësuar thotë:

“Ai (*Allahu*) dërgoi profetin me udhëzim dhe fe të vërtetë që të mbizotërojë mbi të gjitha fetë, edhe nëse e urrejnë idhujtarët.”¹⁷

Pra, feja është metoda e jetës njerëzore dhe orientimi i tyre ideologjik.



Zoti ynë i lartësuar është krijuesi ynë dhe njohësi i realitetit tonë.

Ai thotë:

“(Allahu) Di çdo gjë që ka ndodhur përpara njerëzve dhe çdo gjë që do të ndodhë pas tyre, kurse ata nuk përvetësojnë asgjë nga dija e Tij, përveçse atë që Ai dëshiron.”¹⁸

Atëherë Krijuesi i lartësuar është më i dituri për çfarë na rregullon neve dhe çfarë na bën dobi dhe më i dituri për çfarë na bën dëm neve dhe çfarë na mjeron.



Pra, feja jonë Islami është feja, e cila ka përfshirë qëllimin e përgjithshëm të kësaj jete dhe është feja, e cila përmban nderimin e njeriut dhe vendosjen e tij në një pozitë të lartë e të madhe.

Allahu i lartësuar thotë:

“Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit.”¹⁹

Dhe gjithashtu thotë:

“Ne e kemi krijuar njeriun në formën më të përkryer.”²⁰

Njeriu në këtë tokë, në jetën e kësaj bote, e zhvillon tokën, e ndërton atë dhe administron ato që Allahu ka krijuar në të.

Ai gjatë jetës së tij kalon një periudhë provash për t’u ditur përfshirja

¹⁷ Suretu Et-Teube: 33.

¹⁸ Suretu El-Bekara: 255.

¹⁹ Suretu El-Isra: 70.

²⁰ Suretu Et-Tijn: 4.

e tij në bindjen ndaj Zotit dhe zbatimin e urdhrave të Tij.

Allahu i lartësuar thotë:

“Ne, çdo gjë që gjendet në Tokë, e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre (*njerëzve*) punon më mirë.”²¹



Jeta që jetojmë mbi këtë tokë është vendbanimi ku kryejmë punët që na i ka obliguar Allahu dhe ndalemi nga punët që na i ka ndaluar Allahu i lartësuar.

Pas mbarimit të jetës mbi këtë tokë, ka një jetë tjetër: ose në xhenet, ose në zjarr. Ai, i cili i është përgjigjur urdhrave të Allahut, i është bindur Atij dhe është ndaluar nga ajo që ia ka ndaluar Allahu, është prej banorëve të Xhenetit.

Ndërsa ai, i cili ka kundërshtuar urdhrat e Allahut dhe nuk i është dorëzuar bindjes dhe gjykimeve të Tij, është prej banorëve të Zjarrit.



Feja jonë islame ka përfshirë çdo aspekt të jetës. Ajo nuk ka lënë pas jetën e dynjasë, përkundrazi ia ka dhënë asaj të plotë pjesën që i takon dhe ka dhënë gjykime në dobi të kësaj bote e në dobi të banorëve të saj.

Allahu i madhëruar thotë:

“Kërko me ç’të ka dhënë Allahu të fitosh shtëpinë e Ahiretit dhe mos harro pjesën tënde nga kjo botë! Bëj mirë siç të ka bërë mirë Allahu ty dhe mos kërko të shkatërrosh se Allahu nuk i do shkatërrimtarët.”²²



Feja jonë e madhe islame ka karakteristika dhe veçori, të cilat kanë bërë që shumë prej mohuesve dhe idhujtarëve ta pranojnë atë dhe t’i përmbahen gjykimeve të saj, sepse ajo është feja e drejtë.

²¹ Suratu El-Kehf: 7.

²² Suretu El-Kasas: 77.

Allahu i lartësuar thotë:

“(Allahu) **Ka urdhëruar që të mos adhuronit tjetër veç Tij. Kjo është feja e drejtë.**”²³

Ajo gjithashtu është feja e jetës së lartë njerëzore. Sa janë lumturuar me atë njerëzit përgjatë viteve e shekujve dhe sa kanë vuajtur të tjerët nga kundërshtimi dhe lënia e urdhrave dhe gjykimeve të saj.

Myslimanët kanë qenë kombi më i ngritur dhe popujt më krenarë dhe më të lumtur sipas kapjes së tyre pas fesë.



Islam do të thotë dorëzim dhe myslimani është i dorëzuar i urdhrave të Islamit dhe zbatuesi i gjykimeve të tij.



Allahu i ka nderuar krijesat e tij me këtë Islam, e cila është feja e plotë dhe metodologjia gjithëpërfshirëse. Nuk mundet njeri sado që t'i jetë dhënë prej dijes dhe njohurive të gjejë në Islamin e madh mangësi, sepse atë e ka përsosur Allahu i lartësuar, siç ka thënë në Kuranin famëlartë:

“**Sot e përsosa për ju fenë tuaj, jua plotësova të gjitha mirësitë dhe desha për ju Islamin si fe.**”²⁴

Lëvdatat i takojnë Allahut për mirësinë e Islamit.



²³ Suretu Jusuf: 40.

²⁴ Suretu El-Maide: 3.



Adhurimi

Pasi ta mësojmë se nuk jemi gjendur kot në këtë botë dhe se Allahu i lartmadhëruar është Krijuesi ynë i madh dhe se ai dërgoi profetin e tij Muhamedin -alejhi selam- tek të gjitha krijesat për t'i thirrur në fenë islame, do ta kuptojmë se e kemi detyrë ta adhurojmë këtë Zot të madh me atë adhurim që ai e pëlqen prej nesh që të fitojmë Xhenetin dhe të largohemi nga Zjarri.



Pra, adhurimi është dorëzimi para urdhrave të Allahut: kryerja e atyre që na ka bërë obligim Allahu dhe ndalimi nga ato që na ka ndaluar prej tyre.

Nga llojet e adhurimeve të obliguara janë: namazi, agjërimi, respektimi i prindërve dhe mirësjellja me njerëzit.

Ndërsa nga të ndaluarat janë veprimet e shëmtuara e të këqija si: sharja, zemërimi i prindërve, vjedhja, sjellja keq me të tjerët.



Nëse dikush pyet veten dhe thotë: “Pse adhurojmë vetëm Allahun e lartmadhëruar?”

Përgjigja e vetme është se Allahu i lartmadhëruar është Krijuesi i vetëm i kësaj gjithësie që ne shohim dhe gjithë çfarë përmban ajo: tokë, qiell, male, lumenj, njerëz dhe kafshë.

Ai është pronari i çdo krijese, shpikësi i gjitha gjërave dhe krijesave nga asgjëja dhe zbrazëtia.

Gjithashtu, ne adhurojmë vetëm Allahun, sepse Ai pasi që na ka krijuar na ka dhuruar mirësi të shumta dhe na ka nënshtruar gjithçka të lejuar prej gjërave të krijuara në këtë tokë.

Pra, Ai ka në pronësi gjithçka: vetet tona dhe çdo gjë që ne gëzojmë.



Vështro veten dhe pyete!

A i zotëron duart e tua?

A i zotëron këmbët e tua?

A e zotëron çdo pjesë të trupit tënd?

Përgjigja e vetme është: Jo. Nuk zotëroj asgjë prej tyre.



Pse nuk zotëron asgjë nga pjesët e trupit tënd, kur ti nëse do të prekësh diçka me dorën tënde, arrin ta prekësh?!

Apo kur do të shkosh në një vend, shkon me këmbët e tua?!

Apo kur do të shikosh diçka, e shikon me sytë e tu?!

Përse janë të tuat, kur ti nuk i zotëron ato?!



Sepse ti je krijesë e Allahut.

Allahu është ai i cili të krijoi me dy duar, me dy këmbë dhe me gjithë organet e trupit.

Ti nuk ke krijuar gjë nga trupi yt!

Nuk ke krijuar gjë nga ato që të rrethojnë!

Të gjithë njerëzit -gjithashtu- nuk e kanë krijuar veten e tyre dhe as ndonjë gjë tjetër.

Krijuesi është vetëm Allahu i lartmadhëruar.



Çdo gjë që shih përpara prej: njerëzve, kafshëve, sendeve dhe çdo që e gëzon, apo e punon nuk është pronë e jotja, por pronë e Krijuesit dhe e Zotit të saj.

Allahu i lartësuar thotë:

“E Allahut është pronësia e qiejve dhe e tokës.”²⁵

Dhe thotë:

“Të Allahut janë gjithçka në qiej e në tokë dhe tek Allahu kthehen çëshjtjet.”²⁶

Dhe thotë:

“Allahu ka në pronësi qiejt dhe tokën. Ai jep jetë dhe vdekje.”²⁷



Pronari ynë dhe i çdo gjëje që ekziston është ai që duhet t'i bindemi dhe që e kemi detyrë ta adhurojmë dhe askënd tjetër.

Prandaj ne adhurojmë Allahun.

Ne e adhurojmë Allahun nga dashuria për të sepse Ai thotë:

“Thuaj! Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua që t'ju dojë Allahu.”²⁸

Ne e adhurojmë Allahun nga lakmia për xhenetin sepse Ai thotë:

“Allahu thërret për në xhenet dhe falje me lejen e tij.”²⁹

Ne e adhurojmë Allahun për t'u larguar nga zjarri nga frika prej tij sepse Ai thotë:

“O Zoti ynë! Ti, atë që e fut në zjarr, e ke poshtëruar.”³⁰

²⁵ Suretu Ali Imran: 189.

²⁶ Suretu Ali Imran: 109.

²⁷ Suratu Et-Teube: 116.

²⁸ Suretu Ali Imran: 31.

²⁹ Suretu El-Bakara: 221.

³⁰ Suretu Ali Imran: 192.

Pra, kush është i shpëtuar në këtë botë?

Dhe kush është i humburi?



I shpëtuar është zbatuesi i urdhrave të Allahut dhe i detyrave të Tij.

I shpëtuar është ai që adhuron Allahun e lartësuar ashtu siç e meriton.

I shpëtuar është ai që largohet nga çfarë e zemëron Allahun prej veprave të ndaluara.

Kurse i humbur është ai që nuk i bindet Allahut dhe kundërshton urdhrat dhe detyrat e Tij.

I humbur është ai që nuk i bën adhurim Allahut të lartmadhëruar.

I humbur është ai që vepron të ndaluarat dhe mëkatet dhe bën ato gjëra nga të cilat na ka ndaluar Zoti dhe Krijuesi ynë i lartësuar.

Ky është humbësi i vërtetë dhe ai tjetri është fituesi i vërtetë.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Kush largohet nga zjarri dhe hyn në xhenet, ai ka shpëtuar.”³¹



Prej llojeve të adhurimeve të rëndësishme në të cilën shumë njerëz gabojnë është duaja.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni mua që t’ju përgjigjem. Ata që tregojnë mendjemadhësi ndaj adhurimit tim do të hyjnë në xhehenem të poshtëruar”.³²

I dërguari ynë Muhamedi -alejhi selam- thotë:

“Duaja është (vetë) adhurimi.”³³

³¹ Suretu Ali Imran: 185.

³² Suretu Gafir: 60.

³³ E transmeton Tirmidhiu.

Pra, nëse ti do që të të japë Allahu diçka, lutju Atij dhe thuaji:

O Zot, më fut në xhenet!

O Zot, më shpëto nga zjarri!

O Zot, fali prindërit e mi!

E kështu me radhë për çdo çështje prej çështjeve të dynjasë dhe të ahiretit.

Ti kur i lutesh Allahut të lartësuar, beson me siguri të plotë se vetëm Ai është krijuesi yt, zotëruesi yt dhe Ai që ka mundësi t'i përgjigjet lutjes tënde.

Pra, lutja jote për Allahun e lartësuar është esenca e adhurimit dhe vërtetimi i besimit tënd në Allahun e lartësuar.

Prandaj, ti lutju vetëm Allahut dhe mos iu lut tjetërkujt prej krijesave të tij! Mos i kërko kujt gjë dhe as mos i thirr kujt për ndihmë prej krijesave të Tij!





Engjëjt (Melaiket)

Prej shtyllave më të rëndësishme të besimit në Allahun e lartësuar është: besimi në engjëjt, njohja me realitetin e tyre dhe me çfarë detyrash i ka ngarkuar Allahu i lartësuar.

Me besimin tonë në engjëjt mësojmë shumë çështje të rëndësishme për të cilat shpesh kemi pyetur veten tonë dhe kemi dashur të ndalemi te realiteti i tyre.



Engjëjt janë prej krijesave të Allahut të padukshme dhe të paprekshme, sepse nuk janë materie që mund të shihet me sy, apo të preket me dorë.

Ata i ka ruajtur Allahu i madhëruar nga gabimet dhe devijimet dhe i ka larguar nga gjynahet dhe mëkatet.

Ata gjithashtu nuk kanë zakonet e njerëzve, sepse, as hanë, as pinë, as flenë dhe janë botë tjetër e ndryshme nga bota e njerëzve të cilën e shohim.



Gjëja që i dallon më shumë engjëjt nga njerëzit është adhurimi i shumtë që i bëjnë Allahut, sepse ata janë adhurues të përhershëm dhe nuk lodhen në adhurim.

Allahu i madhëruar thotë:

“(Melaiket) Nuk e kundërshtojnë Allahun në atë që i urdhëron dhe kryejnë atë që urdhërohen.”³⁴

Dhe gjithashtu thotë:

“E madhërojnë (Allahun) natë e ditë dhe nuk lodhen.”³⁵

Ata janë ajka e krijesave të Allahut, prandaj dhe Allahu i ka zgjedhur për detyrat më fisnike.



A ka detyrë më fisnike se sa të përcjellësh ligjet e Zotit te të dërguarit dhe profetët që të ftojnë me to njerëzit në adhurimin e Allahut të vetëm?!

Me këtë detyrë fisnike i ka veçuar Allahu i lartësuar engjëjt.

Allahu i lartësuar thotë:

“Lavdërimi qoftë për Allahun, krijuesin e qiejve dhe të Tokës, i Cili i ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. Allahu, me të vërtetë, është i pushtetshëm për çdo gjë.”³⁶

Nuk do të kishte qenë për ata kjo detyrë, sikur të mos ishin këto cilësi të mëdha dhe dalluese nga krijesat e tjera të Allahut të lartësuar.



Prej cilësive fizike të engjëjve për të cilat na ka njoftuar Allahu i lartësuar në Kuranin famëlartë është se kanë flatra si në ajetin e lartpërmendur.

Këto flatra janë në numra të ndryshëm. Prej tyre ka që kanë dy flatra. Prej tyre ka që kanë tre flatra, ose katër. Madje prej tyre ka që kanë shumë më tepër se kaq si p.sh.: Xhibrili -alejhi selam-, sepse është përcjellë nga profeti -alejhi selam- se e ka parë Xhibrilin me gjashtëqind flatra.



³⁴ Suretu Et-Tahrim: 6.

³⁵ Suretu El-Enbija: 20.

³⁶ Suretu Fatir: 1.

Gjithashtu prej cilësive të tyre është se ata janë në gjendje të ngjiten e të zbrasin mes qiejve dhe tokës dhe me shpejtësi të jashtëzakonshme.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Tek Ai ngjiten engjëjt dhe Shpirti (*Xhibrili*), në një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet.”³⁷

Shpejtësia e engjëjve nuk krahasohet me shpejtësinë e njerëzve, apo njësitë e tyre matëse, kështu që s’ka përngjasim dhe as krahasim mes të dyjave.



Gjithashtu prej cilësive të tyre është se ata janë të krijuar nga drita, siç është përcjellë nga profeti -alejhi selam-.

Ata kanë aftësi të jashtëzakonshme e të çuditshme që s’mund t’i kenë as burrat më gjigantë prej njerëzve dhe një nga këto është se tetë prej tyre mbajnë Arshin e Rrahmanit të lartmadhëruar.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Dhe atë ditë e mbartin Arshin e Zotit tënd mbi vete, tetë (*engjëj*).”³⁸



Prej engjëjve ka nga ata që Allahu i lartësuar i ka ngarkuar me marrjen e shpirtrave të njerëzve kur vdesin.

Prijësi i këtyre engjëjve është “Meleku i Vdekjes”, i cili ka ndihmës nga engjëj të tjerë.

Allahu i madhëruar thotë:

“Thuaju: “Shpirtin do t’jua marrë engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj.”³⁹

Dhe gjithashtu thotë:

³⁷ Suretu El-Mearixh: 4.

³⁸ Suretu El-Hakka: 17.

³⁹ Suratu Es-Sexhde: 11.

“Kur dikujt prej jush i vjen vdekja, ia marrin atij shpirtin të dërguarit tanë dhe ata nuk i bëjnë kurrfarë lëshimi.”⁴⁰



Prej engjëjve ka edhe engjëj, të cilët Allahu i lartësuar i dërgon për të ndihmuar njerëzit besimtarë.

Allahu i lartësuar thotë:

“Kujto, kur Zoti yt u shpalli engjëjve: “Unë jam me ju, andaj mbështetini ata që besojnë”.”⁴¹

Pra, besimi ynë te ky lloj i engjëjve na bën të punojmë për ta merituar mbështetjen e Allahut nëpërmjet melaikeve.



Prej engjëjve ka edhe engjëj, të cilët Allahu i ka bërë shoqëruesit tanë që të shkruajnë veprat tona dhe të regjistrojnë çfarë kemi kryer prej të mirave dhe të këqijave.

Allahu i lartësuar thotë:

“Vallë, a mos kujtojnë ata se Ne nuk i dëgjojmë fjalët e tyre tinëzare dhe bisedat e tyre të fshehta? Pa dyshim, Ne i dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë (*engjëjt*), që janë pranë tyre, shënojnë.”⁴²



Besimi ynë në këtë lloj engjëjsh, të cilët regjistrojnë dhe janë të pandashëm prej nesh, na bën të jemi në vigjilencë të përhershme dhe me vëmendje të vazhdueshme që të ruhem nga rënia në të këqija, në mënyrë që ata të mos na i shënojnë ato vepra.

Kjo gjithashtu na bën të kemi shpresë të përhershme dhe dëshirë të plotë për kryerjen e veprave të mira dhe për t’iu bindur urdhrave, që të na i shkruajnë ato engjëjt regjistruar.

⁴⁰ Suretu El-En’am: 61.

⁴¹ Suretu El-Enfal: 12.

⁴² Suretu Ez-Zuhruf: 80.



Përmbledhja e kësaj teme:

Besimi në engjëjt është zgjerim i njohurive të njeriut për të mësuar rreth kësaj gjithësie të cilën e ka krijuar Allahu i lartësuar në forma dhe lloje të ndryshme.

Kështu besimtari ka njohuri të sakta dhe perceptime të rregullta për shumë vërtetësi të fshehta të gjithësisë, të cilat besimtari i di nga ajo që Allahu ia ka mësuar atij.

Ky besim gjithashtu na mëson se ata që kundërshtojnë Allahun në këtë gjithësi janë pak dhe përqindja e tyre është e papërfillshme në krahasim me gjithë krijesat e Allahut edhe pse ata mes njerëzve konsiderohet shumë, sepse të gjithë njerëzit kundrejt engjëjve dhe krijesave të tjera të bindura të Allahut nuk janë veçse pak.

Të bindurit janë vetëm ata, me të cilët Allahu është i kënaqur dhe i fut në xhenetin e Tij.





Kurani famëlartë

Kurani famëlartë është libri, të cilin Allahu i lartësuar ia ka zbritur nga qielli profetit tonë Muhamedit -alejhi selam-. Në këtë libër është udhëzimi dhe drita e plotë, sepse ai përmban fjalën e Allahut të lartësuar në dobi të njerëzisë dhe në të mirën e mbarë botës.

Allahu i madhëruar thotë:

“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe i përgëzon besimtarët.”⁴³



Fjala “**Kuran**” vjen nga fjala arabe “**karae**”, që do të thotë qartësoi dhe paraqiti. Kështu Kurani është qartësim i përsosur dhe paraqitje e shkëlqyer e ligjeve të Allahut. Aty është ajka e përmbajtjes së librave të mëparshëm si Teurati, të cilin Allahu ua zbriti hebrenjve, apo Inxhili, të cilin Allahu ua zbriti të krishterëve.

Allahu i lartësuar thotë:

“Ne të kemi zbritur ty librin me të vërtetën, vërtetues i librave të mëparshëm (*Teurati dhe Inxhili*) dhe mbizotërues ndaj tyre.”⁴⁴

⁴³ Suretu El-Isra: 9.

⁴⁴ Suretu El-Maide: 48.



Kurani famëlartë është fjala e Zotit të botëve, i lartësuar qoftë, por fjalë jo si fjalët e krijesave, sepse fjalët e Krijuesit ndryshojnë nga fjalët e krijesave dhe nuk i ngjajnë atyre.

Allahu i madhëruar thotë:

“Asgjë nuk i ngjan Atij.”⁴⁵

Gjithashtu thotë:

“Sikur këtë Kuran t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (*mal*) të përlulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut.”⁴⁶



Kurani famëlartë është libër udhëzimi. Ai na fton të mendojmë në mrekullitë e Allahut të lartësuar, të nxjerrim mësim nga krijimi, të meditojmë në krijesat e tij dhe të njohim hallallin dhe haramin për kryerjen e të mirave dhe largimin nga të këqijat.

Allahu i madhëruar thotë:

“Vallë, a nuk meditojnë ata në Kuran, apo zemrat i kanë të kyçura?!”⁴⁷

Dhe gjithashtu thotë:

“Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!”⁴⁸



Allahu i madhëruar e ka zbritur Kuranin famëlartë në qiellin e dynjasë natën e Kadrit, e cila është një prej netëve të muajve të bekuar të Ramazanit. Pas kësaj ngjarjeje, Ai dërgoi engjëllin e tij të nderuar Xhibrilin me disa ajete me vlerë të Kuranit famëlartë tek i dërguari ynë Muhamedi -alejhi salam-, pastaj vazhdoi zbritja e tij për shumë vite.

⁴⁵ Suretu Esh-Shura: 11.

⁴⁶ Suratu El-Hashr: 21.

⁴⁷ Suretu Muhamed: 24.

⁴⁸ Suratu El-Kamer: 17.

Allahu i lartësuar thotë:

“Ne e kemi zbritur atë (*Kuranin*) në natën e Kadrit * E sikur ta dish se ç’është nata e Kadrit! * Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.”⁴⁹



Po, kjo natë e bekuar është më e mirë se njëmijë muaj, sepse ajo është nata e zbritjes së librit të madh, fjalës së urtë dhe dritës së vërtetë mbi të dërguarin e mirësisë dhe udhëzimit, të dërguarin e Zotit të botëve.

Allahu i madhëruar thotë:

“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (*i së mirës nga e keqja*).”⁵⁰



Zbritja e Kuranit i vazhdoi profetit -alejhi selam- për më shumë se njëzet vjet.

Po cila është arsyeja?

Ajo ka qenë nder dhe lavdi për të dërguarin -alejhi selam-, sepse ai në këtë mënyrë e ndjente se është nën përkujdesjen hyjnore dhe nën mbikëqyrjen e zotëruesit dhe se Zoti i tij nuk e harron, sepse Ai është krijuesi, furnizuesi dhe mbrojtësi i tij.



Kurani famëlartë është mrekulli për njerëzit dhe mrekulli për të gjitha krijesat. Ai është libri i Allahut i cili nuk mundet kush të sjellë të ngjashëm me të, apo të flasë fjalë të ngjashme me fjalët e tij.

Allahu i lartësuar thotë:

“Nëse dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë, atëherë sillni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në

⁴⁹ Suretu El-Kadr: 1-3.

⁵⁰ Suretu El-Bekara: 185.

ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (*që i adhuroni*) në vend të Allahut, nëse jeni të sinqertë.”⁵¹

Jo. Ata nuk do të munden.

Ata janë të vegjël për ta bërë këtë edhe pse ishin arabë letrarë me gjuhën e të cilëve zbriti Kurani, por prapë nuk mundën dot dhe u stepën.

Allahu i madhëruar thotë:

“Ky është një Libër, vargjet e të cilit janë shtjelluar qartë, një Kuran në gjuhën arabe, për njerëzit me dije.”⁵²



Kurani famëlartë është libër udhëzimi dhe orientimi.

Allahu i madhëruar thotë:

“Thuaj: “Ai është udhërrëfyes dhe shërim për besimtarët”.”⁵³

Ky udhëzim i Kuranit përmban tre pjesë, të cilat përfshijnë gjithçka që u bën dobi njerëzve në çështjet e dynjasë dhe çështjet e jetesës.

Pjesa e parë: Përfshin akiden (besimin), të cilën njerëzit duhet ta mësojnë dhe ta besojnë si: besimi në Allahun, në engjëjt e tij, në librat e tij, në të dërguarit e tij dhe në ditën e fundit.

Pjesa e dytë: Përfshin gjykimet shariatike me të cilat njerëzit adhurojnë Zotin e tyre dhe mësojnë se çfarë i afron tek Allahu dhe çfarë i largon prej Tij.

Pjesa e tretë: Është sjellja me edukatë, e cila edukon dhe pastron shpirtin e besimtarit, ia ngre vlerën atij, forcon lidhjet vëllazërore dhe e bën më të qëndrueshëm bashkëpunimin ndërmjet njerëzve.

Prej këtyre moraleve janë: vërtetësia, durimi, mëshira, respektimi i prindërve e të tjera.



⁵¹ Suretu El-Bakara: 23.

⁵² Suretu Fusilet: 3.

⁵³ Suretu Fusilet: 44.

Pra, na duhet të drejtohem nga Kurani famëlartë:

Të lexojmë fjalët e tij.

Të meditojmë në ajetet e tij.

Të kuptojmë urdhrat dhe gjykimet e tij.

Të zbatojmë ligjet, dispozitat dhe detyrat e tij.

Të distancohem nga ndalesat e Allahut, të cilat e zemërojnë dhe nuk i pëlqejnë që ne t'i veprojmë.





Të dërguarit dhe profetët

Kur Allahu i lartësuar i krijoi të gjitha krijesat, zgjodhi disa burra nga njerëzit, që t'i ngarkojë me amanetin e përcjelljes së urdhrave të Tij -i lartësuar qoftë- dhe vënien në dijeni të njerëzve se çfarë kërkon nga ata Zoti i tyre: me çfarë i ka obliguar dhe nga se i ka ndaluar.

Allahu i madhëruar thotë:

“Allahu zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit (e kohës së tyre).”⁵⁴

Dhe gjithashtu thotë:

“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: “S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj Mua më adhuroni!””⁵⁵



Qëllimi kryesor për të cilin Allahu dërgoi të dërguarit dhe solli profetët është thirrja e njerëzve në adhurimin e Allahut dhe mbajtja e fesë.

Allahu i lartësuar thotë:

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që t’u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe largojuni idhujve!””⁵⁶

⁵⁴ Suretu Ali Imran: 33.

⁵⁵ Suretu El-Enbija: 25.

⁵⁶ Suretu En-Nahl: 36.

Nuk është mbajtja e fesë vetëm me namaz dhe agjërime, por është me çdo gjë me të cilën Allahu i ka urdhëruar njerëzit ta besojnë me zemër, apo ta praktikojnë me vepra dhe punë.

Pra, mbajtja e fesë kërkon besimin në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij dhe në ditën e fundit. Ajo kërkon gjithashtu punë të sinqerta dhe kryerjen e detyrave të kërkuara si: namazi, agjërimi etj. me të cilat Allahu i ka obliguar njerëzit.



Këto obligime, urdhra dhe udhëzime, nuk mund t'i dinë krijesat vetëm nëpërmjet logjikës së tyre pa ua mësuar ato Allahu i madhëruar. Ata i mësojnë ato nëpërmjet shpalljes së Allahut te të dërguarit e Tij dhe me përcjelljen e të dërguarve të Allahut tek ata urdhrat e Zotit të tyre.

Allahu i lartësuar thotë:

“(Allahu) Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t’ua lexuar atyre shpalljet e Tij, për t’i pastruar e për t’u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë.”⁵⁷

Kush i përgjigjet të dërguarve të Allahut dhe profetëve të Tij, ai është prej të shpëtuarve dhe kush kundërshton fjalën e tyre dhe nuk ua pranon thirrjen, ai është prej të humburve.



Allahu i lartësuar e ka obliguar myslimanin të besojë te të gjithë të dërguarit e Allahut dhe profetët e Tij pa dallim mes tyre, sepse të gjithë prej Allahut janë dërguar dhe për te krijesat e Tij janë nisur.

Zoti ynë i madhëruar thotë:

“Thoni: “Ne besojmë në Allahun, në atë që na është shpallur neve (*Kuranin*), në atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe Esbatëve (*12 bijve të Jakubit*), në atë që i është dhënë Musait e Isait dhe në atë që u është dhënë profetëve nga Zoti i

⁵⁷ Suretu El-Xhumuah: 2.

tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi midis tyre dhe vetëm Allahut i përulemi”.⁵⁸

Dhe gjithashtu thotë:

“I Dërguari beson në atë (*Kuranin*) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (*duke thënë*): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”.⁵⁹



Nëse dikush prej njerëzve beson në disa të dërguar dhe nuk beson në disa të tjerë, atëherë ai ka bërë dallime në besimin e tyre dhe është jobesimtar. Allahu i madhëruar nuk e fut atë në xhenet, por e dënon në zjarrin e xhehenemit -Allahu na ruajt-.

Allahu i madhëruar thotë:

“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë.”⁶⁰

Ky besim i detyruar për myslimanin, e bën atë të njohë vlerat e të dërguarve dhe të profetëve të mëparshëm, siç njihet dërgesën dhe profetësinë e fundit, atë të profetit Muhamed -alejhi selam-.



Prej këtyre të dërguarve ka nga ata, të cilët Allahu i ka përmendur në Kuranin famëlartë dhe nga ata, të cilët nuk i ka përmendur.

Allahu i madhëruar thotë:

“Për disa të dërguar të kemi treguar më parë dhe për disa të tjerë

⁵⁸ Suratu El-Bekara: 136.

⁵⁹ Suratu El-Bekara: 285.

⁶⁰ Suratu En-Nisa: 150-151.

nuk të kemi treguar.”⁶¹

Ata për të cilët Allahu na ka treguar janë: Ibrahim, Is’haku, Jakubi , Nuhu, Daudi, Sulejmani, Ejubi, Jusufi, Musa, Haruni, Zekerija, Jahja, Isai, Iljasi, Ismaili, Eljesai, Junusi, Luti, Hudi, Salihu, Shuajbi, Idrisi, Dhulkifli dhe Ademi.

Ata gjithsej janë njëzet e katër të dërguar të përmendur në Kuranin famëlartë.



I njëzetepesti është vula e profetëve, i fundit prej tyre dhe zotëria i tyre. Ai është i dërguari i Islamit -alejhi selam-, i cili u dërgua mëshirë për botën.

Allahu për të thotë:

“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve.”⁶²

Ndërsa ai për veten e tij ka thënë:

“Unë jam zotëria i bijve të Ademit dhe nuk mburrem.”⁶³



Myslimani e ka detyrë të dijë se, s’ka ndonjë popull nga ata të mëparshmit në të gjithë kohërat e kaluara, vetëm se Allahu i madhëruar i ka dërguar profet që t’i thërrasë ata për tek Allahu dhe t’i udhëzojë ata tek e vërteta.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues.”⁶⁴

Dhe thotë:

⁶¹ Suratu En-Nisa: 164.

⁶² Suretu El-Ahzab: 40.

⁶³ E transmeton imam Ahmedi.

⁶⁴ Suretu Fatir: 24.

“Çdo popull ka pasur të dërguar.”⁶⁵

Dhe thotë:

“Beto hem për Allahun se edhe para teje, Ne u kemi çuar të dërguar popujve të tjerë.”⁶⁶

Këta të dërguar, edhe pse emrat e tyre nuk janë përmendur në Kuranin famëlartë, duhet t’i besojmë përgjithësisht.



Profeti, të cilin e dërgon Allahu te një popull, është njeri si ata, por që ka cilësi të larta dhe virtyte fisnike, të cilat nuk i përmbush veçse ai te populli i tij.

Allahu i lartësuar thotë:

“Allahu zgjedh të dërguar nga engjëjt dhe njerëzit. Allahu me të vërtetë, dëgjon dhe sheh gjithçka.”⁶⁷

Dhe thotë:

“Allahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet.”⁶⁸

Profetësia, apo dërgesa është dhuratë e shtrenjtë prej Allahut të lartmadhëruar, për të cilën zgjedh disa prej robëve të Tij. Ata -siç e përmenda- kanë virtyte të larta dhe moral të përsosur, që të kryejnë detyrat e dërgesës dhe të jenë shembull i lartë për t’u marrë model në çështjet e fesë dhe të dynjasë.



Profeti për shkak se është njeri dhe krijesë e Allahut, përballet me gjithçka që përballen njerëzit e tjerë: shëndetin dhe sëmundjen, fuqinë dhe dobësinë, jetën dhe vdekjen.

Allahu i madhëruar thotë:

⁶⁵ Suretu Junus: 47.

⁶⁶ Suretu En-Nahl: 63.

⁶⁷ Suretu El-Haxh: 75.

⁶⁸ Suretu El-En’am: 124.

“Muhamedi është vetëm i dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa?!”⁶⁹



Secili prej profetëve të lartpërmendur, për shkak se është njeri dhe krijesë e Allahut, nuk vepron në gjithësi, nuk e ka në dorë dobinë dhe dëmin, nuk ndikon në vullnetin e Allahut dhe nuk di nga të fshehtat përveç asaj që i ka mësuar Allahu, siç thotë i lartmadhëruari:

“Thuj: “Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveç asaj që dëshiron Allahu. Sikur ta dija të fshehtën, do t’i shtoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë nuk jam tjetër veçse paralajmërues dhe sjellës i lajmeve të mira për njerëzit që besojnë”.”⁷⁰



Të gjithë të dërguarit -paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ta- kishin një synim dhe një objektiv të vetëm, që ishte: shpëtimi i njerëzve nga humbja dhe nxjerrja e tyre nga errësira në dritë. Pra, ata, -paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ta- ishin thirrës për në mirësi dhe prijës të përmirësimit, siç i ka përshkruar Zoti ynë i madhëruar në Kuran:

“Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuam që të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin dhe ata vetëm Ne na adhuruan.”⁷¹

Secili prej tyre vinte pas tjetrit që të përmbushte thirrjen e paraardhësit dhe të plotësonte rrugën e tij, derisa Allahu e komplotoi fenë e Vet dhe i vulosi profetët dhe të dërguarit me vulën dhe zotërinë e tyre, të dërguarin e Allahut Muhamedin -alejhi selam-. Feja e tij ishte përmbledhje e feve të mëparshme dhe thirrja e tij ishte thirrja e plotë dhe e fundit deri në ditën e kiametit, siç thotë Allahu i lartësuar në Kuranin famëlartë:

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.”⁷²

⁶⁹ Suretu Ali Imran: 144.

⁷⁰ Suretu El-Earaf: 188.

⁷¹ Suretu el-Enbija: 73.

⁷² Suretu el-Maide: 3.



Dita e Fundit

Besimi në Ditën e Fundit është shtyllë themelore prej shtyllave të besimit dhe një prej çështjeve të rëndësishme të njohjes së njeriut me Zotin e vet.

E si të mos jetë kështu, kur ky besim e pajis njeriun me njohuri rreth të ardhmes dhe me përfundimin e kësaj bote me gjithë çfarë ajo përmban: me tokë e me det, me fusha e me male, me njerëz e me kafshë dhe me të gjitha krijesat të çfarëdo lloji qofshin.



Kur njeriu e mëson se çfarë do të ndodhë me të, me pasurinë, rininë, shtëpinë dhe fëmijët e tij, atëherë ai mundet që ta jetojë jetën siç e do Allahu i madhëruar prej tij me: adhurime, bindje dhe kryerjen e detyrave që ia ka ngarkuar Zoti i tij. Ai mundet gjithashtu të përcaktojë qëllimin e tij në këtë jetë dhe të ndërmarrë mjetet, rrugët dhe mënyrat të cilat e çojnë atë te ky qëllim dhe e ndihmojnë në realizimin e tij.

Ndërsa atij të cilit i mungojnë këto njohuri dhe nuk e ka ditur këtë realitet dhe zemra e tij nuk e ka besuar se kjo botë ka një ditë të fundit në të cilën ajo mbaron dhe merr fund, atëherë jeta e tij do jetë pa vlerë, pa qëllim dhe pa objektiv.



Zoti ynë i madhëruar na e ka bërë të qartë në Kuranin famëlartë se, nuk i ka krijuar krijesat pa ndonjë qëllim të madh dhe synim të lartë, por i ka krijuar për më të madhin qëllim dhe më të lartin synim.

Zoti ynë i madhëruar kur krijoi njeriun, ia nënshtroi atij gjithçka në qiell e në tokë dhe e bëri pronar në tokë dhe në çfarë mban ajo. Vallë, a mos ishte e gjitha kjo pa ndonjë qëllim, a synim?

Këtë cilësi nuk e ka Allahu i madhëruar.

Allahu i madhëruar thotë:

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (*për t’ju gjykuar*)?!” I lartësuar është Allahu, Sundimtari i Vërtetë! S’ka zot tjetër të vërtetë, përveç Atij, Zotit të Fronit Madhështor!”⁷³



Dita e Fundit fillon me zhdukjen e botës sonë atëherë kur vdes çdo i gjallë dhe toka ndryshon në një tokë tjetër e po ashtu dhe qiejt.

Pastaj Allahu i madhëruar i ringjall të vdekurit në varre dhe ua kthen sërish jetën.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri? A s’ka qenë një pikë fare që derdhej, pastaj u bë droçkë gjaku e më pas Allahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara, e prej tij bëri çiftin: mashkullin e femrën?! Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t’i ngjallë të vdekurit?”⁷⁴



Pas kësaj jete të re, Allahu i madhëruar merr në llogari çdo njërin prej njerëzve për ato që ka vepruar në jetën e dynjasë prej të mirave a të këqijave.

⁷³ Suretu El-Muminun: 115-116.

⁷⁴ Suratu El-Kijame: 36-40.

Kush ishte prej të mirëve në dynja, bënte mirësi dhe kryente vepra të mira, e shpërblen Allahu për këto punë me Xhenet.

Dhe kush ishte i keq në dynja, vepronte të këqijta dhe nuk kryente punët e mira të obliguara prej Allahut, e ndëshkon Allahu për atë që të këqijta ka mbledhur, me zjarrin e Xhehenemit.



Besimi në Ditën e Fundit ka shumë rëndësi, gjë që duket qartë nga leximi i ajeteve të lartpërmendura të Kuranit.

Allahu i lartësuar thotë:

“Por mirësia është (*cilësi*) e atij që beson Allahun dhe Ditën e Fundit.”⁷⁵

Këtu, Allahu i madhëruar e përmend besimin në Ditën e Fundit bashkë me besimin e Tij dhe kjo gjë tregon për rëndësinë e madhe dhe themelore të saj.

Kush e lexon Kuranin famëlartë shih ajete të shumta që e përmendin dhe tregojnë për të. Pothuajse s’ka sure që të mos tregojë për të duke ia prezantuar atë mendjes dhe logjikës, herë me argumente e fakte dhe herë me sjellje shembujsh.



Ai që lexon ajetet e Kuranit vë re se Dita e Fundit është përshkruar me shumë emra. Çdonjëri prej atyre emrave tregon për një ndodhi a ngjarje që do të ndodhë në atë ditë të madhe, Ditën e Fundit.

Ajo është “Dita e Ringjalljes”, siç ka thënë Zoti ynë i madhëruar:

“Ata, të cilëve u është dhënë dituria dhe besimi, do të thonë: “Ju, me të vërtetë, keni qëndruar atë që ju ka caktuar Allahu në Libër deri në Ditën e Ringjalljes. Ja, kjo është Dita e Ringjalljes, por ju nuk e keni ditur”. ”⁷⁶

⁷⁵ Suretu El-Bekara: 177.

⁷⁶ Suretu Err-Rrum: 56.

Ajo është “Dita e Kiametit”⁷⁷, siç ka thënë Zoti ynë i madhëruar:

“Në Ditën e Kiametit do t’i shihni ata që kanë trilluar gënjeshtër për Allahun, me fytyra të nxira.”⁷⁸

Ajo është “Ora”, siç thotë Allahu i madhëruar:

“Me të vërtetë dridhja e Orës (së Kiametit), është një ngjarje e madhe.”⁷⁹

Ajo është “Dita e Llogarisë”, siç thotë Zoti ynë i madhëruar:

“Unë i lutem Zotit Tim dhe Zotit tuaj për të më mbrojtur prej çdo mendjemadhi, që nuk beson në Ditën e Llogarisë!”⁸⁰

Dita e Fundit ka edhe disa emra të tjerë përveç këtyre.



Kurani i ka kushtuar gjithë këtë vëmendje Ditës së Fundit për disa arsye, ku më të rëndësishmet janë:

Së pari: Idhujtarët arabë e mohonin dhe nuk e pranonin.

Së dyti: Besimi në Ditën e Fundit i jep jetës vlerë, qëllim dhe synim.

Së treti: Disa ndjekës të feve të tjera të kota e besonin Ditën e Fundit ndryshe nga realiteti i saj që duhet të pranohet.



Ajetet kuranore dhe hadithet profetike tregojnë se fillimi i Ditës së Fundit do të jetë me ndodhjen e ndryshimeve të përgjithshme të kësaj bote ku jetojmë, ndryshime në tokë dhe në qiell:

Do të çahet qielli.

Do të shkëputen yjet.

⁷⁷ Kijamet dmth: Ngritje dhe Dita e Kijametit është dita kur njerëzit ngrihen nga varret e tyre për të dalë para Zotit të botëve.

⁷⁸ Suretu Ez-Zumer: 60.

⁷⁹ Suretu El-Haxh: 1.

⁸⁰ Suretu Gafir: 27.

Do të thërrmohen malet.

Do të shkatërrohet çdo gjë.

Allahu i madhëruar thotë:

“Ditën, kur Toka do të ndërrohet në tjetër tokë e po ashtu edhe qiejt dhe të gjithë të dalin para Allahut të Vetmit dhe Ngadhënjyesit.”⁸¹



Kohën se kur do të jetë Dita e Fundit, nuk e di tjetërkush veç Allahut të lartmadhëruar. Ai nuk ia ka shfaqur atë askujt prej krijesave të Tij: as profetëve të dërguar dhe as engjëjve të afërt.

Allahu i madhëruar thotë:

“**Vetëm Allahut i referohet dija e Orës** (*së Fundit*).”⁸²

Disa prej sahabëve e pyesnin të dërguarin e Allahut për çastin e orës së fundit dhe kohën e saj dhe ia përsërisnin pyetjen herë pas here, atëherë Allahu i madhëruar e urdhëroi atë që t’ia referojë vetëm Atij dijen dhe njohjen e kohës së saj.

Allahu i madhëruar thotë:

“**Ata të pyesin ty** (*O Muhamed*) **rreth Orës** (*së fundit*). **Thuaju: “Atë e di vetëm Zoti im. Kohën kur do të ndodhë ajo, do ta tregojë vetëm Ai. Çështja e saj ka rënduar qiejt dhe Tokën dhe nuk do t’u vijë veçse befas.”**Të pyesin, a thua se ti di diçka për të. Thuaj: “**Këtë e di vetëm Allahu, ndërsa shumica e njerëzve nuk e dinë** (*se kjo gjë është e fshehtë*).”⁸³



Pasi Allahu i lartësuar t’ua kthejë sërish jetën njerëzve dhe t’i nxjerrë nga varret, do t’i grumbullojë ata te vendi Tij dhe do t’i mbledhë para vetes për të marrë në llogari çdokënd prej tyre për punët që kanë vepruar.

⁸¹ Suretu Ibrahim: 48.

⁸² Suretu Fusilet: 47.

⁸³ Suretu El-Earaf: 187.

Atëherë toka dëshmon se çka ngjarë mbi të.

Allahu i madhëruar thotë:

“Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (*të fundit*) dhe kur ajo të nxjerrë barrën e rëndë që mban e njeriu të thotë: “Ç’po i ndodh asaj!” Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj, sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë. Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t’u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”⁸⁴

Dhe jo vetëm ajo por, edhe gjuhët do të dëshmojnë, edhe duart do të flasin dhe po ashtu edhe këmbët, edhe lëkurat, derisa askush të mos mundet të gënjejë apo të arratiset.

Allahu i madhëruar thotë:

“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë, Allahu do t’ua shpaguaj dënimin e merituar dhe ata do ta marrin vesh se Allahu është e Vërteta e qartë”⁸⁵.

Kështu përmbushet argumentimi i Allahut ndaj krijesave. Kush ka kryer punë të mira, ka Xhenetin vendbanim dhe kush i ka bërë keq vetes dhe ka kundërshtuar Zotin e tij do të ndëshkohet me Zjarr dhe sa vend i keq që është ai.



⁸⁴ Suretu Ez-Zelzele: 1-8.

⁸⁵ Suretu En-Nur: 24-25.



Xheneti (Parajsa)

Xheneti është ai vend i gjerë dhe i madh, të cilin Allahu i lartësuar e ka përgatitur për robtë e Tij, të cilët i janë bindur Atij në jetën e kësaj bote dhe i janë përmbajtur urdhrave të Tij, si shpërblim për besimin e tyre të sinqertë dhe punën e tyre të mirë.

Allahu i madhëruar thotë:

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, gjerësia e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit.”⁸⁶



Allahu i madhëruar e ka emërtuar atë në Kuranin famëlartë me disa emra:

Kopshti i Strehimit.

Shtëpia e Përjetësisë.

Firdeusi (*Kopshti i Lartë i Begative*).

Shtëpia e Paqes.

Shtëpia e Përhershme.

Vendi i Sigurt.

Dhe emra të tjerë.

⁸⁶ Suretu Ali Imran: 133.



Në Xhenet nuk hyn veçse ai, i cili kryen vepra të mira e fisnike dhe pajiset me cilësi të larta e veti të lavdërueshme dhe të ndershme.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë prej besimtarëve jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. *(Ky është)* premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj tregtie! Kjo është fitorja madhështore. *(Këta janë)* ata që pendohen, e adhurojnë Allahun, e falënderojnë Atë, agjërojnë, përkulen *(në namaz)*, bien në sexhde *(gjatë namazit)*, urdhërojnë për vepra të mira, pengojnë të këqijat dhe u përmbahen kufijve të caktuar nga Allahu. Jepu lajmin e mirë besimtarëve!”⁸⁷



Allahu i lartësuar e ka përshkruar Xhenetin se begatitë e tij janë të përhershme dhe gëzimi aty nuk ka fund, çdo gjë atje është me bollëk dhe lumenjtë e tij janë të shumtë, të mëdhenj dhe të shumëllojshëm.

Prej lumenjve ka që janë me ujë të mirë e të shijshëm, të cilit nuk i ndryshon aroma dhe as shija e ndijimi.

Prej tyre ka që janë prej qumështi të pastër e të këndshëm.

Prej tyre ka që janë prej alkooli të shijshëm për ata që e pinë, jo si alkooli i ndaluar i kësaj bote, i cili prish mendjen dhe bllokton logjikën.

E prej tyre ka që janë prej mjaltit të kulluar.

E lumenj të tjerë që rrjedhin poshtë banesave.

Aty ka edhe fruta dhe mish shpendësh.



Prej gjërave të çuditshme me të cilat Allahu i lartësuar i furnizon banorët e Xhenetit janë frutat e shijshme, me shije të veçanta dhe

⁸⁷ Suretu Et-Teube: 111-112.

të ndryshme, të cilat i ngjajnë njëra-tjetrës dhe banorët e Xhenetit i mendojnë se janë të njëjta me ato që kanë ngrënë më përpara, por realiteti është ndryshe.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Përgëzoi ata që kanë besuar dhe kanë punuar vepra të mira se për ta do të jetë xheneti poshtë të cilit rrjedhin lumenj. Sa herë që u sjellin fruta, thonë: “Si këto na sollën më përpara.” dhe u duken të ngjashme. Aty do të kenë bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë.”⁸⁸



Këtë furnizim, të cilin e ka përgatitur për ta Zoti i tyre i madhëruar, ua sjellin shërbëtorë djelmosha, të cilët u shërbejnë dhe u përgjigjen porosive e dëshirave të tyre.

Këta djelmosha mbajnë enë dhe gota prej floriri të pastër. Ata nga bukuria dhe përsosmëria i ngjajnë margaritarëve të shpërndarë.

Allahu i madhëruar thotë:

“Atyre do t’u shërbejnë djem përherë të rinj, të cilët kur i shikon, të duken si margaritarë të shpërndarë.”⁸⁹

Dhe gjithashtu thotë:

“Hyni në Xhenet të gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja, ku do t’ju shërbehet me pjata dhe gota prej floriri. Aty do të ketë çfarë t’ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë.”⁹⁰



Prej mirësive të Xhenetit, të cilat ua jep Allahu robvë të Tij të mirë dhe krijesave të Tij besimtare dhe që janë veçanërisht për ata në mesin e gjithë krijesave, janë: veshja dhe banesat.

⁸⁸ Suretu El-Bekara: 25.

⁸⁹ Suretu El-Insan: 19.

⁹⁰ Suretu Ez-Zuhruf: 70-71.

Veshja e banorëve të Xhenetit është prej mëndafshi të hollë dhe të trashë dhe ata zbukurohen me flori të kulluar dhe të pastër.

Banesat e tyre janë shumë të mira me projekte të habitshme dhe me dhoma me kate, poshtë të cilave rrjedhin lumenj.

Allahu i madhëruar thotë:

“Ndërkaq, ata që i frikësohen Zotit, do të kenë dhoma të ngritura mbi njëra-tjetrën, pranë të cilave rrjedhin lumenj. Ky është premtimi i Allahut dhe Allahu nuk e thyen premtimin e Vet.”⁹¹



Nuk ka në Xhenet prej gjërave të Dynjasë veçse emrat, sepse aty ka çfarë syri s’e ka parë, veshi s’e ka dëgjuar dhe mendja njerëzore s’e ka imagjinuar.

Allahu i madhëruar thotë:

“Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në botën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”⁹²



Në Xhenet nuk ka mëkate dhe as kotësira.

Atje ka:

Lartësim për Allahun dhe madhërim për Të.

Selam prej Allahut për besimtarët.

Selam prej engjëjve për besimtarët.

Selam prej besimtarëve për njëri-tjetrin.

Allahu i madhëruar thotë:

“Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e Xhenetit) dhe do t’u thonë: “Selam për ju, për durimin që keni treguar (në jetën e dynjasë)! Sa përfundim i mirë është ai vendbanim!”⁹³

⁹¹ Suretu Ez-Zumer: 20.

⁹² Suretu Es-Sexhde: 17.

⁹³ Suretu Er-Rrad: 23-24.

Banorët e Xhenetit janë në paqe dhe qetësi, sepse Allahu ua ka çrrënjësuar nga zemrat smirën ndaj njerëzve. Të gjithë janë vëllezër të dashur dhe nuk i prek ata në Xhenet as lodhje e as sëmundje.



Mirësia më e madhe që gjejnë banorët e Xhenetit është shikimi i Zotit të tyre të madhëruar dhe fitimi i kënaqësisë së Tij.

Allahu i madhëruar thotë:

“Atë ditë, disa fytyra shkëlqejnë. Te Zoti i tyre duke parë.”⁹⁴

Dhe gjithashtu thotë:

“Dhe kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh.”⁹⁵

Ky është kulmi i plotësisë së mirësive të Allahut mbi robtë e Tij dhe nderimi i Tij për ta.



Xheneti është i përhershëm dhe nuk mbaron. Ai do të mbetet përgjithmonë dhe po ashtu banorët e tij do jenë të përhershëm, as do të vdesin dhe as do të shuhen, apo shfarosen.

Allahu i madhëruar thotë:

“Kurse fatlumët, do të hyjnë në Xhenet, ku do të qëndrojnë përherë, aq sa të jenë qiejt dhe Toka, përveç nëse do Zoti yt. Kjo është dhuratë e pandërprerë.”⁹⁶

Sekreti i kësaj përjetësie për banorët e Xhenetit është se Allahu i madhëruar e di që në zemrat e tyre ka vendosmëri në besim dhe këmbëngulje në bindje sado e gjatë të jetë jeta dhe sado e madhe të jetë moshja. Prandaj Allahu i lartësuar deshi që t'i shpërblejë ata për qëllimin dhe vullnetin e tyre me diçka shumë më të madhe dhe më të lartë në grada dhe u shkroi atyre në këmbim të asaj vendosmërie dhe këmbënguljeje në bindje, përjetësinë në Xhenet dhe qëndrimin në të, të gëzuar dhe të lumtur.

⁹⁴ Suretu El-Kijame: 22-23.

⁹⁵ Suretu Et-Teube: 72.

⁹⁶ Suretu Hud: 108.



Zjarri (Xhehenemi)

Kush i bindet Allahut të madhëruar, vepron të mirat dhe i largohet të këqijave, Allahu i madhëruar e shpërblen me Xhenet, i jep atij begatitë e përhershme e të qëndrueshme dhe aty do të jetë përgjithmonë e nuk vdes kurrë.

Ndërsa kush e kundërshton Allahun e madhëruar duke vepruar të këqijat dhe duke lënë te mirat, s'ka dyshim se Allahu i madhëruar do e shpërblejë me dënim për veprat e këqija që ka kryer dhe do e fusë në zjarrin e Xhehenemit -Allahu na ruajte prej tij-.



Zjarri ka disa emra:

Sair [Zjarri i Ndezur].

Ledha [Flaka e Pastër].

Hauije [Gropa e Rrëzimit].

Sekar [Djegësi, apo Përcëlluesi].

Secili prej këtyre emrave tregon për dënimin e ashpër, ndëshkimin e rëndë dhe një mënyrë të dënimit në Zjarr.



Allahu i madhëruar e ka përshkruar me hollësi Zjarrin, aq sa të thinjet floku e të preket zemra, në mënyrë që të kthehen të humburit nga rruga e humbjes. Ai ka përmendur se lënda djegëse e tij do të jenë njerëzit dhe gurët.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët nuk kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por zbatojnë çfarë urdhërohen.”⁹⁷

Zjarri gjithashtu nuk mjaftohet me çfarë i hidhet atij, për shkak të madhësisë dhe gjerësisë së tij. Ai gjithmonë kërkon më shumë që të mos mbetet asnjë pjesë e tij bosh.

Allahu i madhëruar thotë:

“Atë Ditë Ne do ta pyesim Xhehenemin: “A u mbushe?” e ai do të përgjigjet: “A ka edhe më?””⁹⁸



Banorët e zjarrit hanë, pinë dhe vishen, por:

Çfarë hanë, çfarë pinë dhe çfarë veshin?

Allahu i lartësuar thotë:

“A është më e mirë kjo gjendje apo pema e Zekumit? Ne e kemi bërë atë mundim për keqbërësit. Ajo është pemë që del nga fundi i Zjarrit flakërues dhe frutat e saj janë si kokat e djajve. Me të vërtetë, ata do ta hanë prej këtyre frutave dhe me to do të mbushin barqet. Pastaj, ata do të kenë një përzierje me ujë të nxehtë (për ta pirë).”⁹⁹

Pra ushqimi i tyre është Zekumi. Ajo është pemë prej llojeve më të pështira të pemëve, me shije të hidhur dhe më erë të qelbur.

⁹⁷ Suratu Et-Tahrim: 6.

⁹⁸ Suretu Kaf:30.

⁹⁹ Suretu Es-Safat: 62-67.

Kurse për pijen, Allahu i madhëruar thotë:

“Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t’u jepet ujë si xehja e shkrirë, që do t’ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)!”¹⁰⁰

Pra, pija e tyre është bakër i shkrirë nga zjarri, i cili ua copëton zorrët dhe ua djeg fytyrat.

Ndërsa për rrobat, Allahu i madhëruar thotë:

“Për ata që nuk besojnë janë përgatitur rroba prej zjarri, e mbi kokat e tyre do të hidhet ujë i valuar, me të cilin do t’u shkrihen ç’kanë në barqe dhe lëkurat. Për ata ka kamxhikë prej hekuri.”¹⁰¹



Kështu është jeta e banorëve të zjarrit:

Dënim dhe mjerim.

Vuajtje dhe ndëshkim.

As vdesin që të qetësohen dhe as bëjnë jetë të lumtur që të gëzohen.

Allahu i madhëruar thotë:

“Përkujtimit do t’i shmanget vetëm më i keqi, i cili do të digjet në zjarrin e madh, ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë.”¹⁰²

Dhe gjithashtu thotë:

“Ata që mohuan shenjat Tona, Ne padyshim, do t’i djegim në zjarr. Sapo t’u digjen lëkurat, do t’ua ndërrojmë ato me lëkura të tjera që ta shijojnë dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”¹⁰³



¹⁰⁰ Suretu El-Kehf: 29.

¹⁰¹ Suretu El-Haxh: 20-21.

¹⁰² Suretu El-Eala: 11.

¹⁰³ Suretu En-Nisa: 56.

Imagjinoje zjarrin në shtëpinë tënde, a do të mundje ta prekje atë, apo t'i afroheshe atij?

Nëse do ta bësh, do të digjet dora dhe prandaj i largohesh dhe nuk i afrohesh.

Nuk është ky zjarr që ti i druhesh, vetëm se diçka e vogël.

Po sikur të shihje një zjarr të rënë në ndonjë vend dhe të shihje flakët valë-valë duke dalë prej tij, çfarë do të bëje?

S'ka dyshim se droja jote prej këtij zjarri të madh do të jetë më e madhe se droja jote prej zjarrit që sheh në shtëpi dhe do të largohesh prej tij.

Nëse e ke kuptuar këtë, atëherë dije se më i madhi zjarr që mund të ekzistojë në këtë botë, nuk është asgjë para zjarrit në Xhehenemit.

Profeti Muhamed -alejhi selam- thotë:

“Zjarri që ju ndizni ka një të shtatëdhjetën pjesë të nxehtësisë së zjarrit të Xhehenemit.”

Shokët e profetit -paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- i thanë atij:

“Edhe sikur të ishte si zjarri i Dynjasë, do të mjaftonte si dënim, o i dërguar i Allahut.”

Atëherë profeti -alejhi selam- u tha:

“Ai mbi këtë të Dynjasë është gjashtëdhjetë e nëntë pjesë, secila prej tyre ka sa nxehtësia e zjarrit të Dynjasë.”¹⁰⁴



Banorët e Zjarrit kanë shkallë të ndryshme dënimi: prej tyre ka që do të kenë dënim shumë të ashpër dhe prej tyre ka që do ta kenë dënim më të lehtë.

Profeti Muhamed -alejhi selam- na ka njoftuar për dënimin më të lehtë në Zjarr, atëherë cili është dënimi i tij, si do të jetë situata e tij dhe çfarë do të ndjejë ai?

¹⁰⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

I dërguari -alejhi selam- ka thënë:

“Njeriu me dënimin më të lehtë është ai i cili do të ketë nallane prej zjarri prej të cilit i vlon truri siç vlon uji në vorbë. Nuk i duket se po dënohet njeri më ashpër se ai, por në të vërtetë ai ka dënimin më të lehtë.”¹⁰⁵



Kurse besimtarët vepërmirë, të cilët iu bindën Zotit të tyre, iu përgjigjën urdhrave të Tij dhe nuk iu afruan ndalesave, nuk do i prekë gjë nga ky dënim. Por mund të ketë disa njerëz prej myslimanëve që falen dhe agjërojnë dhe kanë rënë në disa mëkate, kanë vepruar disa ndalesa dhe kanë lënë disa urdhra: si do të jetë gjendja e tyre, do jenë në Xhenet apo në Zjarr?

Allahu i madhëruar thotë:

“Ditën e Kiametit, do të vendosim peshore të drejta e askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi. Do të sjellim (*për gjykim*) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi dhe mjaftojmë Ne për llogaritje.”¹⁰⁶

Allahu i madhëruar është më i urti dhe më i drejti. Ata që janë të kësaj kategorie, Ai i merr në llogari për punët e tyre duke ua peshuar punët e mira dhe punët e këqija.

Nëse punët e mira do të jenë më shumë, ai do të jetë në xhenet.

E nëse punët e këqija do të jenë më shumë, atëherë ai do të hyjë në zjarr për t’u dënuar për atë që gjynahe ka mbartur, shpërblim, i cili rezulton prej drejtësisë dhe urtësisë së Tij, pastaj përfundimi i tij do të jetë në Xhenet.



Zjarri është i përjetshëm, as shuhet dhe as mbaron.

Edhe banorët e Zjarrit, as i zë vdekja dhe as shuhen.

¹⁰⁵ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹⁰⁶ Suretu El-Enbija: 47.

Allahu i madhëruar thotë:

“Ndërsa të poshtrit, do të hyjnë në zjarr, ku i presin ofshamat e vajtimet. Aty do të mbeten përherë, sa të jenë qiejt dhe Toka, përveç nëse do Zoti yt. Me të vërtetë, Zoti yt e kryen atë që do.”¹⁰⁷

Sekreti i qëndrimit të banorëve të zjarrit në Zjarr dhe përjetësimin të tyre aty, është se ata ishin të vendosur në poshtërsi dhe në veprat e këqija që bënin dhe i shpërbleu Allahu për atë që preferuan dhe zgjodhën. Ata edhe sikur të jetonin qindra vite do të vazhdonin të qëndronin në mohim, mosbindje dhe kokëfortësi.

Madje edhe pasi të dënohen në Zjarr dhe t’u bëhet realitet i padyshimtë, sikur të ktheheshin në Dynja do të ktheheshin prapë te gjendja e tyre e mohimit dhe e mosbindjes.

Allahu i madhëruar thotë:

“Sikur t’i shohësh ata kur të vihen para zjarrit, duke thënë: “Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t’i mohonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!” Po, atyre iu doli në pah ajo që më parë e fshihnin, por edhe sikur të ktheheshin, prapë do të bënin ato që u ishin ndaluar. Vërtet, ata janë gënjeshtarë.”¹⁰⁸



¹⁰⁷ Suretu Hud: 106-107.

¹⁰⁸ Suretu El-En’am: 27-28.



Abdesi

Adhurimi më i rëndësishëm praktik të cilin Allahu i madhëruar ua ka kërkuar robëve të tij besimtarë është namazi (lutja).

Namazi që të jetë i saktë ka kushte dhe më i rëndësishmi prej tyre është abdesi.

Allahu i madhëruar thotë:

“O besimtarë! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla, fshijeni kokën dhe lani këmbët deri në nyje!”¹⁰⁹

Pra, kush do të falet, duhet patjetër të marrë abdes.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Allahu nuk pranon namaz, pa prekur ujin pastrues (*abdesi*).”¹¹⁰

Dhe gjithashtu ka thënë:

“S’ka namaz, ai që s’ka abdes.”¹¹¹



Abdesi ka mirësi të shumta dhe shpërblim të madh.

¹⁰⁹ Suretu El-Maide: 6.

¹¹⁰ E transmeton Muslimi.

¹¹¹ Etransmeton Ebu Daudi dhe Ibn Maxhe.

Profeti -alejhi salam- ka thënë:

“Kur të marrë abdes myslimani, bien gjynahet e tij nga dëgjimi, shikimi, duart dhe këmbët dhe kur të ulet, ulet me gjynahe të falura.”¹¹²

Dhe gjithashtu ka thënë:

“Kush merr mirë abdes, bien gjynahet prej trupit të tij deri dhe prej thonjve.”¹¹³



Para se të mësojmë mënyrën e marrjes së abdesit duhet të njihemi me një veprim të rëndësishëm, të cilin shpesh herë e bëjmë para abdesit dhe ai është kryerja e nevojës.

Kryerja e nevojës ka disa norma, të cilat na i ka mësuar Profeti alejhi salam. Prandaj, kur dikush do që të kryejë nevojën, duhet të ketë parasysh si më poshtë:

E para: Të hyjë në vendin e kryerjes së nevojës me këmbën e majtë duke thënë: “**Allahumme in-nij eudhu bike minel-khubuthi uel-khabaith!**

*(O Allah! Mbështetem te Ti të më mbrosh prej shejtanëve të pistë: meshkuj e femra!)*¹¹⁴

E dyta: Të largojë gjëra të shenjta që mund të mbajë me vete si p.sh. Kurani.

E treta: Të ruaj rrobat e tij që të mos preken nga ndyrësitë si urina, apo piklat urinës.

E katërta: Të sigurohet për ndërprerjen e nevojës pas kryerjes së saj.

E pesta: Të largojë mbetjet e ndyta të jashtëqitjeve me ujë, apo me letra, apo me diçka tjetër të ngjashme.

¹¹² E transmeton Taberani.

¹¹³ E transmeton Muslimi.

¹¹⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

E gjashta: Nëse mbetjet e jashtëqitjeve i largon me letra, duhet të sigurohet që ato të mos përmbajnë fjalë të shenjta të shkruara si: ajete dhe hadithe, sepse kjo është e ndaluar dhe nuk lejohet, madje t'i largohet fare letrave të shkruara.

E shtata: Të sigurohet se mbetjet e jashtëqitjeve janë hequr plotësisht.

E teta: Të mos përdorë dorën e djathtë për pastrim nga mbetjet e ndyta, kur t'i heqë ato, por të përdorë dorën e majtë dhe s'ka problem nëse e përdor të djathtën p.sh. për hedhjen e ujit.

E nënta: Pasi të ketë kryer nevojën të dalë me këmbën e djathtë duke thënë: **“Gufraneke! (Kërkoj faljen tënde, o Allah!)”**¹¹⁵



Kur të ketë mbaruar nga kryerja e nevojës dhe do që të marrë abdes, duhet të ketë parasysh si më poshtë:

E para: Të bëjë nijetin (*qëllimin*) për abdes me zemër pa lëvizur gjuhën, se profeti -alejhi selam- thotë:

“Punët janë sipas nijetit (*qëllimit*).”¹¹⁶

E dyta: Ta fillojë abdesin me përmendjen e Allahut duke thënë: **“Bismil-lah! (Me emrin e Allahut)!”**

E treta: Të lajë duart tre herë.

E katërta: Të shpëlajë gojën tre herë duke e lëvizur ujin nëpër gojë.

E pesta: Të shpëlajë hundën tre herë me dorën e djathtë duke e thithur ujin brenda hundës.

E gjashta: Pas çdo thithjeje të ujit ta nxjerrë atë jashtë në të tre herët.

E shtata: Të lajë fytyrën tre herë. D.m.th.: Të lajë zonën që përfshinë pjesën nga fillimi i flokëve deri poshtë mjekrës për së gjati dhe nga maja e njërit vesh deri te tjetri për së gjeri.

¹¹⁵ E transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.

¹¹⁶ E transmeton Buhariu.

E teta: Të lajë duart nga majat e gishtërinjve deri te bërrylat, tre herë.

E nënta: Të fërkojë me dy duart e tij të gjithë kokën nga përpara deri mbrapa dhe anasjelltas.

E dhjeta: Të fërkojë veshët, sepse ato bëjnë pjesë te koka.

E njëmbëdhjeta: Të lajë këmbët nga majat e gishtërinjve deri te nyjat.

Me kryerjen e këtyre veprimeve ka përfunduar abdesi.



Pasi të ketë kryer abdesin është prej praktikës profetike të lutet me këtë dua:

“Esh’hedu en la ilahe ila Allahu, la sherike leh! Ue esh’hedu ene Muhameden abduhu ue resuluh! Allahume ixh’alnij minet-teuabijne, ue ixh’alnij minel-mutetahirin!

(Dëshmoj se s’ka Zot tjetër veç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i dërguari i tij! O Allah, më bëj mua prej të penduarve dhe më bëj mua prej të pastruarve!)”

Sepse profeti -alejhi selam- na ka njoftuar se:

“Kush merr mirë abdes dhe pastaj thotë: ... (duanë e lartpërmendur), i hapen atij tetë dyert e Xhenetit që të hyjë nga cila të dojë prej tyre.”¹¹⁷



Disa veprime të rëndësishme:

E para: Është e pëlqyer për atë që merr abdes, të lajë tre herë secilën nga pjesët e trupit që lahen në abdes.

Nëse ai mjaftohet me dy, apo me një herë lejohet, por me kusht që uji të arrijë në çdo vend të asaj pjese që lahet.

E dyta: Është e pëlqyer të përdoret misvaku para abdesit.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

¹¹⁷ E transmeton Tirmidhiu.

“Sikur të mos ishte mundim për ymetin tim do i kisha urdhëruar për përdorimin e misvakut në çdo abdes.”¹¹⁸

E treta: Nuk i lejohet atij që merr abdes të përdorë shumë ujë për abdes, sepse është shpërdorim i cili nuk lejohet.

E katërta: Nuk qëndron fërkimi qafës si pjesë e abdesit, siç veprojnë shumë njerëz.

E pesta: Nuk është e saktë asnjë dua gjatë abdesit veç asaj që u përmend më lart pas përfundimit të abdesit.



Abdesi prishet me këto veprime:

1- Nëse kryen jashtëqitjen.

2- Nëse nxjerr gazra.

3- Nëse fle.

4- Nëse ha mish deveje.

Profeti -alejhi selam ka thënë:

“**Kush ha mish deveje, të marrë abdes!**”¹¹⁹

Vërejtje: Disa njerëz mendojnë se rrjedhja e gjakut e prish abdesin, por kjo nuk është e saktë, sepse rrjedhja e gjakut nuk bën pjesë të gjërave që të prishin abdesin.



I dashur djalosh mysliman!

Me këto gjëra mësove:

Si të marrësh abdes.

Cilat janë gjërat që të prishin abdesin.

¹¹⁸ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹¹⁹ Kjo thënie nuk është hadith profetik. Në hadithet profetike gjendet diçka tjetër e ngjashme: “**Është pyetur Profeti -alejhi selam-: A të marrim abdes nga grënja e mishit të deveve? Ai tha: Po**”. E transmeton Muslimi.

Mësove gjithashtu edukatën shariatike që na e ka mësuar profeti në kryerjen e nevojës.

Të gjitha këto gjëra -siç e shikon- janë shumë të rëndësishme. Tani s'të mbetet tjetër vetëm se t'i veprosh ato dhe t'ua mësosh atyre që s'i dinë.

Allahu të dhëntë sukses në punë të mira. Ai është dëgjues (i lutjes), plotësues i saj.





Namazi

Namazi konsiderohet një nga detyrat më të mëdha praktike, të cilën Allahu i madhëruar ua ka bërë obligim njerëzve.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

“Ndarja mes mohimit dhe besimit është lënia e namazit.”¹²⁰

Muslimanët janë urdhëruar t’u mësojnë fëmijëve të tyre namazin.

Profeti -alejhi selam- ka porositur:

“Mësojini fëmijëve namazin kur të bëhen shtatë vjeç dhe rrihni (nëse nuk falen), kur të bëhen dhjetë vjeç.”¹²¹



Namazi që jemi urdhëruar të falim ka: qëndrime të caktuara, fjalë të caktuara dhe kohë të caktuara.

Allahu i madhëruar thotë:

“Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.”¹²²

¹²⁰ E transmeton Tirmidhiu dhe origjina e tij është te Muslimi.

¹²¹ E transmeton Ebu Daudi.

¹²² Suretu En-Nisa: 103.

Që do të thotë: obligim që ua ka obliguar Allahu i lartësuar robëve të Tij besimtarë në kohë të shënuara e të përcaktuara. Nuk i lejohet myslimanit të shkujdeset ndaj atyre kohëve me preokupime të tjera derisa të dalë koha e ndonjë namazi e të hyjë koha e tjetrit që vjen pas tij.

Zoti ynë i madhëruar na i ka qartësuar nëpërmjet Profetit -alejhi salam- vaktet e namazit duke filluar nga namazi i sabahut deri në namazin e darkës.

Ne i njohim ato, kur dëgjojmë zërin e muezinit që thërret:

Allahu Ekber! Allahu Ekber!

Allahu Ekber! Allahu Ekber!

Esh'hedu en la ilahe ilAllah! Esh'hedu en la ilahe ilAllah!

Esh'hedu ene Muhameden resulullah! Esh'hedu ene Muhameden rasulullah!

Haj-je ales-saleh! Haj-je ales-saleh!

Haj-je al-el-felah! Haj-je al-el-falah!

Allahu Ekber! Allahu Ekber!

La ilahe ilAllah!

Po dëgjuam këtë thirrje (ezanin)¹²³, do të thotë se koha e namazit ka hyrë.



Ndërsa formën dhe veprimet që kryen namazliu gjatë faljes, jemi të urdhëruar t'i marrim nga syneti i Profetit -alejhi salam-.

Profeti -alejhi salam- thotë:

“Faluni, siç më keni parë mua të falem!”¹²⁴

¹²³ Ezani është lajmërim për hyrjen e kohës së namazit. Është e pëlqyeshme për atë që dëgjon ezanin të përsërisë fjalët pas muezinit.

¹²⁴ E transmeton Buhariu.

Kështu, myslimani i bindur ndaj Zotit të tij të madhëruar duhet ta kryejë namazin në përputhje të plotë me namazin e Profetit -alejhi selam-, në mënyrë që Zoti i madhëruar të kënaqet prej tij dhe ta shpërblejë atë mirë dhe shumë për punën e tij.



Allahu i lartmadhëruar na e ka bërë të qartë në shumë ajete të Kuranit famëlartë: mirësinë e namazit, mirësinë e ruajtjes së tij dhe gjynahun e atij që e lë, apo e neglizhon atë.

Allahu i madhëruar thotë:

“Ata që i falin namazet rregullisht. Pikërisht ata do të jenë të nderuar në kopshtet e Xhenetit.”¹²⁵

Dhe gjithashtu thotë:

“Dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.”¹²⁶

Dhe gjithashtu thotë:

“Kanë shpëtuar besimtarët. Ata të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.”¹²⁷

Kështu ne nuk do të jemi namazlinj korrektë derisa ta kryejmë namazin me bazat, kushtet, kohët dhe rregullat e tij.



Kushtet e namazit të saktë:

1- Abdesi.

E shpjeguar në temën e lartpërmendur se, kush do që të falet duhet të marrë abdes nëse nuk ka.

¹²⁵ Suretu El-Mearixh: 34-35.

¹²⁶ Suretu El-Ankebut: 45.

¹²⁷ Suretu El-Mu'mininun: 1-2.

2- Pastërtia e trupit, e rrobës dhe e vendit.

Namazliu duhet të sigurohet se trupi i tij është i pastër e nuk mban asnjë gjë të ndytë, po ashtu rrobat e tij dhe vendi ku qëndron për tu falur.

3- Drejtimi nga kibla.

Allahu i lartmadhëruar thotë:

“Ne do të të kthejmë ty nga kibla që pëlqen. Prandaj, ktheje fytyrën tënd nga Xhamia e Shenjtë (*Qabeja*)!”¹²⁸

Kibla është drejtim i njohur e i ditur.

4- Hyrja e kohës.

Asnjë namaz nuk është i saktë para hyrjes së kohës së tij, siç dhe nuk është i saktë pas daljes së asaj kohe.

Allahu i madhëruar thotë:

“Mjerë për namazlitë! Ata të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.”¹²⁹

Do të thotë: të shkujdesur ndaj tij duke e vonuar pa arsye nga koha e përcaktuar nga sheriati.

5- Mbulimi i aurretit.

Nuk lejohet që myslimani të falet i pambuluar dhe t’i duket auret i.

Çdo kusht që mungon prej këtyre kushteve e bën të pavlefshëm namazin, nëse është qëllimisht. Ndërsa, nëse ndodh nga harresa, gabimi a padija, nuk mban përgjegjësi për atë veprim, por duhet të mësojë nëse nuk di dhe të kthehet nëse gabon.



Kur këto kushte të jenë plotësuar dhe myslimani të jetë përgatitur për namaz, atëherë ai duhet të veprojë si më poshtë:

¹²⁸ Suretu el-Bekare: 144.

¹²⁹ Suretu El-Maun: 4-5.

1- Të sjellë ndërmend nijetin dhe ta bëjë atë me zemër, pa e shprehur me fjalë, për të përcaktuar numrin e rekateve dhe llojin e tyre, nëse janë farze apo sunete.

2- Pastaj të ngrejë duart deri te veshët dhe të thotë:

“Allahu Ekber! (*Allahu është më i madhi!*)”

3- Pastaj të vërë dorën e djathtë mbi të majtë, t’i vendosë ato mbi kraharor dhe të fillojë namazin me dua duke i çuar Allahut të lartësuar lëvdata dhe madhërimi si p.sh: duaja: **“Subhaneke Allahume, ue bihamdike, ue tebarakesmuke, ue teala xheduke, ue la ilahe gajruke!”**

4- T’i kërkojë mbrojtje Allahut prej Shejtanit të mallkuar **“Eudhu bilahi minesh-Shejtanirr-Rraxhijm!”** dhe të lexojë suren El-Fatiha dhe disa ajete të tjera bashkë me të si p.sh. sure të vogla.

5- Kur të ketë mbaruar nga veprimi i lartpërmendur, të ngrejë duart deri te veshët dhe të thotë: **“Allahu Ekber!”**, pastaj të bjerë në ruku duke vënë duart tek gjunjët dhe të thotë: **“Subhane rabijel-adhijm!”** tre herë.

6- Pastaj të ngrejë duart dhe të ngrihet duke thënë: **“Semi Allahu limen hamideh! Rabena ue lekel-hamd!”**

7- Pastaj të thotë **“Allahu Ekber!”** dhe të bjerë në sexhde duke vendosur duart para këmbëve. Kur të arrijë në tokë t’i vendosë mirë në sexhde: ballin, hundën, gjunjët, shuplakat e duarve dhe gishtërinjtë e këmbëve dhe të thotë: **“Subhane rabijel-eala!”** tre herë.

8- Pastaj të ngrejë kokën nga sexhdja e parë duke thënë: **“Allahu Ekber!”** dhe duart t’i vendosë te skajet e kofshëve afër gjunjëve duke thënë: **“Rabigfir lij, uerhamnij, uehdinij, ueafinij, uerzuknij!”**

9- Kur të mbarojë sexhden e parë, siç e përmendëm, të bëjë sexhden e dytë ekzaktësisht si të parën.

10- Kur të mbarojë sexhden e dytë, të ngrejë kokën dhe të ulet pak mbi këmbën e majtë të shtrirë dhe me gishtat e këmbës së djathtë të ngritura.

11- Kur myslimani të kryejë veprimet e lartpërmendura, ka mbaruar një rekat me tre bazat e tij: qëndrimi në këmbë, rukuja dhe sexhdja.

12- Pastaj në rekatën e dytë, të përsërisë ato që ka bërë në të parin dhe pasi t'i mbarojë ato, të ulet me dorën e majtë të shtriturë mbi gju dhe me gishtat e dorës së djathtë të mbledhura dhe gishtin tregues të kësaj dore të ngritur, të cilin e lëviz duke thënë: “**Etehijatu lilahi, ues-salauatu et-tajibetu.**

Es-selamu alen-Nebiji ue rahmetullahi ue berakatuhu.

Es-Selamu alejna ue ala ibadilahi es-salihine.

Eshhedu en la ilahe ilallahu, ue eshedu ene Muhameden abduhu ue rasuluhu.

Allahume sali ala Muhamedin, ue ala ali Muhamedin, kema salejte ala Ibrahimje ue ala Ali Ibrahimje! Ue barik ala Muhamedin, ue ala ali Muhammedin kema barakte ala Ibrahimje, ue ala ali Ibrahim, ineke hamijdun mexhijdun!”¹³⁰

13- Pastaj të lusë Allahun e madhëruar për çfarë të dojë nga të mirat e dynjasë e të ahiretit duke e filluar lutjen e tij me: “**Allahume inj eudhu bike min adhabi xheheneme, ue min adhabil-kabri, ue min fitnetil-mehjai uel-memati, ue min sherri fitnetil-mesijhi Ed-dexhal!**”

14- Pastaj të kthejë kokën në anën e djathtë dhe thotë: “**Es-selamu alejkum, ue rahmetullah!**” Pastaj po kështu dhe në anën e majtë.

15- Me këto veprime mbaron namazi i tij nëse është dyrekatësh.

16- Nëse janë tre apo katër rekate, atëherë të ngrihet pasi të ketë mbaruar leximin e duasë së teshehudit në rekatën e dytë duke thënë: “**Allahu Ekber!**” dhe duke ngritur duart dhe të përsërisë veprimet ku çdo rekat duhet të përmbajë: qëndrimin në këmbë, rukunë dhe sexhden.

17- Pasi të mbarojë nga rekati i tretë, apo i katërt, të ulet dhe të përsërisë në ulje leximin e atyre që ka bërë në mbarim të rekatit të dytë dhe pastaj të jepë selam.



¹³⁰ Kjo quhet duaja e teshehudit dhe salati i Ibrahimit

Prej edukatës së namazit është:

1- Namazliu të shikojë në tokë, në vendin e sexhdes dhe të mos e ngrejë shikimin lart.

2- Të mos lëvizë shumë gjatë namazit.

3- Të ruajë namazin me xhemat në xhami, sepse ai është njëzet e shtatë herë më i mirë se namazi që falet veçmas.

4- Të ruaj dhikrin dhe lutjet pas namazit si thënia: “**Estagfirullah!**” dhe thënia: “**Allahume entes-selamu ue minkes-selamu, tebarekte ja dhel-xhelali uel-ikrami!**”

5- Nëse namazliu është pas një imami, të mos veprojë asgjë nga veprimet e namazit, veçse pasi t’i ketë vepruar imami, sepse nuk i lejohet të paraprijë imamin.

6- Nëse ai harron në namaz, shton, apo pakëson, apo dyshon, të marrë për bazë më të paktën dhe pastaj të plotësojë atë që i kërkohet.

Shembull: Nëse dyshon se ke falur tre, apo katër rekate, merre treshin për bazë, pastaj fal edhe një rekat të katërt. Pasi të mbarosh duanë e teshhudit të fundit të bësh dy sexhde para selamit. Këto sexhde quhen sexhdet e harresës.



Që t’i kryesh në rregull namazet, qofshin ato farze, apo sunete, duhet të dish numrin e rekateve të farzeve dhe të suneteve:

Namazi i Sabahut ka: dy sunete dhe dy farze.

Namazi i Drekës ka: dy sunete, katër farze dhe dy sunete.

Namazi i Ikindisë ka: katër farze.

Namazi i Akshamit: tre farze dhe dy sunete.

Namazi i Jacisë ka : katër farze, dy sunete dhe tre vitër.



Nuk ka dallim mes këtyre farzeve, apo suneteve, apo vitrit vetëm se me nijet vendi i të cilit është në zemër, siç u përmend më lart.

Këto janë rregullat e përgjithshme të namazit; myslimani duhet t'i ruaj ato, të kujdeset për kryerjen e tyre dhe t'i ftojë të tjerët për t'i vepruar.

Nëse ai e bën këtë gjë atëherë ai është njeri i përkushtuar dhe Allahu do ta shpërblejë me Xhenet e do ta ruaj nga Zjarri.



NJOHURI ISLAME

për të rinjtë myslimanë

- Libri 2 -



Titulli i librit
“Njohuri Islame për të Rinjtë Myslimanë”

Përktheu
Teuta XEKA

Kontrolloi
Abdullah NABOLLI

Redaktimi gjuhësor
Sara FAHEM

Ballina & Faqosja
Pelegri



Boton: “Udha e Besimtarëve”

Botimi i parë
Tiranë, 2020



Parathënie

Lëvdatat i takojnë Allahut! Paqe e përshëndetje çojmë mbi prijësin e profetëve, mbi familjen e tij dhe mbi gjithë shokët e tij!

Në vijim:

I dashur djalosh mysliman!

Ky libër përmbledh një seri broshurash edukative nëpërmjet së cilës do të njihesh me Islamin, fenë tënde, në të cilën ke lindur dhe nën rregullat e së cilës je rritur. Nëpërmjet tyre do të mësosh gjërat më të rëndësishme që t'i ka bërë detyrë krijuesi yt i madh, Allahu, dhe do të njihesh gjithashtu me historinë dhe traditën e profetit tënd të shtrenjtë, Muhamedit, dhe çdo gjë që ka lidhje me to: besime, marrëdhënie, adhurime dhe morale.

Vlera e kësaj serie qëndron te bashkimi i saj mes cilësisë së njohurive dhe thjeshtësisë së stilit në shkrim, çka të bën ta kuptosh mirë atë pa pasur nevojë të kërkosh ndihmën e familjes, apo të afërmeve, veçse në ndonjë rast të rrallë.

Së fundi:

Lus Allahun e Madhëruar që të të bëjë dobi me të, sepse Ai është dëgjuesi i lutjeve dhe Ai që u përgjigjet atyre.

Autori



Dija (Ilmi)

Dija apo “*Ilmi*” është njohja e asaj që ke për qëllim të kuptosh, duke u ndalur në cilësitë dhe domethëniet e saj ashtu siç janë në realitet.

Dija mund të quhet edhe **njohuri** (*marife*), sepse kush ka njohur diçka e ka ditur atë¹.

Ndërsa **të kuptuarit** (*fehmi*) është gradë më e lartë se dija.

Allahu i madhëruar thotë:

«**Ne e bëmë çështjen ta kuptonte Sulejmani dhe secilit i dhamë mençuri e dije.**»²

Pra, Allahu i madhëruar i ka dhënë të kuptuarit, vend më të lartë se dija, sepse ai e përmban atë dhe pak më tepër.

Ndërsa **të konceptuarit**, (*fikhu*) është gradë më e lartë se sa të kuptuarit, sepse ai përveç të kuptuarit është kapja e qëllimit të folësit dhe synimit të tij nga fjala që thotë.

Allahu e ka theksuar këtë si mangësi të hipokritëve, të cilët nuk arrijnë të konceptojnë domethënien e fjalëve dhe qëllimet e tyre, kur thotë:

«**Ata kanë zemra me të cilat nuk konceptojnë.**»³

¹ Kanë thënë disa dijetarë: Dija është më e qartë se ç’mund të përkufizohet.

² Suretu El-Enbija: 79.

³ Suretu El-Earaf: 179.



Dija, e cila është për qëllim në hadithin e profetit -alejhi selam-:

«**Kërkimi i dijes është detyrë për çdo mysliman.**»⁴ dhe tek fjala e tij -alejhi selam-:

«**Profetët nuk kanë lënë trashëgimi, as ar e as argjend, por kanë lënë trashëgimi dijen. Kush e nxë atë, ka fatin e madh.**»⁵, është dija e sheriatit.

Ajo është dija, të cilën Allahu i madhëruar ia ka zbritur të Dërguarit të Tij -alejhi selam-, prej udhëzimeve të dy shpalljeve të lavdishme, Kuranit dhe Sunetit.

Kjo lloj dijeje është detyrë për çdo mysliman, për shkak të punëve të mira me të cilat është ngarkuar si: namazi, agjërimi etj.



Ndërsa dija e çështjeve të kësaj bote si: industria, bujqësia, biznesi etj., është detyrë për disa individë të shoqërisë së myslimanëve për të mbuluar nevojat e gjithë bashkësisë së tyre në lidhje me këto fusha.

Sipas kësaj domethënieje duhet kuptuar fjala e profetit -alejhi selam-:

«**Ju i dini më mirë çështjet tuaja të kësaj bote.**»⁶



Nxënia e dijes është nga veprat më të mira dhe nga adhurimet më fisnike, me të cilat njeriu afrohet tek Allahu i madhëruar. Madje ajo është një nga llojet e luftës në rrugë të Allahut, siç ka thënë Allahu i lartmadhëruar në Kuran për Kuranin:

«**Luftoju fort ata me të** (*d.m.th.: me Kuranin!*)»⁷

⁴ E transmeton Ibn Maxhe.

⁵ E transmeton Ibn Maxhe.

⁶ E transmeton Muslimi.

⁷ Suretu El-Furkan: 52.

Kjo luftë me dije e bën të madh dallimin mes dijetarit dhe të tjerëve, siç ka thënë Allahu i madhëruar:

«Thuaj, a barazohen ata që dinë me ata që nuk dinë?!»⁸

Dijetarët thonë:

“Nuk barazohet ai që di me atë që nuk di, siç nuk barazohet i gjalli me të vdekurin, ai që dëgjon me të shurdhin dhe ai që shikon me të verbrin.

Dija është ndriçim me të cilën njeriu udhëzohet dhe del nga errësitrat në dritë.

Me dije, Allahu ngre kë të dojë nga robtë e Tij, siç thotë në Kuran:

«Allahu i ngre ata që besuan prej jush dhe ata që iu është dhënë dija në grada të larta.»⁹

Prandaj gjejmë se dijetarët janë gjithmonë objekt lavdërimi. Ata sa herë që përmenden, njerëzit i lavdërojnë. Kjo është ngritje për ta në dynja, ndërsa në ahiret ata ngrihen në grada sipas përpjekjes së tyre në rrugë të Allahut dhe punëve që kanë vepruar.”



Dija është themeli i të gjitha punëve duke filluar nga teuhidi (*njësimi*) dhe akidja (*besimi*), sepse Allahu i madhëruar thotë:

«Dije se s’ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe kërko falje për mëkatin tënd!»¹⁰

Për të përfshirë më pas të gjitha punët, siç ka thënë profeti -alejhi salam-:

«Veprat janë sipas nijetit.»¹¹

Ai që nuk di, nuk mundet, as ta kontrollojë nijetin e tij, as ta përcaktojë atë dhe as të njohë rregullat dhe llojet e tij.

⁸ Suretu Ez-Zumer: 9.

⁹ Suretu El-Muxhadile: 11.

¹⁰ Suretu Muhamed: 19.

¹¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Ai që nuk di, nuk mundet të kryejë atë që ia kërkon teuhidi (*njësimi*) i Allahut të lartmadhëruar, ashtu siç e do Allahu.

Ai gjithashtu nuk mundet, as të falë namazin si namazi i profetit -alejhi selam- i cili ka thënë: «**Faluni, siç më kemi parë mua të falem!**»¹², as të japë zekat siç na ka mësuar profeti -alejhi selam- dhe as të bëjë haxhin siç e ka bërë profeti -alejhi selam-, i cili ka thënë: «**Merrni prej meje ritet¹³ tuaja!**»¹⁴



Nxënësi i dijes ka disa norma të rëndësishme në lidhje me veten e tij.

Prej tyre janë:

** Pastrimi i nijetit për Allahun e madhëruar.*

Siç ka thënë i Madhëruari:

«**Ata nuk qenë urdhëruar, veçse të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë.**»¹⁵

** Largimi i injorancës prej vetes së tij dhe prej të tjerëve.*

Siç ka thënë i Madhëruari:

«**Allahu ju nxori ju prej barkut të nënave tuaja dhe ju nuk dinit asgjë.**»¹⁶

Ai që ka për qëllim largimin e injorancës nga vetja e vet dhe nga të tjerët, futet në rrethin e kërimit të dijes dhe të mësimin të fesë.

Nëse ai i përmbush këto dhe bëhet prej të dijsshmëve, atëherë dija e tij rreth Zotit i jep drojë ndaj Tij, frikë prej dënimit të Tij dhe zbatim

¹² E transmeton Buhariu.

¹³ D.m.th: veprimet e Haxhit; bazat, detyrat dhe sunetet e tij.

¹⁴ E transmeton Muslimi.

¹⁵ Suretu El-Bejine: 5.

¹⁶ Suretu En-Nahl: 78.

të urdhrave të Tij për të qenë më i frikësuari i njerëzve ndaj Allahut të madhëruar, siç thotë Allahu:

«**I frikësohen Allahut prej robëve të Tij dijetarët.**»¹⁷

** Të punuarit me dijen.*

Dija është pemë, frytet e të cilës janë veprat.

Ajo përfshin: akiden, adhurimin, moralin, etikën dhe marrëdhëniet e ndërsjella.

Profeti -alejhi selam- ka thënë: «**Kurani është argument, ose për ty, ose kundër teje.**»¹⁸

Për ty: nëse vepron sipas udhëzimit dhe urdhrave të tij.

Kundër teje: nëse nuk vepron me të dhe nuk udhëzohesh me urdhrat e tij.

** Thirrja (daveti) për tek Allahu i madhëruar.*

Sepse ajo është dija më e mirë dhe më fisnike:

«**Kush e ka fjalën më të mirë se sa ai që thërret për tek Allahu, bën vepra të mira dhe thotë: unë jam prej myslimanëve?**»¹⁹

Apo ajeti:

«**Thuaj, kjo është rruga ime! Thërras për tek Allahu me qartësi (basira), unë dhe kush më ndjek mua.**»²⁰

Fjala [**me qartësi, apo basira**] do të thotë dije dhe dija më e madhe është dija e Kuranit dhe e Sunetit, siç ka thënë profeti -alejhi selam-:

«**Ju kam lënë dy gjëra, të cilave nëse i përmbaheni, kurrë nuk kenit për të humbur: librin e Allahut dhe sunetin tim.**»²¹

¹⁷ Suretu El-Fatir: 28.

¹⁸ E transmeton Muslimi.

¹⁹ Suretu Fusilet: 33.

²⁰ Suretu Jusuf: 108.

²¹ E Transmeton Hakimi.



Nxënësi i dijes ka disa norma edhe me mësuesin, apo profesorin e tij.

Prej tyre janë:

**Të durojë në nxënien e dijes prej mësuesit të tij.*

Kjo gjë arrihet duke këmbëngulur në kërkimin e dijes, pa u mërzitur, pa e ndërprerë atë dhe pa i bërë mërziçjes vend në veten e tij e as rrugë për në mendjen e tij.

Atë nuk e arrin nxënësi vetëm se me durim -së pari- me mësuesin dhe profesorin e tij, pastaj moshumbja e shpresës nga kërkimi i dobisë dhe përfitimi prej tij.

Profeti -alejhi selam- thotë:

«**Kush përpiqet të bëjë durim, i jep durim Allahu!**»²²

** Respektimi i mësuesit dhe vlerësimi i tij.*

Siç ka thënë profeti -alejhi selam-:

«**Nuk është prej nesh kush nuk mëshiron të voglin, nuk respekton të madhin dhe nuk i njeh të dijsmit hakun e tij.**»²³

Mësuesi zakonisht i plotëson këto dy cilësi: moshë të madhe dhe dije të gjerë, çka e bën të meritojë respekt dhe kujdes ndaj tij.



Kërkimi i dijes ka disa faktorë ndihmues, ku më të rëndësishmit janë:

1- Frika prej Allahut (Takuaja).

Ajo do të thotë: të bëjë njeriu mburojë mes tij dhe asaj që i frikësohet prej zemërimit të Zotit, që ta ruajë prej tij, duke vepruar vepra të mira dhe duke iu larguar mëkateve.

²² E transmeton Buhariu.

²³ E transmeton Ahmedi.

Frika apo *takuaja* është një nga çelësat e dijes, portat dhe shkaqet e saj, siç ka thënë Allahu i madhëruar:

«O ju që keni besuar, nëse i frikësoheni Allahut, ai do t'ju japë juve dallim (*furkan*).»²⁴

Dallimi apo *furkani* është aftësia për të dalluar të vërtetën nga e kota, të mirën nga e keqja dhe udhëzimin nga humbja.

Më e rëndësishmja dhe më e para që mund të futet në kuptimin e kësaj fjale është dija.

2- *Shoqërimi me dijetarët.*

Kjo, sepse shoqërimi me dijetarët është rrugë e sigurt dhe e çon nxënësin në bregun e sigurisë, larg moskuptimit dhe keqkuptimit, plus faktit që edukohet prej tij dhe pajiset me cilësitë dhe moralin e tij.



Nga gjërat që duhet të ketë kujdes nxënësi i dijes që të largohet dhe distancohet janë:

* *Smira.*

Smirë do të thotë: urrejta e mirësisë që i ka bërë Allahu disa robve të tij prej kolegëve dhe shokëve të nxënësit.

I dërguari i Allahut -alejhi selam- thotë: «**Nuk beson ndonjëri nga ju derisa ta dojë të mirën për vëllain e tij, siç e do atë për veten e tij.**»²⁵

Ilaçi i kësaj sëmundjeje është përpjekja e myslimanit që të jetë në këtë mirësi si vëllai i tij dhe pastaj të dojë vazhdimësinë e kësaj mirësie për të dhe ta falënderojë Zotin për çdo gjendje.

* *Të flasë pa dije.*

Fjala pa dije në çështjet e kësaj bote është diçka e qortuar dhe e kritikuar.

²⁴ Suretu El-Enfal: 29.

²⁵ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Nuk flet mjeku në zanatin e inxhinierit.

Nuk flet muratori në profesionin e mësuesit.

Nuk flet kuzhinieri në punët e bujkut.

E kështu me radhë.

Atëherë, si mund të jetë çështja kur bëhet fjalë për dijen e shariatit dhe të fesë?!

Allahu i madhëruar thotë:

«Mos thoni me gjuhët tuaja të rreme: “Kjo është e lejuar e kjo e ndaluar!”, që kështu të trilloni gënjeshtër për Allahun.»²⁶

Dhe po ashtu thotë:

«Mos rend pas asaj për të cilën nuk ke dije. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, për të gjitha këto do të mbahet përgjegjësi.»²⁷

Kur Allahu i madhëruar i ka përmendur në Kuranin famëlartë veprat e ndyra për të na tërhequr vërejtjen për to, ka përmendur mes tyre:

«... dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini.»²⁸

** Mendjemadhësia.*

Ajo është cilësi e keqe dhe e ulët që përzihet me shpirtrat e dobët, sepse shejtani i pëshpërit atij që e ka atë ves, se me mendjemadhësi ngrihesh, ndërkohë që në të vërtetë ulet dhe zvogëlohet!

Profeti -alejhi selam- thotë:

«**Mendjemadhësia është refuzimi i së vërtetës dhe përçmimi i njerëzve.**»²⁹

²⁶ Suretu En-Nahl: 116.

²⁷ Suretu El-Isra: 36.

²⁸ Suretu El-Earaf: 33.

²⁹ E transmeton Muslimi.

Për shkak të mendjemadhësisë Iblisi është bërë nga të mallkuarit, siç ka thënë Allahu i madhëruar:

«Përveç Iblisit, i cili refuzoi e u tregua mendjemadh dhe ishte prej mohuesve.»³⁰



I lumtur prej nxënësve të dijes është ai që pajiset me moral të lartë, edukohet me virtyte të larta, i largohet veprimeve të këqija dhe ruhet nga punët e kota duke u kujdesur fort për sinqeritetin, kapjen pas syneve dhe të punuarit me dijen.

O Allah, na furnizo ne me dije, na jep sukses në vepra dhe na zbukuro ne me edukatë!



³⁰ Suretu El-Bekara: 24.



Agjërimi i Ramazanit

Agjërimi është një prej detyrave më të rëndësishme të Islamit dhe një prej shtyllave madhore të tij.

Allahu i madhëruar thotë:

«O ju që besuat, ju është shkruar juve agjërimi, ashtu siç u ishte shkruar atyre që ishin para jush me qëllim që të ruheni.»³¹

Dhe po ashtu thotë:

«Muaji i Ramazanit është ai në të cilin zbriti Kurani, udhëzim për njerëzit, qartësues i udhës së drejtë dhe dallues i së mirës nga e keqja. Prandaj, kush prezanton prej jush në këtë muaj ta agjërojë atë!»³²

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se s'ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i tij, falja e Namazit, dhënia e Zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe Haxhi në shtëpinë e shenjtë për atë që ka mundësi.»³³



³¹ Suretu El-Bekare: 183.

³² Suretu El-Bekare: 185.

³³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Agjërimi ka shumë të mira fetare, prej tyre:

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**Xheneti ka një derë që quhet Rejan, nëpërmjet së cilës do të hyjnë agjëruesit ditën e Kiametit dhe nuk hyn në të tjetërkush veç tyre. Ata pasi të futen, ajo do të mbyllet dhe nuk ka për të hyrë më njeri nëpërmjet saj. Kush hyn nëpërmjet saj do të pijë dhe kush pi nuk ka për të ndërë më etje kurrë.**»³⁴

Dhe ka thënë:

«**Kur vjen Ramazani, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Zjarrit dhe lidhen shejtanët.**»³⁵

Dhe gjithashtu ka thënë:

«**Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë, i falen atij mëkatet e kaluara.**»³⁶

Fjala e tij “**me besim dhe shpresë**” do të thotë: me besim në gjykimin e Tij (*Allahut*), duke shpresuar shpërblimin prej Tij dhe duke iu bindur Zotit të tij.



Detyra e agjërimit i kërkohet myslimanit kur të rritet dhe bëhet i aftë për t’u ngarkuar me detyra dhe adhurime, që ta ketë të mundshëm zbatimin dhe kujdesin për to.

Ndërsa, nëse është fëmijë ose pak më i rritur, por pa arritur moshën e pjekurisë, nuk e ka detyrë agjërimitin.

Por, nëse përpiqet të agjërojë për t’u mësuar dhe për t’iu bërë i dashur -edhe nëse është me nxitjen e prindërve- nuk ka pengesë për këtë.

Rubeja e bija e Muauidhit, -e cila është sahabije- ka thënë: «*I shtynim fëmijët tanë të agjëronin dhe i çonim në xhami. U bënim lodra prej leshi*

³⁴ E transmeton imam Ahmedi.

³⁵ E transmeton Muslimi.

³⁶ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

që nëse ndonjëri prej tyre do të qante për ushqim t'ia jepnim atë dhe kështu vepronim deri në iftar.»³⁷



Agjërim nga ana gjuhësore do të thotë: “*Ndalim*”.

Ndërsa në shariat është: “*Lënia e ngrënies, pirjes dhe e çdo gjëje tjetër që e prish agjërimin, për një ditë të plotë nga lindja e qartë e agimit deri në perëndim të plotë të diellit*”.

Për agjërim duhet patjetër që nijeti i adhurimit të bëhet gjatë natës deri para agimit me qëllim dhe vendosmëri në zemër.



Është e pëlqyer për myslimanin të bëjë syfy gjatë natës për agjërimin e tij duke u zgjuar para agimit për të ngrënë diçka prej ushqimit ditën që do të agjërojë, qoftë dhe hurma arabe, apo ujë që të forcohet për ditën e agjërimin të tij, si zbatim i asaj që ka ardhur në lidhje me dobinë e syfyrit në Sunetin e pastër.

Një nga shokët e profetit -alejhi selam- ka thënë: «*Hyra tek profeti -alejhi selam- kur ai po hante syfyr dhe më tha: “Syfyri është begati që jua ka dhënë Allahu, prandaj mos e lini!”*»³⁸



Agjërimi ka një veçanti në krahasim me adhurimet e tjera, në aspektin se ai është punë e fshehtë, të cilën nuk e di tjetërkush përveç Allahut të madhëruar që do të thotë se nuk e di kush prej krijesave realitetin e saj dhe as e shikon dot atë.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Allahu ka thënë: Çdo vepër e birit të Ademit është për të dhe ajo i shumëfishohet nga një e mirë me dhjetë të tilla deri në shtatëqind, përveç agjërimin. Ai është për mua dhe unë shpërblej për të.»³⁹

³⁷ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

³⁸ E transmeton Nesai.

³⁹ E transmeton Muslimi.



Myslimani kur agjëron, nuk agjëron vetëm nga ngrënia dhe pirja, por agjëron gjithashtu edhe nga veprat dhe fjalët e këqija.

Profeti -alejhi salam- ka thënë: «**Kush nuk e lë fjalën e kotë dhe veprën me të, Allahu nuk ka nevojë që të ai të lërë ngrënien dhe pirjen.**»⁴⁰

Ali bin Ebi Talibi -radiallahu anhu- ka thënë: “*Agjërimi nuk është (largimi vetëm) nga e ngrëna dhe e pira, por (edhe) nga gënjeshtria, e kota dhe e pavlera.*”⁴¹

Xhabir bin Abdullahi -radiallahu anhuma- ka thënë: “*Kur të agjërosh le të agjërojë me ty dëgjimi yt, shikimi yt dhe gjuha jote nga gënjeshttrat dhe mëkatet! Lëre keqtrajtimin e shërbëtorit dhe qëndro i sjellshëm dhe me qetësi gjatë ditës së agjërimit! Mos e bëj ditën e agjërimit dhe të çeljes njësoj!*”⁴²



Është traditë që myslimanët në muajin e Ramazanit të falin njëmbëdhjetë rekate namaz nate (*teravi*) pas farzit (*të jacisë*) në ndjekje të praktikës së profetit -alejhi salam- .

Profeti -alejhi salam- ka thënë: «**Kush ngrihet për namaz nate në Ramazan me besim dhe shpresë i falen atij gjynahet e kaluara.**»⁴³

Nëna e besimtarëve Aishja -radiallahu anha- ka thënë: “*Nuk ka shtuar i dërguari i Allahut, as në Ramazan dhe as jashtë tij mbi njëmbëdhjetë rekate.*”⁴⁴



⁴⁰ E transmeton Buhariu.

⁴¹ E transmeton Ibn Ebij Shejbe.

⁴² E transmeton Ibn Ebij Shejbe.

⁴³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁴⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Agjërimi ka dobi të mëdha, të cilat i bëjnë dobi myslimanit në fenë dhe dynjanë e tij. Prej tyre janë:

-Fitimi i Xhenetit dhe shpëtimi prej Zjarrit.

-Pastrimi i shpirtit dhe ruajtja e trupit.

-Arritja e dashurisë së Allahut të madhëruar duke kryer urdhrin e Tij.

-Ndjenja se je më pranë vëllezërve myslimanë prej të varfërve, të uriturve dhe atyre që nuk kanë mundësi të fitojnë jetesën.

-Largimi nga mëkatet dhe gjynahet.

O Allah na e bëj të lehtë agjërimin, na ndihmo për namaz nate dhe na ndero me edukatën islame!





Zekati

Zekati (*lëmosha e zekatit*) është një prej farzeve të rëndësishme të Islamit dhe një prej shtyllave të mëdha të tij.

Allahu i madhëruar thotë: «Falni Namazin dhe jepni Zekatin! Çfarëdo të mirë që të bëni për veten tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Në të vërtetë, Ai sheh mirë gjithçka që bëni.»⁴⁵

Dhe thotë: «Ata që besuan dhe kryen vepra të mira, falën Namazin dhe dhanë Zekatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre. Ata nuk kanë për të pasur frikë dhe as do të brengosen.»⁴⁶

Dhe thotë: «Kujdestari juaj është vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin Namazin, japin Zekatin dhe janë të përlulur ndaj Allahut.»⁴⁷

Dhe thotë: «Unë godas me dënimin Tim kë të dua, ndërsa mëshira Ime përfshin çdo gjë. Atë do t'ua shkruaj atyre që ruhen nga gjynahet, e japin Zekatin dhe atyre që u besojnë shpalljeve Tona.»⁴⁸

Profeti -alejhi selam- ka thënë: «**Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se s'ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe se**

⁴⁵ Suretu El-Bekare: 110.

⁴⁶ Suretu El-Bekare: 277.

⁴⁷ Suretu El-Maide: 55.

⁴⁸ Suretu El-Earaf: 156.

Muhamedi është i dërguari i tij, falja e Namazit, dhënia e Zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe Haxhi në shtëpinë e shenjtë për atë që ka mundësi.»⁴⁹



Zekati ka mirësi të shumta fetare, prej tyre:

Ebu Umame -radiallahu anhu- thotë: *«Kam dëgjuar profetin -alejhi selam- duke mbajtur hytben në haxhin e lamtumirës dhe tha: “Frikësojuni Allahut, Zotit tuaj, falni pesë namazet, agjëroni muajin e Ramazanit, jepni Zekatin e pasurisë dhe bindjuni atij që drejton çështjet tuaja, që të hyni në Xhenetin e Zotit tuaj!”»⁵⁰*

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: **«Nëse e jep Zekatin e pasurisë, e ke kryer detyrën tënde.»⁵¹**

Xherir bin Abdullah El-Bexhelij -radiallahu anhu- tregon: *«I kam dhënë besën profetit -alejhi selam- për faljen e Namazit, dhënien e Zekatit dhe këshillimin e çdo myslimani.»⁵²*

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: **«Nuk e ka pakësuar ndonjë sadaka pasurinë, nuk i shton Allahu njeriut kur fal vetëm se krenari dhe nuk tregohet njeri modest për hir të Allahut vetëm se e ngre atë Allahu.»⁵³**

Hakim bin Hizami -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: **«Dora që jep është më e mirë se dora që merr dhe fillo me ata të cilët i ke nën kujdestari. Sadakaja më e mirë është nga ajo që të tepron. Kush e lë lypjen, e nderon atë Allahu dhe kush mjaftohet me aq sa ka, i jep atij Allahu.»⁵⁴**

⁴⁹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁵⁰ E transmeton Tirmidhiu dhe Ahmed.

⁵¹ E transmeton Hakimi, Bejhakiu etj.

⁵² E transmeton Buhariu dhe Muslimi

⁵³ E transmeton Muslimi.

⁵⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.



Zekati i bëhet detyrë myslimanit kur të rritet e të bëhet burrë dhe të ngarkohet me detyra dhe adhurime, atëherë kur ka mundësi t'i kryejë ato dhe e posedon pasurinë që Allahu i madhëruar ia ka bërë detyrë zekatin, i cili është e drejtë e veçantë e të varfërve dhe e nevojtarëve.

Nuk është detyrë për të voglin -jetim qoftë ky, apo jo- zekati i pasurisë së trashëguar, apo të rezervuar për të.



Zekat në përdorimin gjuhësor do të thotë: “Rritje, shtim dhe pastrim”, siç ka thënë Allahu i madhëruar:

«Merr nga pasuria e tyre sadaka që t'i pastrosh ata me të dhe t'i dëlirësh.»⁵⁵

Sadakaja e përmendur këtu është Zekati i obliguar.

Dijetarët e tefsirit thonë:

«Origjina e fjalës zekat është shtimi që arrihet nga begatia e Allahut të madhëruar, e cila merret në konsideratë, si në çështjet e dynjasë, ashtu edhe në ato të ahiretit, dhe thuhet: bënë zekat të mbjellat kur rriten dhe zhvillohen

Nga ky përdorim është marrë fjala zekat për atë që jep njeriu si detyrë prej Allahut për të varfrit dhe është quajtur kështu, ose që të shpresohet prej saj bereqet, ose për pastrimin e shpirtit (d.m.th frymëzimi i tij për të mira dhe begati), ose për të dyja së bashku, sepse ajo i përmban të dyja mirësitë.»

Ndërsa zekati si term shariatik (përdorimi fetar i fjalës) është: “Ajo pjesë e pasurisë që e bën detyrë sheriati t'u jepet të varfërve dhe përmban kushte të caktuara”.



Zekati nuk i jepet vetëm se njerëzve të posaçëm, të cilët Allahu i madhëruar i ka përmendur në Kuranin famëlartë:

⁵⁵ Suretu Et-Teube: 103.

«Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që punojnë për të, për ata që doni t’ua fitoni zemrat, për lirimin e robërve, për borxhlinjtë, për rrugën e Allahut dhe për të mbeturin në rrugë. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijsëm dhe i Urtë.»⁵⁶

[**Të varfrit**] janë ata që nuk kanë asgjë për të mbajtur shpirtin gjallë dhe as për të mbuluar nevojat e tyre.

[**Nevojtarët**] janë ata që kanë sa për të mbajtur shpirtin gjallë, por nuk i mbulojnë dot nevojat e tyre.

[**Ata që punojnë për të**] janë ata që mbledhin zekatin, administrojnë çështjen e tij dhe kujdesen për të.

[**Robërit**] janë skllëverit që janë në pronësinë e zotërinjve të tyre.

[**Atyre që duam t’ua fitojmë zemrat**] janë jomyslimanët, të cilëve u jepet nga pasuria e zekatit për t’i nxitur në Islam dhe për t’i tërhequr në fe.

[**Borxhlinjtë**] janë ata që i kanë rënduar borxhet të cilat, as nuk mund t’i shlyejnë dhe as mund t’i mbajnë.

[**Në rrugën e Allahut**] do të thotë lufta e ligjësuar për t’u përballur me armiqtë e Allahut të madhëruar.

[**I mbeturi në rrugë**] është ai që i janë ndërprerë mundësitë e lëvizjes dhe gjendet larg vendit të tij.



Allahu i madhëruar thotë: «Ata që fshehin arin dhe argjendin dhe nuk i shpenzojnë ato në rrugë të Allahut, përgëzoji me dënim të dhembshëm * Ditën, kur ato të nxehen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to t’u damkosen ballët, anët dhe shpinat e tyre e t’u thuhet: “Kjo është ajo që keni depozituar për veten; pra, shijoni atë që depozituat!”»⁵⁷

⁵⁶ Suretu Et-Teube: 60.

⁵⁷ Suretu Et-Teube: 34-35.

Ibën Umeri -radiallahu anhuma- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Ai që nuk e jep zekatin e pasurisë së tij do t'i paraqitet pasuria e tij ditën e Kiametit në formën e gjarprit me dy pika të zeza në ballë, i cili e mbërthen atë, apo e lidh dhe i thotë: Unë jam thesari yt, unë jam thesari yt.»⁵⁸

Umeri -radiallahu anhuma- ka thënë:

«Pasuria, së cilës nuk i jepet zekati, është fshehje e saj.»

Aliu -radiallahu anhu- ka thënë:

«E ka mallkuar profeti -alejhi selam- atë që nuk e jep Zekatin.»

Burejda -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Nuk e pengon ndonjë popull Zekatin, vetëm se e sprovon Allahu me sezone të thata.»⁵⁹

[**Sezone të thata**] do të thotë pengimi i shiut, mosrënia e tij dhe pasojat që vijnë prej saj si zia e bukës.

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Nuk ka ndonjë pronar ari ose argjendi, i cili nuk ua jep atyre hakun, vetëm se ato, ditën e Kiametit do t'i bëhen pllaka të zjarrta. Ato do të nxehen në zjarrin e Xhehenemit dhe do t'i damkosen me to ana, balli dhe shpina e tij. Sa herë që të ftohen, kthehen sërish (për t'u nxehur) “në një ditë, gjatësia e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet”, derisa të gjykohet mes njerëzve dhe të shihet udha e tij, ose për në Xhenet, ose për në Zjarr ...»⁶⁰



⁵⁸ E transmeton Buhariu, Muslimi, Ibn Maxhe etj

⁵⁹ E transmeton Taberani.

⁶⁰ E transmeton Buhariu, Muslimi etj.

Zekati merret nga kategori të caktuara pasurie, për të cilat ka argumente nga sheriati -dhe me masë të caktuar- .

1- Monedhat. D.m.th. paratë.

2- Devetë, lopët dhe bagëtitë e imëta.

3- Drithërat si: gruri, elbi e të tjera të ngjashme.

4- Mjalti.

5- Thesaret. Dhe janë ato që gjenden të fshehura në tokën e myslimanëve prej pasurive të njerëzve të kohës paraislame.

6- Mallrat e tregtisë.



Këto kategori dhe çdo lloj tjetër i ngjashëm me to, nëse arrijnë masën e caktuar nga sheriati, bëhet detyrë zekati i tyre.

Nuk bëhet detyrë zekati i monedhave -d.m.th. i parave-, vetëm nëse ato arrijnë masën e përcaktuar nga sheriati dhe që është sasi e caktuar me vlerë afërsisht 85 gramë ar dhe pasi të kenë kaluar një vit të plotë nën pronësinë e tij.

Pasuria është mirësi për pronarin e saj, nëse ai e përdor atë për mirë dhe punë të ndershme.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Sa e mirë, është pasuria e mirë, për njeriun e mirë!»⁶¹



Zekati, nuk i jepet dikujt që ka pasuri dhe as atij që është i fortë dhe është në gjendje të punojë.

Profeti -alejhi selam- ka thënë: **«Nuk e ka hallall sadakanë i pasuri dhe as ai që është i fortë e i shëndetshëm.»⁶²**



⁶¹ E transmeton Ahmedi.

⁶² E transmeton Tirmidhu dhe Ebu Daudi.

Zekati ka dobi të mëdha, prej të cilave myslimani përfiton në Dynja dhe në Ahiret. Prej tyre janë:

- Praktikimi i shariatit dhe zbatimi i gjykimeve të tij.
- Çlirimi i pasurisë nga të drejtat e të tjerëve në të.
- Mbrojtje e vetes nga koprracia.
- Ndjenja e afrimit me të varfrit dhe nevojtarët dhe ndihmesa e tyre.
- Shtimi dhe rritja e pasurisë.
- Vërtetimi i falënderimit të Allahut të madhëruar për mirësitë e Tij.
- Forcimi i lidhjeve dhe marrëdhënieve mes individëve të të gjithë ymetit.
- Largimi i dënimit të Allahut dhe sjellja e mirësive të Tij.
- Kthjelltësia në Dynja dhe shpëtimi në Xhenet.

O Allah na i mbulo nevojat, na e shto (*pasurinë*), na jep sukses (*në punë të mira*), na përforco (*në fe*) dhe bëje Dynjanë në duart tona dhe jo në zemrat tona!





Haxhi (Vizita e Qabesë)

Haxhi, apo “*Vizita e Qabesë*” është një nga detyrat e rëndësishme të Islamit dhe një nga shtyllat e tij të mëdha.

Allahu i madhëruar thotë: «Për hir të Allahut është bërë detyrë për njerëzit haxhi i Shtëpisë së Shenjtë, për këdo që ka mundësi ta marrë atë rrugë. E kush mohon, ta dijë se Allahu nuk ka nevojë për askënd!»⁶³

Profeti -alejhi selam- ka thënë: «**Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se s’ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i tij, falja e Namazit, dhënia e Zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe Haxhi në shtëpinë e shenjtë për atë që ka mundësi.**»⁶⁴



Detyra e Haxhit i obligohet myslimanit kur të rritet dhe të ngarkohet me punë dhe adhurime. Ndërsa, nëse është fëmijë i vogël, apo i madh, por pa arritur moshën e pjekurisë, nuk e ka detyrë Haxhin. E nëse prindërit e ndihmojnë atë për haxh, haxhi i tij është i saktë dhe prindërit për haxhin e tij kanë shpërblim.

Ibën Abasi -radiallahu anhu- tregon: «*Një grua ngriti një fëmijë tek*

⁶³ Suretu Ali Imran: 97.

⁶⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

*profeti -alejhi selam- dhe e pyeti: A ka haxh për këtë? Profeti -alejhi selam- i tha: “Po. Dhe ti ke shpërblim.”*⁶⁵

Dhe kur i vogli bëhet burrë, i bëhet detyrë Haxhi sipas kushteve të konsideruara nga sheriatu.



Kushtet e detyrës së Haxhit janë:

- 1- Mundësia për të arritur në Mekë dhe për të kryer atje Haxhin.
- 2- Vlera monetare që i mundëson atij udhëtimin dhe kryerjen e detyrave të Haxhit.

Ky është dhe kuptimi i fjalës së Allahut të madhëruar: “... për këdo që ka mundësi ta marrë atë rrugë.”

Ndërsa kuptimi i fjalës së Tij: “... E kush mohon, ta dijë se Allahu nuk ka nevojë për askënd!” është: kush nuk e pranon detyrën e Haxhit dhe as kapet pas saj, ka mohuar dhe ka dalë nga feja islame.

Allahu i lartmadhëruar nuk ka nevojë për këtë njeri mohues dhe as për të gjitha botët, njerëz qofshin ata, melaike, apo xhinë. Përkundrazi, ata të gjithë kanë nevojë për të -subhanehu- dhe Ai s'ka nevojë për ta.



Fjala “**Haxh**” nga ana gjuhësore do të thotë: “Synimi i një gjëje”.

Ndërsa “**Haxh**” në kuptimin shariatik do të thotë: “Angazhimi në veprime dhe fjalë të caktuara, të cilat myslimani i bën në ditë të caktuara dhe në një vend të caktuar”.

Nga këto veprime, më të rëndësishmet janë:

a-Ihrami për haxh; që është nijeti me zemër për vendosmërinë e kryerjes së punëve të haxhit duke e shoqëruar me telbije.

Telbija e haxhit është fjala: “**Lebbejke Allahumme bil-Haxhxi** (Të përgjigjem ty, o Allah, me Haxh!)”

⁶⁵ E transmeton Muslimi.

Kuptimi i fjalës lebejke është: I përgjigjem urdhrit tënd, o Allah!

Muslimani gjatë telbijes thotë:

“Lebbejke Allahumme, lebbejke! Lebbejke la sherike leke, lebejke! Innel-hamde uen-ni’mete leke uel-mulke, la sherike leke!

(Të përgjigjem ty, o Allah, të përgjigjem! Të përgjigjem ty dhe ti s’ke ortak! Lavdia është e jotja, mirësia dhe sundimi dhe ti s’ke ortak!)”

Ai me këtë telbije deklaron sinqeritetin e tij në njësimin e Zotit të tij të madhëruar dhe përfshirjen e tij në detyrat që i obligohen ndaj të adhuruarit të tij të lartmadhëruar.

Ihrami i Haxhit për të kryer ritet e tij fillon nga dita e tetë e Dhul-Hixhes⁶⁶ deri në ditën e Bajramit, që është dita e dhjetë e këtij muaji.

b- Tavafi rreth Qabesë -shtatë herë-; fillon çdo herë tek Guri i zi dhe mbaron po tek ai.

Allahu i madhëruar thotë: «... dhe që të bëjnë tavaf në Shtëpinë e Lashtë.»⁶⁷ Muslimani kur bën tavaf rreth Qabesë është më se i bindur se po bën një nga adhurimet më të mëdha dhe po afrohet tek Allahu i madhëruar me një nga punët më të dashura, sepse kjo vepër si adhurim nuk lejohet në asnjë vend tjetër në botë veçse në Qabenë e nderuar.

Prandaj në këtë adhurim ndihet vlera e sinqeritetit dhe çiltërsia e tij për Allahun e lartmadhëruar.

c- Seaji, *apo ecja* mes Safasë dhe Mervas.

Safa dhe Merva janë dy kodra të vogla në Mekë përbri Xhamisë së Shenjtë. Haxhiu e ka detyrë të ecë mes këtyre dy kodrave duke filluar nga Safa për në Merva -dhe kjo numërohet një herë- derisa të bëhen shtatë herë.

Dhe përfundimi i seajit të tij -d.m.th. ecjes së tij- herën e shtatë është te Merva.

d- Pastaj qëndrimi në malin e Arafatit një ditë ose një pjesë të ditës.

⁶⁶ Emri i muajit hënor në të cilin kryhet Haxhi.

⁶⁷ Suretu El-Haxh: 29.

Dita e qëndrimit në Arafat është ditë e shënuar, sepse ajo është dita kur Allahu i ka plotësuar këtij ymeti fenë, siç ka thënë subhanehu:

«Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha për ju Islamin fe.»⁶⁸

Në këtë ditë të shënuar, Allahu i madhëruar i fal mëkatet dhe gjynahet robve të tij.

Në ditën e Arafatit është e pëlqyer për haxhiun të bëjë sa më shumë tehlil (*të thotë: La ilahe il-Allah*) dhe të përmendë teuhidin.

Abdullah bin Amër bin El-Asi -radiallahu anhum- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë: «**Duaja më e mirë është duaja e ditës së Arafatit. Dhe fjala më e mirë që kam thënë unë dhe profetët para meje është:**

«**La ilahe il-Allah uahdehu la sherijke lehu. Le hul-mulku ue le hul-hamdu ue hue ala kul-li shejin kadir.**

(Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, i vetëm dhe pa rival! Atij i takon sundimi dhe lavdia dhe ai ka fuqi për çdo gjë.)»⁶⁹



Ditët, në të cilat myslimani kryen ritet e Haxhit, janë: dita e tetë e Dhul-Hixhes -e muajit hënor-, dita e nëntë, dita e dhjetë, dita e njëmbëdhjetë, dita e dymbëdhjetë dhe dita e trembëdhjetë.



Ndërsa, vendi ku myslimani kryen ritet e Haxhit, është Meka dhe konkretisht këto zona, të cilat, ose janë pjesë e saj, ose janë afër saj:

1- Xhamia e Shenjtë ku ndodhet dhe Qabeja dhe pranë saj Safa dhe Merva.

2- Mina-ja, që është vend afër Mekës dhe haxhinjtë qëndrojnë aty në ditë të caktuara.

⁶⁸ Suretu El-Maide: 3.

⁶⁹ E transmeton Tirmidhiu dhe Taberanij.

3- Arafati, që është kodër afër Mekës dhe haxhinjtë qëndrojnë aty në ditën e nëntë të muajit Dhul-Hixhe dhe është një ditë para Bajramit.

4- Muzdelife, që është vend mes Arafatit dhe Minasë dhe haxhinjtë flenë aty në natën e Bajramit.



Haxhiu bën edhe disa punë të tjera dhe prej tyre janë:

1- Gjuajtja e gurëve të vegjël -nga shtatë guralecë- në vendin e caktuar dhe që janë tre xhemeratet: Xhemra-ja e Akabesë e Madhja, Xhemra-ja e Mesme dhe Xhemra-ja e Vogël. Dhe bëhet në mënyrë dhe kohë të caktuar.

2- Kurbani, për t'u afruar me të tek Allahu, dhe është: ose deve, ose lopë, ose bagëti e imët.

3- Prerja e flokëve ose shkurtimi i tyre dhe kjo bëhet pas mbarimit të punëve të Haxhit.



Ka edhe vepra që haxhiu është i ndaluar t'i veprojë gjatë Haxhit kur ai është në ihram. Prej tyre janë:

1- Veshja e rrobave të zakonshme⁷⁰, qofshin këto rroba të jashtme apo të brendshme.

2- Mbulimi i kokës i çfarëdo lloji qoftë ai.

3- Parfumosja me çfarëdo lloj parfumi qoftë ai.

4- Rruajtja e flokëve, ose prerja e tyre.

5- Vrasja e gjahut.

6- Martesa dhe çdo gjë që ka lidhje me të, apo që të çon drejt saj.



⁷⁰ Haxhiu për mbulim të trupit përdor dy mbështjellëse: njëren për pjesën e poshtme të trupit dhe tjetrën për pjesën e sipërme të tij.

Haxhi ka dobi të shumta, të cilat i bëjnë dobi myslimanit në fenë dhe dynjanë e tij. Prej tyre janë:

- Fitimi i Xhenetit dhe shpëtimi nga Zjarri.
- Sinqeriteti në punë për Allahun dhe përgjegjësia ndaj Tij.
- Largimi nga kurthet e Shejtanit.
- Formimi i lidhjeve miqësore mes myslimanëve.
- Mësimi i durimit, i dhurimit dhe i sakrificës.

O Allah, na ndihmo ne të kuptojmë ritet e Haxhit dhe na e lehtëso mundësinë e kryerjes së tij!



Mirënjohja e prindërve (Birri)

Fjala “**Mirënjohje**”, apo “*Birr*” është emër i përgjithshëm që përfshin çdo gjë të mirë si: sinqeriteti, dashuria, përmbushja e premtimit, bindja, rregullsia dhe të tjera të ngjashme me to e që kanë të bëjnë me sjelljen e mirë dhe fisnike.

Dijetarët e gjuhës thonë:

«“**Birri**” përfshinë mirësitë e *Dynjasë* dhe të *Ahiretit*.

Mirësitë e Dynjasë janë: udhëzimi, lumturia dhe begatitë që ia mundëson Allahu i madhëruar robit të tij.

Ndërsa, mirësia e Ahiretit është fitimi i begatave të përjetshme në Xhenet.»



Mirënjohja, apo “*Birri*” i prindërve është: “Bamirësia me ta, bindja ndaj tyre, vlerësimi i tyre, kryerja e detyrave ndaj tyre, mëshira ndaj tyre, butësia me ta etj.”.

E kundërta e kësaj fjale është fjala “**Ukuk**” (*mosmirënjohja*).

Është emër i përgjithshëm që përfshin të gjitha cilësitë e këqija -Allahu na ruajt- si: mënjanimi, gabimi, injorimi, braktisja dhe lëndimi i tyre.

Çdo vepër me të cilën lëndohet njëri apo të dy prindërit është një lloj mosmirënjohjeje, pak apo shumë qoftë ajo.

Janë pyetur disa dijetarë tabi'inë për mosmirënjohjen dhe kanë thënë: «Ajo është: kur betohet babai ose nëna për diçka dhe ai nuk e zbaton betimin e tyre, apo kur e urdhërojnë për diçka dhe nuk i bindet urdhrit të tyre, apo kur i kërkojnë atij ndonjë gjë dhe ai nuk ua jep atë, apo kur i besojnë ndonjë gjë dhe ai nuk ua ruan atë.»

Mosmirënjohja është nga mëkatet më të mëdha.

Ebu Bekra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi salam- ka thënë:

«A t'ju tregoj për më të mëdhatë e gjynaheve të mëdha?

I thanë: Patjetër, o i dërguar i Allahut!

Atëherë profeti -alejhi salam- u tha:

T'i bësh ortak Allahut dhe mosmirënjohja e prindërve.

T'i bësh ortak Allahut dhe mosmirënjohja e prindërve.

T'i bësh ortak Allahut dhe mosmirënjohja e prindërve.»⁷¹

Imam Ahmedi -Allahu e mëshiroftë- ka thënë: «*Mirënjohja e prindërve, fshin gjynahet e mëdha.*»

Allahu na faltë dhe na ruajt prej këtij mëkati!



Allahu i madhëruar ka urdhëruar të adhurohet ashtu siç i takon, të njësohet ashtu siç i takon, pastaj i ka bashkuar kësaj të drejte mirënjohjen e prindërve dhe ka thënë:

«Zoti yt ka gjykuar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit.»⁷²

Madje e ka lidhur falënderimin e Tij me falënderimin e atyre të dyve duke qartësuar se çfarë vlere dhe rëndësie ka ky falënderim -që është sjellja e mirë dhe bindja ndaj tyre-. Allahu i madhëruar thotë:

⁷¹ E transmeton Buhariu, Muslimi etj

⁷² Suretu El-Isra: 23.

«Më falëndero mua dhe prindërit e tu dhe te Ne është kthimi.»⁷³

Ndërkohë që pak më lart u përmend edhe hadithi ku shirku i Allahut, -i cili është e kundërta e Teuhidit- shoqërohet me mosmirënjohjen e prindërve, e cila është e kundërta e mirënjohjes së tyre-.



Për këtë shkak mirënjohja e prindërve është nga punët më madhështore, nga adhurimet më të pëlqyera dhe nga afrimet më të dalluara.

Abdullah bin Mes'udi -radiallahu anhu- tregon: «*E pyeta Profetin -alejhi selam- : Cila vepër është më e dashur tek Allahu -i lartmadhëruar-?*

*Ai më tha: **Namazi në kohën e vet.***

I thashë: Pastaj cila?

*Ai më tha: **Mirënjohja e prindërve.***

*I thashë: Pastaj cila? Ai më tha: **Lufta në rrugë të Allahut.**»⁷⁴*

Namazi është nga veprat më madhështore në Islam pas fjalës së teuhidit. Pastaj sipas hadithit vjen mirënjohja e prindërve dhe kjo për nga vendi që zë, pozita që mban dhe vlera që ka.



Porosia për mirënjohjen e prindërve -ashtu siç u takon- është përmendur në Kuran dhe Sunet:

Allahu i madhëruar thotë:

«**E kemi porositur njeriun që të sillet mirë me prindërit...**»⁷⁵

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**Allahu ju porosit ju për nënat tuaja.**

Allahu ju porosit ju për nënat tuaja.

⁷³ Suretu Lukman: 14.

⁷⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁷⁵ Suretu El-Ahkaf: 15.

Allahu ju porositi ju për nënat tuaja.

Allahu ju porositi ju për baballarët tuaj

Allahu ju porositi ju për të afërmit sipas afërsisë.»⁷⁶

Kjo porosi nuk e ka marrë këtë vlerë, veçse për shkak të rëndësisë që ka mirënjohja e tyre, pozitës së lartë që zë dhe ndikimit të madh që ka ajo.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**Prindi është e mesmja prej dyerve të Xhenetit.**» Ebu Darda' -radiallahu anhu- pas kësaj porosie ka thënë: «*Nëse do, humbe atë derë, ose ruaje atë!*»⁷⁷

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**Kënaqësia e Zotit është te kënaqësinë e prindit dhe zemërimi i Zotit është te zemërimi i prindit.**»⁷⁸

Fjala prind këtu përfshin babain dhe nënën.



Nëse njëri prej prindërve, apo të dy janë jobesimtarë dhe nuk janë myslimanë, atëherë është detyrë të mos u bindesh në pjesën që lidhet me mosbesimin, sepse Profeti -alejhi selam- ka thënë: «**Nuk ka bindje ndaj krijesave në kundërshtim të Krijuesit!**»⁷⁹

Por detyrë është mirënjohja e tyre brenda kufijve të shariatit, bamirësia me ta aty ku nuk kundërshtohet feja dhe shoqërimi i tyre në Dynja brenda të pranueshmes.

Allahu i madhëruar thotë: «**Ne e kemi porositur njeriun, që të sillet mirë me prindërit e vet dhe: “Nëse ata të shtyjnë që të më**

⁷⁶ E transmeton Ibn Maxhe.

⁷⁷ E transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxhe etj

⁷⁸ E transmeton Tirmidhiu.

⁷⁹ Transmeton Ahmedi dhe Taberani.

shoqërosh Mua (në *adhurim*) atë për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos iu bind atyre!»⁸⁰

Gjithashtu thotë: «Nëse ata të nxisin që të më shoqërosh Mua (në *adhurim*) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos iu bind atyre, por sillu mirë me ata në këtë jetë!»⁸¹

Komentuesit e Kuranit thonë: *Allahu i porositi robtë e Tij të sillen mirë me prindërit pasi që i nxit ata të ruajnë njësimin e Tij, sepse prindërit janë shkak për ekzistencën e njeriut dhe prej tyre ka shijuar kulmin e mirësive, babai me shpenzime e nëna me ngrohtësinë e saj.*

Edhe pse kjo porosi për butësi, mëshirë dhe mirësjellje për shkak të mirësjelljes së tyre të mëparshme, Ai thotë:

«Nëse ata të nxisin që të më shoqërosh Mua (në *adhurim*) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos iu bind atyre...», që do të thotë se, kur ata insistojnë që ti t'i ndjekësh ata në fenë e tyre -nëse janë mushrikë-, atëherë kujdes ti dhe ata! Mos iu bind atyre në këtë gjë, sepse kthimi juaj do të jetë tek Unë ditën e Kiametit! Atëherë do të shpërblej ty për mirësinë me ta, për durimin tënd në fe dhe do të ringjall ty me punëmirët e jo me grupin e prindërve të tu edhe pse je njeriu më i afërt për ta në këtë Dynja, sepse njeriu ringjallet ditën e Kiametit me atë që do -d.m.th. dashurinë fetare- dhe prandaj ka thënë:

« Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, me siguri do t'i radhisim në mesin e të mirëve.»⁸²



Mirënjohja e prindërve ka shumë dobi në këtë botë dhe tjetrën. Prej tyre janë:

- Është shenjë suksesi prej Allahut të madhëruar për robin në jetën e tij.

⁸⁰ Suretu El-Ankebut: 8.

⁸¹ Suretu Lukman: 15.

⁸² Suretu El-Ankebut: 9.

- Tregon për kapje të mirë pas Islamit dhe besim të plotë.
- Është nga veprat më fisnike, adhurimet më të dalluara dhe afrimet më të arrira.
- Është rrugë për në Xhenet.
- Është shtim dhe begati në fe dhe në Dynja.

Lusim Allahun e madhëruar të na japë mirënjohje me prindërit, punë që i kënaqin ata, përkushtim për t'iu bindur atyre dhe bamirësi për ta, gjatë jetës dhe pas vdekjes!





Shokët e Profetit -alejhi selam- (Sahabët)

Shokët e profetit -alejhi selam- janë njerëzit më të mirë pas profetëve, lajmëtarë qofshin ata, apo të dërguar (*nebijë, apo resulë*).

Kjo, sepse ata janë:

- ata që i besuan që në fillim dhe me besim të plotë profetit -alejhi selam- dhe thirrjes së tij,

- ata që emigruan me profetin -alejhi selam- duke duruar vështirësitë dhe mundimet,

- ata që e ndihmuan dhe e mbrojtën atë,

- ata që luftuan së bashku me të jobesimtarët dhe politeistët etj.

Siç thotë Allahu i madhëruar: «**Ata që besuan, mërguan e luftuan për çështjen e Allahut dhe ata që u bënë strehim atyre e i ndihmuan, ata janë besimtarë të vërtetë. Për ta ka falje dhe shpërblim bujar.**»⁸³



Këto mirësi të mëdha u janë dhënë atyre, për shkak se Allahu i madhëruar i zgjodhi ata për të shoqëruar Profetin e Tij -alejhi selam- .

Ashtu siç zgjodhi të dërguarin e Tij, Muhamedin, që të jetë vula e të dërguarve të dhe më i dalluari i lajmëtarëve të Tij,

dhe zgjodhi fenë islame që të jetë feja e vetme e pranuar tek Ai, në

⁸³ Suretu El-Enfal: 74.

Dynja dhe në Ahiret,

ashtu zgjodhi edhe këtë grup besimtarësh të mirë, që kanë jetuar në kohën e profetësisë, që të jenë shokët e mirë të Profetit tonë -salallahu alejhi ue selam- dhe mbartësit e zgjedhur të thirrjes së tij.

Allahu i madhëruar thotë: «**Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar mirësitë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes...**»⁸⁴



Fjala “**Sahabi**” referuar etimologjisë arabe është fjalë e formuar nga fjala “**suhbe**” që do të thotë “shoqërim”.

Ndërsa si term fetar “**Sahabi**” është kushdo që:

- e ka takuar Profetin -alejhi selam- gjatë jetës së tij,
- e ka besuar atë pas dërgimit të tij profet,
- dhe ka vdekur besimtar.

Cilido që i plotëson këto kushte është sahabi:

- pavarësisht nëse ka ndenjur me Profetin -alejhi selam- pak ose shumë, ose vetëm e ka parë pa ndenjur me të,
- pavarësisht nëse ka transmetuar prej tij -alejhi selam- hadithe, apo nuk ka transmetuar,
- dhe pavarësisht nëse ka luftuar përkrah tij, apo nuk ka luftuar.



Respektimi i sahabëve, vlerësimi i tyre, nderimi dhe njohja e meritave që kanë është gjë shumë e rëndësishme, sepse ata -radiallahu anhum- janë faktori bazë në përcjelljen e gjithë fesë, sidomos të haditheve të Profetit -alejhi selam- dhe të transmetimit të tyre.

⁸⁴ Suretu El-Fer’h: 29.

Për këtë arsye shënohet në Kuran se ata fituan kënaqësinë e Allahut, gjë që u jep atyre gradën më të lartë të besueshmërisë dhe konsiderohet sukses i madh i dhuruar prej Zotit, siç thuhet në ajetin: «**Allahu u kënaq me besimtarët, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi, i shpërbleu me një fitore të afërt * dhe ua mundësoi arritjen e fitimeve të mëdha. Vërtet Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.**»⁸⁵



Janë gjendur si në të kaluarën ashtu dhe në të tashmen grupe njerëzish që pretendojnë Islamin dhe i shajnë sahabët e profetit -alejhi salam-, i fyejnë dhe i gjuajnë me akuza të gënjeshtërtë dhe të trilluara.

Veprimi i turpshëm i këtyre grupeve bën që të hidhen dyshime mbi sunetin e Profetit -alejhi salam- dhe hadithet e tij, sepse sahabët janë transmetuesit dhe përcjellësit e tyre dhe hedhja e dyshimit mbi ta është hedhje dyshimi mbi to. Profeti -alejhi salam- thotë:

«Mos i shani shokët e mi! Mos i shani shokët e mi, se për Atë që ka në dorë shpirtin tim, sikur ndonjëri nga ju të shpenzojë florinj (për hir të Allahut) sa mali i Uhudit nuk do të arrijë as sa një palë grushte të ndonjërit prej tyre madje as sa një grusht.»⁸⁶

Kjo gjë nuk do të ishte kështu, veçse për shkak të dallueshmërisë së tyre të madhe përgjatë gjithë historisë.

Profeti -alejhi salam- ka thënë:

«Njerëzit më të mirë janë brezi im, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre ...»⁸⁷

Prandaj sahabët ishin siguri për ymetin dhe portë e hajrit për të, siç ka thënë Profeti -alejhi salam-:

⁸⁵ Suretu El-Fer'h: 18-19.

⁸⁶ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁸⁷ E transmeton Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu etj.

«Sahabët janë siguria e ymetit. Kur të ikin sahabët e mi, do t'i vijë ymetit ajo që i premtohet.»⁸⁸

Dhe kështu ndodhi. Sapo iku koha e sahabëve -radiallahu anhum- u futën mosmarrëveshjet dhe dobësia në radhët e ymetit.

Ibën Umeri -radiallahu anhum- ka thënë:

«Mos i shani shokët e Muhamedit -alejhi selam- sepse qëndrimi i tyre një moment me profetin është më i mirë se puna e ndonjërit prej jush për dyzetë vjet.»

Imam Ebu Zur'ah Er-Razij ka thënë:

«Nëse sheh dikë që shan ndonjërin nga sahabët e profetit të Allahut, dije se ai është zindik (heretik që ka qëllim ta prishë fenë).»

Imam Ebu Xhaferr Tahaviu ka thënë:

«I duam shokët e profetit të Allahut -alejhi selam- ... dashuria për ta është fe, besim dhe mirënjohje, ndërsa urrejtja e tyre është mohim, hipokrizi dhe arrogancë.»



Më i miri ndër të gjithë sahabët është:

- Ebu Bekër Sidiku -radiallahu anhu-,

pastaj

- Umer bin Khatabi -radiallahu anhu-,

pastaj

- Uthman bin Afani -radiallahu anhu-,

pastaj

- Ali bin Ebi Talibi -radiallahu anhu-,

të cilët janë dhe katër khalifët e drejtë.

Me këta të katërt -radiallahu anhum- janë dhe gjashtë të tjerë, për

⁸⁸ E transmeton Muslimi.

të cilët Profeti i Allahut ka dëshmuar se do të jenë në Xhenet dhe i ka përgëzuar se do të jenë nga banorët e tij. Ata janë:

- Talha bin Ubejdullah -radiallahu anhu-.
- Zubejr bin El-A'uam -radiallahu anhu- .
- Abdurrahman bin Auf -radiallahu anhu- .
- Sead bin Ebi Uekas -radiallahu anhu- .
- Seid bin Zejd -radiallahu anhu- .
- Ebu Ubejde Amir bin El-Xherrah -radiallahu anhu- .

Të gjithë këta dhjetë sahabë janë të përgëzuar me Xhenet. Allahu qoftë i kënaqur me ta dhe na bashkoftë ne me ta në të mira!



Sahabët e profetit -alejhi selam- ishin këmbëngulës në përcjelljen e haditheve të tij, në ndjekjen e lajmeve të tij dhe transmetimin e sunetit të tij.

Madje disa prej tyre kanë transmetuar më shumë se një mijë hadithe nga profeti -alejhi selam.

Ata janë:

1- Ebu Hurejra -radiallahu anhu-, i cili ka transmetuar më shumë se pesëmijë (5000) hadithe dhe është ai që ka transmetuar më shumë se gjithë të tjerët.

2- Abdullah bin Umer bin El-Khatab -radiallahu anhu-, i cili ka transmetuar më shumë se dymijë e pesëqind (2500) hadithe.

3- Enes bin Maliku -radiallahu anhu-, i cili ka transmetuar më shumë se dymijë e dyqind (2200) hadithe.

4- Aishe bint Es-Sidik -radiallahu anhu-, nëna e besimtarëve dhe bashkëshortja e profetit -alejhi selam-, e cila ka transmetuar më shumë se dymijë e dyqind (2200) hadithe.

5- Abdullah bin Abasi -radiallahu anhu-, i cili ka transmetuar më shumë se njëmijë e pesëqind (1500) hadithe.

6- Xhabir bin Abdullah El-Ensarij -radiallahu anhuma-, i cili ka transmetuar më shumë se njëmijë e pesëqind (1500) hadithe.

7- Ebu Seid El-Khudrij -radiallahu anhu-, i cili ka transmetuar më shumë se njëmijë e njëqind (1100) hadithe.

Prej sahabëve -radiallahu anhum- ka nga ata që kanë transmetuar prej tij -alejhi selam- qindra hadithe dhe prej tyre ka nga ata që kanë transmetuar dhjetëra hadithe.



Çdokush që i do sahabët e profetit të Allahut -alejhi selam-, ecën në udhën e tyre dhe ndjek rrugën e tyre -radiallahu anhum-, është nga vëllezërit e profetit të Allahut -salallahu alejhi selam-.

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- shkoi njëherë te varreza (*e Bakisë, varrezë në Medinë*) dhe u lut:

«Paqja qoftë mbi ju, o shtëpi e popullit besimtarë! Edhe ne në dashtë Allahu ju do t'ju pasojmë!

Do të dëshiroja sikur të shihnim vëllezërit tanë!

Njerëzit i thanë: A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i dërguari i Allahut?!

*Profeti -alejhi selam- u tha: **Ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit tanë janë ata që nuk kanë ardhur akoma.»**⁸⁹*

Dijetarët e hadithit kanë thënë: «*Nga kjo thënie kuptohet se vëllezërit e tij -alejhi selam- janë të tjerë dhe jo shokët e tij, sepse shokët e tij janë ata që e kanë parë dhe shoqëruar atë dhe e kanë besuar, ndërsa vëllezërit e tij janë ata që e kanë besuar atë, por nuk e kanë parë.»*

Lusim Allahun e madhëruar të na japë dashuri për sahabët e profetit të Allahut, të na mundësojë ndjekjen dhe mbrojtjen e figurës së tyre dhe të jemi vëllezër të vërtetë të profetit -alejhi selam- në besim, ndjekje dhe shëmbëllim!

⁸⁹ E transmeton Muslimi.



Edukata

Edukatë do të thotë të pajisesh me cilësi të lavdëruara dhe virtyte të çmuara dhe të distancohesh nga veprimet e ulëta dhe veset e shëmtuara.

Ibën Kajim El-Xheuzije -Allahu e mëshiroftë- ka thënë: *«Realiteti i edukatës është sjellja me moral të mirë, prandaj dhe edukata është shfaqja e të përsosurës në natyrën e njeriut prej fjalëve dhe veprimeve.»*



Allahu i madhëruar thotë: **«O ju, që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.»**⁹⁰

Ibën Abasi -radiallahu anhu- në lidhje me domethënien e ajetit ka thënë: *«Edukojini dhe mësojini ata!»*

Fjala e Tij **“Ruani”** do të thotë: mbroni dhe pengoni.

Mbi domethënien e fjalës **“Edukatë”** ndërtohen dy çështje të rëndësishme:

E para: Edukimi i vetes, që do të thotë: përvetësimi i vetive të mira dhe i cilësive të larta.

E dyta: Edukimi i të tjerëve, që do të thotë: t’ua mësosh atyre virtytet e larta dhe të dënosh kundërshtimin e tyre.



⁹⁰ Suretu Et-Tahrim: 6.

Edukata është disa llojesh dhe më të rëndësishmet janë tri:

E para: Edukata me Allahun e lartësuar.

Baza e saj është: të kryejë myslimani detyrën e adhurimit për Zotin e tij të madhëruar duke insistuar të perfeksionojë fjalët dhe veprat e tij dhe të largohet nga të metat dhe mëkatet; siç ka qenë dhe duaaja e profetit -alejhi salam-:

«O Allah! Më ndihmo mua në dhikrin tënd, falënderimin tënd dhe adhurimin tënd të mirë!»⁹¹

Prej edukatës me Allahun e madhëruar është: njohja e emrave dhe cilësive të Tij dhe mësimi i fesë dhe shariatit të Tij.

Prej saj gjithashtu është: respektimi i fjalëve të Tij (*dmth: i librit të Tij*) dhe meditimi në ajetet e tij, siç thuhet: **«Vallë, a nuk e meditojnë ata Kuranin, apo zemrat i kanë me dryna?!»⁹²**

E dyta: Edukata me profetin e Allahut -alejhi salam- .

Baza e saj është: dorëzimi ndaj urdhrave të profetit, pasimi i sunetit dhe përçafimi i udhëzimeve të tij.

Allahu i madhëruar thotë: **«O ju që keni besuar! Mos dilni përpara (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij!»⁹³**

Gjithashtu thotë: **«Nëse i bindeni atij (Profetit), udhëzoheni.»⁹⁴**

Prej edukatës me të -alejhi salam- gjatë jetës së tij ishte të mos ngrihej asnjë zë mbi zërin e tij. Ndërsa pas vdekjes së tij do të thotë të mos i jepet përparësi ndonjë mendimi e as logjike mbi sunetin dhe udhëzimin e tij.

Abdullah bin Mubaraku ka thënë: *«Kush e neglizhon edukatën, ndëshkohet me mosqasjen ndaj sunetit. Kush nënvlerëson sunetin,*

⁹¹ E transmeton Ebu Daudi, Nesai dhe Ahmedii.

⁹² Suretu Muhamed: 24.

⁹³ Suretu El-Huxhurat: 1.

⁹⁴ Suretu En-Nur: 54.

ndëshkohet me mosqasjen ndaj farzeve. Dhe kush nënvlerëson farzet, ndëshkohet me mosqasjen ndaj diturisë.»

E treta: Edukata me njerëzit.

Baza e saj është: sjellja me ta në atë mënyrë që u takon, me secilin sipas nivelit dhe pozitës që ka.

Edukata me prindërit është: mirënjohja e tyre, bamirësia me ta dhe lutja për ta.

Edukata me dijetarin është: respektimi i tij, nderimi i tij, përfitimi prej dijes së tij dhe lutja për të.

Edukata me familjen është: kryerja e detyrave ndaj tyre, përpjekja për ndreqjen e tyre dhe interesimi për arritjen e asaj që është në dobi të tyre.

Edukata me shokët është: ofrimi i këshillës për ta dhe ruajtja e tyre në mungesë dhe në prezencë.

E kështu me radhë ...



Myslimani ka dhe **edukatën vetjake** që lidhet me veten e tij:

E ngrëna ka edukatën e saj.

E pira ka edukatën e saj.

Gjumi ka edukatën e tij.

Udhëtimi ka edukatën e tij.

Fjala ka edukatën e saj.

Dhe heshtja ka edukatën e saj.

Është detyrë e domosdoshme për çdo mysliman njohja e këtyre normave në mënyrë të shkoqitur, përvetësimi i tyre dhe edukimi real me to.

Myslimani në të gjitha këto norma ka shembullin e përsosur dhe modelin e qëndrueshëm profetin më fisnik, Muhamedin, -alejhi selam- siç thuhet në Kuran:

«Për ju në të Dërguarin e Allahut ka shembull të mirë për këdo që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.»⁹⁵



Prej sjelljeve të çmuara, me të cilat duhet të pajiset myslimani dhe të largohet nga ajo që bie ndesh me to, janë:

1- Thjeshtësia dhe largimi nga mendjemadhësia dhe pëlqimi i vetes.

2- Turpi, sepse ai e pengon njeriun nga gjërat e papranueshme dhe e nxit për mirësi dhe vepra të mira.

3- Përmbajtja, sepse ajo e nxit njeriun të mbajë mllëfin dhe të kontrollojë zemërimin.

4- Singëriteti, i cili është porta e shpëtimit, mënyra e udhëzimit dhe rruga më e shkurtër për të arritur tek e vërteta.

5- Kënaqja (*mjaftimi*), e cila është çelësi i qetësisë shpirtërore dhe adresa e rehatisë së tij. Me të njeriu largon vesin e smirës dhe sëmundjet e moraleve të ulëta.



Është pyetur Hasen El-Basriu -Allahu e mëshiroftë-: «*Cila është edukata më e dobishme?* Ai ka thënë: *Kuptimi i fesë, moslakmimi i Dynjasë dhe njohja e detyrave të Allahut për ty.*»

Jahja bin Muadh Er-Razij ka thënë: «*Kush pajiset me edukatën e Allahut, bëhet nga të dashurit e Allahut.*»

Thuhet se: «*Edukata në punë është shenjë e pranimit të saj prej Allahut të madhëruar.*»



Edukata islame ka dobi të mëdha, prej të cilave myslimani ka përfitime në fenë dhe dynjanë e tij. Prej tyre janë:

⁹⁵ Suretu El-Ahzab: 21.

- Sjellja e mirë, largimi nga të metat dhe kapja pas gjërave të çmuara.
 - Përpjekja për të bërë atë që duhet dhe ruajtja nga gabimet.
 - Kapja pas porosive fetare të Allahut të lartmadhëruar dhe gjykimeve të Tij të shariatit.
 - Ndjekja e sunetit të profetit -alejhi selam- dhe udhëzimit të tij.
 - Qetësimi i shpirtit dhe stabilizimi i tij.
 - Njohja e të drejtave të njerëzve dhe zbatimi i tyre, e cila e bën atë rrugë të përmirësimit të gjithë shoqërisë.
- O Allah, na zbukuro ne me edukatë dhe na mundëso çdo shkak për arritjen e saj!





Xhamia (Mesxhidi)

Xhamia, apo “*Mesxhidi*” është vendi i përgatitur i myslimanëve për të kryer namazin me xhemat. Ata i prin imami që të bëjnë atë që bën ai dhe të thonë atë që thotë ai.

Nëse për ndonjë arsye nuk ka xhami, lejohet namazi në cilindo vend të pastër ku nuk ka haramë dhe gjynahe.

Profeti -alejhi selam- ka thënë: «**Më është bërë toka xhami dhe pastrim.**»⁹⁶,⁹⁷



Xhamia në Islam ka pozitë të lartë dhe zë vend të rëndësishëm.

Kjo për shkak se:

- Është pishtar i udhëzimit për gjithë besimtarët.
- Është djepi i edukimit dhe i mësimin për fëmijët e myslimanëve.

Profeti -salallahu alejhi ue selam- ka thënë: «**Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë.**»⁹⁸

⁹⁶ D.m.th.: pastrim me tejemum me dheun e saj kur mungon uji, apo kur vështirësohet përdorimi i tij.

⁹⁷ E transmeton Buhariu, Muslimi etj.

⁹⁸ E transmeton Muslimi, Ibn Hibbani etj.

Në xhami myslimanët kryejnë më të madhin adhurim për Zotin e botëve.

Në xhami myslimanët mësojnë gjykimet e fesë dhe çështjet e legjislacionit të tyre.

Në xhami myslimanët diskutojnë çështje të tyre dhe këshillojnë njëri-tjetrin për të drejtën dhe për durim.

Në xhami rritet i vogli nën dritën e udhëzimit dhe të edukatës islame.

Në xhami plotësohet i rrituri me morale të larta dhe vepra të mira.



Për të përfuruar rëndësinë e xhamisë në fenë tonë të drejtë, e para gjë, së cilës i kushtoi rëndësi profeti -alejhi selam- dhe e bëri kur erdhi në Medine, ishte urdhri i tij -alejhi selam- për ndërtimin e xhamisë dhe ngritjen e saj për të ngritur dhikrin e Allahut, për të falur namazin dhe për t'i lidhur sahabët me të, sepse këto janë nga shenjat e besimit. Në Kuran thuhet:

«Për xhamitë e Allahut interesohen (d.m.th.: i ndërtojnë, i frekuentojnë dhe kujdesen për to) vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, falin namazin, japin zekatin dhe nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Këta shpresohet të jenë prej të udhëzuarve.»⁹⁹



Fjala “*Mesxhid*” vjen nga fjala “*suxhud*” që do të thotë: rënie në sexhde, veprim, i cili është një nga bazat më të rëndësishme të namazit, i cili është vepra më e madhe praktike e besimit, madje shtylla e fesë.

Për shkak të kësaj çështjeje madhore është përmendur në Kuran lidhja mes xhamive dhe teuhidit (*njësimit të Allahut*), siç ka thënë Allahu i madhëruar:

⁹⁹ Suretu Et-Teube: 18.

«Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut!»¹⁰⁰

Dhe kjo, për të kryer adhurimin e sinqertë dhe për të vërtetuar teuhidin e drejtë.



Është detyrë e çdo myslimani që ka mundësi, të kryejë namazet farze në xhami. Kjo për dy arsye të rëndësishme:

E para: Sepse shpërblimi i namazit të tij shumëfishohet siç thuhet në hadithin profetik:

«**Namazi i njeriut me xhemat është njëzetë e shtatë gradë më shumë se i atij që falet vetëm.**»¹⁰¹

E dyta: Largon nga vetja mëkatin e mosprezantimit në namaz me xhemat në xhami.

Nuk e linte njeri namazin me xhemat në kohën e Profetit -alejhi salam-, përveç hipokritëve.

Ndërsa kush ka arsye që e pengojnë atë nga vajtja në xhami si sëmundja, apo distanca e largët, nuk ka mëkat për të -në dashtë Allahu-.



Sikur myslimani ta vërejë me kujdes shpërblimin e madh që fiton nga qëndrimi në xhami, do të ishte përpjekur në maksimum që ta kalojë kohën e lirë -pas punës, apo studimeve, apo preokupimeve- në xhami, sepse Profeti -alejhi salam- ka thënë:

«**Melaiket bëjnë dua për çdonjërin nga ju, përderisa është në vendin e faljes dhe përderisa nuk e ka prishur abdesin.**

Ata thonë: O Allah fale atë! O Allah mëshiroje atë!»¹⁰²

¹⁰⁰ Suretu El-Xhin: 18.

¹⁰¹ E transmeton Buhariu, Muslimi etj.

¹⁰² E transmeton Buhariu, Muslimi etj.

Me uljen e tij në xhami atij i hapen shumë porta mirësie, prej tyre:
- Qëndron në shtëpinë e Allahut dhe është nën mbrojtjen e Zotit të tij të madhëruar.

- Pret namazin, pas namazit.

- Ia kushton kohën dhikrit të Allahut me të gjitha gjymtyrët e tij.

- Njihet me ndonjë vëlla në Islam prej të cilit mund të ketë dobi në çështje dynjaje dhe feje.

Vëllazëria në fe është nga llojet më të mira të vëllazërisë.

Ndërsa: dynjaja, pasuria, bukuria etj., nuk janë të përhershme, as të qëndrueshme, e as nuk mbesin përgjithmonë.



Është e pëlqyer për atë që hyn në xhami, të hyjë me këmbën e djathtë duke përmendur Zotin e tij të lartmadhëruar.

Profeti -alejhi selam- ka thënë: «**Kur të hyjë ndonjëri prej jush në xhami, të thotë: Allahumme ifteh lij eb' uabe rahmetike** (O Allah, m'i hap mua dyert e mëshirës sate!)! **Ndërsa kur të dalë të thotë: Allahumme innij es' eluke min fadlike** (O Allah, unë kërkoj prej mirësive të tua!)!»¹⁰³

Hyrja në xhami është për adhurim dhe vepra të mira dhe i përshtatet kërkimit të mëshirës prej Allahut të madhëruar.

Ndërsa dalja nga xhamia bëhet për punë, ose për studime, ose kërkimin e rrizkut dhe i përshtatet kërkimit të mirësive materiale prej Tij.

Kur myslimani të hyjë në xhami, puna e parë e tij -nëse nuk po falet namazi me xhemat- është të falë dy rekate përshëndetje për xhaminë.

Profeti -alejhi selam- thotë: «**Kur të hyjë ndonjëri prej jush në xhami, të falë dy rekate para se të ulet.**»¹⁰⁴



¹⁰³ E transmeton Muslimi.

¹⁰⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Ai që shkon në xhami duhet të pajset me sjellje islame dhe të ndjekë shembullin e sunetit të profetit -alejhi salatu ue selam- .

Profeti –salallahu alejhi ue selam- thotë: «**Kush ha hudhra, qepë dhe presh, të mos i afrohet xhamisë sonë, sepse melaiket bezdisen prej asaj që bezdisen njerëzit.**»¹⁰⁵

Këtë gjykim e kanë edhe duhanpirësit që mbajnë erë të rëndë.

Po kështu edhe njerëzit me rroba të pista, apo me trupin pis dhe mbajnë erë të keqe, etj.



Mjafton për mirësinë e xhamisë dhe frekuentuesve të saj -nga shumë mirësi të tjera- fjala e profetit -alejhi selam- :

«**Nuk mblidhet ndonjë grup njerëzish në ndonjë nga shtëpitë e Allahut, për të lexuar librin e Allahut dhe për ta mësuar atë, vetëm se u zbret qetësia, i mbulon mëshira, i rrethojnë melaiket dhe i përmend Allahu tek ata të vetët** (*d.m.th: te melaiket*).»¹⁰⁶

Dhe gjithashtu fjala e profetit -alejhi selam- kur ka numëruar shtatë grupet që Allahu i madhëruar i fut nën hijen e arshit të Tij, ditën kur nuk do të ketë hije tjetër veç hijes së Tij:

“**... Një burrë që e ka lidhur zemrën me xhaminë, i cili sapo del prej saj, kthehet përsëri.**”¹⁰⁷

E lusim Allahun e madhëruar të na bëjë edhe ne prej tyre me mirësinë dhe bujarinë e tij!

¹⁰⁵ E transmeton Muslimi.

¹⁰⁶ E transmeton Muslimi, Tirmidhiu etj.

¹⁰⁷ E transmeton Muslimi.



Lutja (Duaja)

Lutja, apo “*Duaja*” është drejtimi nga Allahu i lartësuar me kërkesa dhe lutje për mirësitë e Dynjasë dhe të Ahiretit.

Për shembull:

- vazhdimësia në bindje ndaj Allahut dhe në ndjekje të Profetit – salallahu alejhi ue selam-,

- mundësimi i mirënjohjes së prindërve,

- suksesi në studime,

- ruajtja e shokëve,

- e të tjera.

Myslimanit nuk i lejohet t’i lutet tjetërkujt veç Allahut në gjërat që nuk ka mundësi tjetërkush veç Allahut të lartësuar.

Profeti -alejhi selam- ka thënë: «**O djalosh! Dua të të mësoj disa fjalë: Kur të lutesh, lute Allahut! Dhe kur të kërkosh ndihmë, kërkoi ndihmë Allahut!**»¹⁰⁸

Allahu i lartësuar thotë: «**Kur robërit e Mi (*besimtarë*) të pyesin për Mua, (*thuaje se*) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua.**»¹⁰⁹

¹⁰⁸ E transmeton Tirmidhiu.

¹⁰⁹ Suretu El-Bekare: 186.

Dhe thotë: «Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni Mua, t’ju përgjigjem juve!”»¹¹⁰



Kur myslimani do që ta lusë Zotin e tij bujar dhe të lartësuar, atëherë duaja e tij drejtuar Atij duhet të jetë në fshehtësi dhe me zë të ulët, jo e publikuar dhe jo me zë të lartë.

Allahu i lartësuar thotë: «**Lutjuni Zotit tuaj me nënshtrim dhe në fshehtësi!**»¹¹¹

Fjala [**me nënshtrim**] do të thotë me përlulje për Allahun.

Dijetarët e tefsirit në komentimin e fjalës së Allahut «**Lutjuni Zotit tuaj me nënshtrim dhe në fshehtësi! Njëmend, Ai nuk i do ata që e tejkalojnë**», thonë: «*Tejkalimi në dua është disa llojesh, prej tyre janë: ngritja e zërit dhe e bërtitura.*»

Duaja në fshehtësi ka disa dobi, prej tyre:

1- Është argument për besimin e myslimanit se Zoti i tij ia dëgjon lutjen edhe pse atë nuk ia dëgjojnë krijesat.

2- Shfaq më mirë edukatën e robit me Zotin e tij dhe madhërimin e tij për Të.

3- Sjell më shumë përlulje dhe realizon më mirë sinqeritetin.



Duaja ka disa norma, prej tyre janë:

1- Zgjedhja e kohëve të preferuara, si: dita e Arafatit, muaji i Ramazanit -sidomos dhjetëditëshi i fundit i tij-, ora (*pjesa*) e fundit e ditës së xhuma para perëndimit dhe pjesa e tretë e çdo nate para agimit.

2- Zgjedhja e momenteve të preferuara si: lutja në sexhde, kur bie shi, kur çel agjëruesi dhe gjatë udhëtimit.

¹¹⁰ Suretu Gafir: 60.

¹¹¹ Suretu El-Araf: 55.

3- Përkujdesja në drejtimin nga kibla gjatë lutjes.

4- Sinqeriteti në dua dhe përulja gjatë saj.

5- Vendosmëria dhe siguria se Allahu do t'i përgjigjet duasë së tij.

6- T'i përsërisë fjalët e duasë tre herë.

7- Çelja e duasë me falënderim të Allahut dhe mbyllja e saj me salavate mbi profetin -salallahu alejhi ue selam- .

8- Të pastrojë veten e tij nga mëkatet dhe gjynahet dhe ta çlirojë atë nga padrejtësitë dhe haramet.



Duaja më e mirë dhe më frytdhënëse është lutja e Allahut me emrat e tij të mirë dhe cilësitë e tij të larta.

Allahu i madhëruar thotë:

«Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrreni Atë (*lutjuni Atij*) me to!»¹¹²

Si lutja e profetit të Zotit Ibrahimit -alejhi selam- :

«O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (*këtë vepër*)! Me të vërtetë, Ti je Dëgjuesi dhe i Dituri ! * O Zoti ynë! Na bëj të përulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përulur ndaj Teje! Tregona ritet tona dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!»¹¹³

Po kështu lutja e profetit të Zotit, Zekerijës -alejhi selam-:

«O Zoti im, mos më lër vetëm (*pa fëmijë*), se Ti je trashëgimtari më i mirë!»¹¹⁴

Po kështu dhe lutjet e robërve të devotshëm të Allahut:

¹¹² Suretu El-Araf: 180.

¹¹³ Suretu El-Bekare: 127-128.

¹¹⁴ Suretu El-Enbija: 89.

«Mes robërve të Mi, ishte një grup i cili thoshte: “O Zoti ynë, ne kemi besuar, andaj na fal dhe na mëshiro se Ti je më i miri i mëshiruesve!»¹¹⁵

Lutje të tilla kuranore ka plot:

«O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (*nga e vërteta*), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!»¹¹⁶

«Ata të cilët erdhën pas tyre thonë: O Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!»¹¹⁷

«O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për jobesimtarët dhe falna ne! O Zot, Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.»¹¹⁸



Duaja më e madhe është lutja ndaj Allahut me emrin e tij më të madh.

Enes bin Maliku -radiallahu anhu- tregon: «*Isha i ulur me profetin -alejhi selam- dhe në këmbë qëndronte një burrë duke u falur. Ai pasi bëri rukunë, sexhden dhe teshehudin bëri dua dhe tha:*

Allahumme inij es’eluke bi’ene lekel hamdu la ilahe ila ente, Al-Menanu, Bediu As-Semauati uel-erd, ja Dhel Xhelali uel Ikram, ja Haju ja Kajum! Ini es’eluke ...

(O Allah, unë të lutem ty, se ty të takon falënderimi dhe s’ka Zot tjetër veç teje. Ti je Dhuruesi dhe Shpikësi i qiejve dhe i tokës. O Fisnik dhe Bujar! O i Gjallë e Kujdestar i çdo gjëje! Unë të lutem ty ...).

¹¹⁵ Suretu El-Muminun: 109.

¹¹⁶ Suretu Ali Imran: 8.

¹¹⁷ Suretu El-Hashr: 10.

¹¹⁸ Suretu El-Mumtehine: 5.

Profeti -alejhi selam- u tha shokëve të tij: A e dini se me çfarë është lutur?

Ata i thanë: Allahu dhe i dërguari i tij e dinë më mirë.

Ai u tha: Për atë në dorën e të cilit është shpirti im, e ka lutur Allahun me emrin e tij më të madh me të cilin kur lutet i përgjigjet lutjes dhe kur i kërkohet e jep atë (që i kërkohet).»¹¹⁹



Nga llojet e lutjeve pas të cilave duhet të kapet fort myslimani dhe të mos i anashkalojë janë dhikri i ditës dhe i natës, pavarësisht nëse ato janë të lidhura me një kohë të caktuar si p.sh. dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes si:

- «**Subhanallahi ue bi hamdihi!** (I patëmetë është Allahu dhe i lavdëruar është Ai!)». E përsërit këtë njëqind herë.

- Thënia në mëngjes: «**Asbahna ue asbaha elmulku lilahi uel hamdu lilahi, la ilahe ilallahu uehdehu la sherike lehu, lehu mulku ue lehu hamdu ue hue ala kuli shej'in kadir! Rabi es'eluke khajra ma fij hadhel-jeumi ue khajra me beadehu, ue eudhu bike min sherri ma fij hadhel-jeumi ue sherri me beadehu! Rabi eudhu bike minel-kesel ue suil-kiberi, rabi eudhu bike min adhabin finnari ue adhabin fil-kabri!**

(U gdhimë dhe vazhdon pushteti i Allahut. Falënderimi i takon Allahut. Nuk ka zot tjetër veç Allahut të vetëm e të pashoq. I Atij është pushteti dhe atij i takon falënderimi. Ai për çdo gjë ka mundësi. O Zot, të kërkoj ty hajrin e kësaj dite dhe hajrin e asaj që vjen pas saj dhe të kërkoj të më mbrosh nga e keqja e kësaj dite dhe e keqja e asaj që vjen pas saj! O Zot kërkoj të më ruash nga përtacia dhe e keqja e pleqërisë, o Zot kërkoj mbrojtje prej dënimit në zjarr dhe dënimit në varr!)»

Kur të ngryisë e thotë sërish këtë (por me fjalët): «**Emsejna ue emsal mulku lilahi ...** (U ngryisë dhe vazhdon pushteti i Allahut ...)

¹¹⁹ E transmeton Tirmidhiu, Nesai etj.

- «**Bismilahi ledhi la jedurru mea ismihi shej'un fil erdi ue la fis-semai ue hue semiul alim** (Me emrin e Allahut, me emrin e të cilit nuk bën dëm ndonjë gjë në tokë e as në qiell dhe Ai është Dëgjuesi dhe i Dijshmi)». E përsërit këtë tre herë.

- «**Allahumme bike asbahna ue bike emsejna ue bike nehja ue bike nemutu ue ilejke nushur**» (O Allah, me mirësinë tënde kemi gdhirë dhe me mirësinë tënde jemi ngrysur! Ti na mban gjallë, Ti na bën të vdesim dhe te Ti është kthimi.)»

Kur të ngrysë e thotë sërish këtë me fjalët: «**Allahumme bike emsejna ue bike asbahna ... ue ilejkel-mesijr!** (O Allah me mirësinë tënde jemi ngrysur dhe me mirësinë tënde kemi gdhirë ... dhe te ti është kthimi!)»

E shumë dua të tjera.

- Ose lutje që lidhen me një vend të caktuar, p.sh.: kur del nga shtëpia.

Enesi -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**Kush thotë -d.m.th. kur del nga shtëpia e tij-: Bismilah! Teuekeltu alAllah! La haule ue la kuete ila bilah!** (Me emrin e Allahut! I mbështetem Allahut! Nuk ndryshon gjë dhe as ka kush mundësi për të, veçse me vullnetin e Allahut!). **I thuhet atij: U mjaftove, u mbrojte dhe u udhëzove. Largohet prej tij shejtani dhe i thotë shejtanit tjetër: Ç'mund të bësh me një njeri që është udhëzuar, është mjaftuar (me Allahun) dhe është mbrojtur?!**»¹²⁰

Ose kur hyn në shtëpi.

Xhabir bin Abdullahi -radiallahu anhum- tregon:

«**Kam dëgjuar profetin -alejhi selam- duke thënë: Kur hyn njeriu në shtëpinë e tij dhe përmend Allahun e madhëruar në hyrje dhe në ngrënie, shejtani u thotë (shokëve të tij): nuk keni vend fjetjeje e as darkë.**

¹²⁰ E transmeton Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.

Ndërsa kur hyn dhe nuk e përmend Allahun e madhëruar kur hyn, shejtani u thotë: **E siguruat vendin e fjetjes. E nëse nuk e përmend Allahun në ngrënie, u thotë: E siguruat vendin për të fjetur e për të ngrënë.**»¹²¹

- Prej tyre janë dhe duatë e hyrjes në xhami dhe daljes prej saj, duaja e tregut etj.

Ose ato që lidhen me një veprim ose punë:

- Si duaja e ngrënies dhe pirjes:

«**Allahumme barik lena fima razektena uerzukna khajran minhu!** (*O Allah na begato në atë që na ke furnizuar dhe na furnizo me më të mirë se kjo!*)»

Pastaj thotë: «**Bismilah!** (*Me emrin e Allahut!*)»

Kur të mbarojë ngrënien, ose pirjen thotë:

«**Elhamdulillah!** (*Falënderimi i takon Allahut!*)», ose «**Elhamdulillahil-ledhi et’amenij hadha ue razekanihi min gajri haulin minij ue la kueh!** (*Falënderimi i takon Allahut i cili më ushqeu këtë dhe më furnizoi pa përpjekje nga unë dhe pa mundim!*)»

- Duaja e teshtimës.

Ai që teshtin thotë: «**Elhamdulillah!** (*Falënderimi i takon Allahut!*)»

Ndërsa ai që e dëgjon atë thotë: «**Jerhamukellahu!** (*Të mëshiroftë Allahu!*)»

Atëherë ai që teshtin ia kthen: «**Jehdikumullahu ue juslihu balekum!** (*Të udhëzofte Allahu dhe ta përmirësofte gjendjen!*)»

- Duaja e gjumit.

Aishja -radiallahu anha- tregon: «*Profeti -alejhi selam- çdo natë kur vinte në shtrat mblihte dy duart, pastaj frynte në to dhe lexonte: “Kuhuellahu ehad”, “Kul eudhu bi rabil felek” dhe “Kul eudhu bi rabinas”, pastaj fshinte sa të mundte trupin e tij duke filluar me kokën,*

¹²¹ E transmeton Muslimi, Ebu Daudi, Ibn Maxhe etj

fytyrën dhe pjesën e përparme të trupit. E bënte këtë tre herë.»

- Duaja e istikharës¹²².

Xhabir bin Abdullahi -radiallahu anhum- tregon: «Profeti -alejhi selam- na mësonte duanë e istikharës në të gjitha çështjet siç na mësonte ndonjë sure Kurani dhe na thoshte: **Kur të shqetësohet ndonjëri prej jush për një çështje, të falë dy rekate jo farz, pastaj të thotë:**

Allahumme innij estekhijruke bi ilmike ue estakdiruke bi kudretike, ue es'eluke min fadlikel-adhim, fe inneke takdiru ue la akdiru, ue tea'lemu ue la ealemu, ue ente al'lamul gujub.

Allahumme, in kunte tealamu enne hadhal emra (dhe e përcakton me emër) hairun li fi dini ue me'ashi ue akibeti emrij -ose thotë- axhili emrij ue exhilihi fakdirhu li ue jessirhu li thumme barik li fihi. Ue in kunte tealemu enne hadhel emra sherrun li fi dini ue me'ashi ue akibeti emrij -ose thotë- 'axhili emrij ue exhilihi, fashifhu anni uesrifni anhu uakdir li al-hajra hajthu kene thummerdini-bihi.

(O Allah, me diturinë Tënde kërkoj hajrin! Kërkoj ndihmë prej fuqisë Sate dhe kërkoj prej të mirave të Tua të shumta, sepse Ti je i gjithëfuqishëm, e unë jam i dobët. Ti di çdo gjë e unë nuk di. Ti je ai që i di të fshehtat.

O Allah, nëse Ti e di se kjo punë e imja (dhe e përcakton me emër) është e mirë për mua në fenë time, për jetën time dhe përfundimin tim -ose thotë- shpejt apo vonë, ma mundëso atë mua dhe ma lehtëso, pastaj më begato në të. Dhe nëse Ti e di se kjo punë është në dëmin tim për fenë time, jetën time dhe përfundimin tim -ose thotë- shpejt apo vonë, largoje atë prej meje dhe më largo mua prej saj dhe më cakto mua hajrin kudo që të jetë pastaj më bëj të kënaqur me të).»¹²³

Kështu veprohet për çdo veprim, apo punë.



¹²² Kërkimi hajrit dhe i suksesit nga Allahu i lartësuar për të gjitha problemet dhe çështjet.

¹²³ E transmeton Buhariu.

Lutja e Allahut të lartësuar i jep myslimanit shumë dobi në dynja dhe ahiret, prej tyre janë:

1- Përgjigjja e lutjes dhe largimi i brengave.

2- Sjellja e të mirave dhe largimi i të këqijave në çështje feje, apo dynjaje.

3- Strehimi tek Allahu dhe largimi i shqetësimeve.

4- Vazhdimësia e njeriut në ndjesinë e nevojës për Zotin e tij dhe ndjeshmërinë e dobësisë përpara Krijuesit të tij.

5- Nënshtrimi i plotë për Allahun e lartësuar.

Lusim Allahun e madh të na japë sukses në dhikrin e tij, falënderimin e tij dhe adhurimin e duhur atij!





Veshja

Myslimani i vërtetë, i bindur ndaj Zotit të tij të madhëruar dhe i kapur pas sunetit të Profetit -salallahu alejhi ue salam-, figura e tij dallohet në të gjitha çështjet e tij:

- Dallohet në adhurimin e tij.
- Dallohet në marrëdhëniet e tij.
- Dallohet në edukatën e tij.
- Dallohet në moralin e tij.

Gjithë këto dallime i japin atij dhe një dallim tjetër mes tij dhe të tjerëve që nuk janë si ai në adhurim, marrëdhënie, edukatë, moral etj. dhe që është dallimi i myslimanit në paraqitjen dhe veshjen e tij.



Veshja është një mirësi e madhe e Allahut për njeriun. Ai me të e ka nderuar dhe e ka dalluar atë mbi të gjitha krijesat e Tij.

Me veshjen njeriu:

- Mbulon aurretin e tij.
- Ruan trupin e tij.
- Zbukurohet me një petk bukurie dhe përsosjeje.

Allahu i madhëruar thotë:

«O bijtë e Ademit! Ne bëmë për ju veshje që të mbuloni vendet e turpshmedhetëzbukuroheni.»¹²⁴

¹²⁴ Suretu El-Araf: 26.

Kush e ruan këtë veshje në përshtatje me sheriatin për të mos e kundërshtuar atë në pamjen e jashtme, do të jetë shkak i fortë për përmirësimin e të brendshmes së tij dhe udhëzimit të zemrës së tij, prandaj Allahu pas saj thotë:

«Por petku i devotshmërisë është më i miri!»¹²⁵

D.m.th.: besimi në Allahun, frika ndaj Tij, puna e mirë etj.



E para sprovë, me të cilën Shejtani i mallkuar e sprovoi njeriun, është sprovë e Ademit -alejhi selam- dhe e gruas së tij Havasë.

Allahu i lartësuar i nderoi Ademin dhe Havanë me rrobat e Xhenetit, me zbulimet dhe bukuritë e tij, ndërsa Shejtani vajti t'i mashtrojë ata dhe t'u bëjë dredhi.

Kur ata të dy iu përgjigjën atij, iu shfaqën pjesët e turpshme dhe iu zbuluan aurretet e tyre.

Atëherë ata nxituan të këpusin gjethe nga pemët e xhenetit për të mbuluar aurretet e tyre.

Zbulimi i aurretit është çështje që në vetvete bie ndesh me natyrën e pastër të njeriut dhe bie ndesh me turpin si cilësi njerëzore, prandaj dhe sheriatit është përputhur me natyrën e pastër në këtë çështje.

Allahu i lartësuar, kur tregon për historinë e Ademit dhe Havasë me Shejtantin e mallkuar, thotë:

«Ai i mashtroi ata me dinakërinë e tij dhe pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit. Atëherë Zoti i tyre u thirri: “A nuk ju ndalova nga ajo pemë dhe ju thash se Shejtani është armiku juaj i hapët?”»¹²⁶

Çdo njeri që e mbulon aurretin e tij ecën sipas natyrës së pastër të babait të tij Ademit dhe çdo njeri që e zbulon atë mashtrohet nga dinakëria e armikut të tij Iblisit dhe kurtheve që ai i ngre.

¹²⁵ Suretu El-Araf: 26.

¹²⁶ Suretu El-Araf: 22.



Allahu i madhëruar ka urdhëruar për zbukurim për namaz dhe veshjen e rrobave mbuluese që të mos ndjekin myslimanët shembullin e jobesimtarëve, të cilët bënin tavaf të pambuluar rreth Qabes.

Allahu i madhëruar thotë:

«O bijtë e Ademit, vishni zbukurimet tuaja për në çdo xhami!»¹²⁷

Ky urdhër përfshin gjithashtu zgjedhjen e rrobës më të mirë e të pastër.



Është e pëlqyer për myslimanin kur vishet, apo mbathet të fillojë me të djathtën.

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon:

«Profeti -alejhi selam- kur vishte këmishën, fillonte me të djathtën. Nëse veshja e tij -çfarëdo qoftë ajo- ishte e re, bënte dua dhe thoshte:

Allahumme lekel hamdu, ente keseutenijhi. Es'eluke min khajrihi ue khajri ma sunia lehu, ue eudhu bike min sherrihi ue sherri ma sunia lehu!

(O Allah, ty të takon falënderimi, sepse Ti ma mundësove mua veshjen e saj. Ty ta kërkoj hajrin e saj dhe hajrin e asaj për të cilën është prodhuar dhe nga Ti kërkoj mbrojtjen prej të keqes së saj dhe të keqes së asaj për të cilën është prodhuar).»¹²⁸

Prej sunetit të profetit për atë që vesh rrobë të re është t'i thuhet:

«**Ilbes xhediden, ue ish hamiden, ue mut shehijden!** (Veshç të reja, jetofsh i lavdëruar dhe vdeksh shehid!)»¹²⁹

Shokët e profetit -alejhi selam-, kur ndonjëri prej tyre vishte një

¹²⁷ Suretu El-Araf: 31.

¹²⁸ E transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu etj

¹²⁹ E transmeton Ibn Maxhe.

rrobë të re, i thoshin: «*Ta gëzosh (e vjetërofsh) dhe ta kompensoftë Allahu me më të mirë!*»¹³⁰¹³¹

Profeti -alejhi salam- ka thënë:

«**Kush vesh një rrobë, pastaj thotë:**

El-hamdulilahi ledhi kesenij hadheth-theube ue razekaniijhi min gajri haulin minij ue la kueh, (*Falënderimi i takon Allahut që më veshi me këtë rrobë dhe më furnizoi me të pa mundim a sforcim.*¹³²)

i falen atij mëkatet e kaluara.»¹³³



Ngjyra më e mirë e rrobave për të cilën nxiste Profeti -alejhi salam- dhe e pëlqente, ishte e bardha.

Profeti -alejhi salam- ka thënë:

«**Vishni rroba të bardha, sepse ato janë rrobat më të mira!**»¹³⁴

Ngjyra e bardhë e ndihmon myslimanin në kujdesin për pastërtinë e rrobave të tij dhe në ruajtjen nga ndotja, pavarësisht nëse ndotja është shkaktuar nga lëndë të pastra, apo të pista.

Allahu i madhëruar thotë: «**Dhe rrobat e tua pastroji!**»¹³⁵



Myslmani në lidhje me rrobat e tij duhet të distancohet nga disa gjëra. Prej tyre:

- Veshjet e jobesimtarëve, mushrikëve dhe shpikjeve të tyre, në të cilat nuk kujdesen për turpin dhe nuk kanë frikë Krijuesin.

Profeti -alejhi salam- ka thënë:

¹³⁰ Kur të vjetrohet.

¹³¹ E transmeton Ebu Daudi.

¹³² Sikur të mos ishte dëshira e Allahut kjo nuk do të arrihej.

¹³³ E transmeton Ebu Daudi.

¹³⁴ E transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu etj.

¹³⁵ Suretu El-Mudethir: 4.

«**Kush i përngjan një populli, ai është prej tyre.**»¹³⁶

- Veshjet e femrave.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**I mallkoftë Allahu ata burra, të cilët i përngjajnë femrave (në zakonet e tyre)**!»¹³⁷

- Veshja e mëndafshit¹³⁸.

Profeti -alejhi selam- na ka njoftuar se:

«**Mëndafshi është i ndaluar për meshkujt e këtij ymeti dhe i lejuar për femrat.**»¹³⁹

- Veshja e gjatë poshtë nyjave të këmbës, sepse konsiderohet mendjemadhësi edhe nëse ai që e vesh nuk e ka atë qëllim.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**Ajo -pjesë e izarit¹⁴⁰- që zbret poshtë nyjave, është në zjarr.**»¹⁴¹

- Veshja që përmban foto të krijesave me shpirt -njeri qoftë ky apo kafshë-.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«**I mallkoftë Allahu ata që portretizojnë!**»¹⁴²

- Veshjet e ngushta që tregojnë përmasat e auresit, apo tregojnë ngjyrat e tyre.

Kjo sepse qëllimi i mbulimit nuk realizohet me veshje të tilla.



¹³⁶ E transmeton Ebu Daudi.

¹³⁷ E transmeton Ahmedi.

¹³⁸ Ose e floririt.

¹³⁹ E transmeton Ibn Maxhe, Nesai etj

¹⁴⁰ Rrobë që mbulon pjesën e trupit nga mesi e poshtë.

¹⁴¹ E transmeton Buhariu, Nesai etj.

¹⁴² E transmeton Buhariu, Ahmedi etj

Nëse myslimanit mashkull i kërkohet kjo veshje me këto përkthime në lidhje me mbulimin apo të mbuluarit, atëherë kjo gjë femrës myslimane i kërkohet në formë më të theksuar dhe me urdhra më të forta.

Allahu i madhëruar thotë:

«O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.»¹⁴³

Më ruajtëse për femrën myslimane -si nga ana e fesë ashtu edhe nga ana e dynjasë- është mbulimi i të gjithë trupit të saj, madje edhe fytyrën me duart¹⁴⁴.

Asaj nuk i lejohet zbulimi i ndonjë gjëje prej trupit të saj përpara burrave të huaj¹⁴⁵ ose grave jobesimtare.

Ndërsa përpara grave myslimane, aq më tepër përpara të afërmeve të saj, i lejohet të zbulojë nga trupi vetëm vendet e abdesit dhe të zbukurimit.

Po ashtu i lejohet edhe përpara burrave që quhen “*mabrem*” dhe që janë ata me të cilët nuk lejohet martesë si: babai, gjyshi, vëllai, xhaxhai dhe daja.

Lusim Allahun e madhëruar të na ndihmojë në falënderimin e mirësive të Tij dhe të na zbukurojë me petkun e devotshmërisë!



¹⁴³ Suretu El-Ahzab: 59.

¹⁴⁴ Autori do të thotë: sa më shumë të mbulohet femra aq më mirë është për të dhe jo se mbulimi i duarve dhe i fytyrës është detyrë nga Allahu i madhëruar, sepse Ai këto dy pjesë i ka lejuar të shfaqen.

¹⁴⁵ Kështu quhen të gjithë ata burra me të cilët lejohet martesë.



Vdekja

Nocioni “**Vdekje**” është e kundërta e nocionit “**Jetë**”. Atëherë, vdekja është përfundimi i jetës së çdo krijese të gjallë, cilado qoftë pozita e saj, siç thotë Allahu i madhëruar:

«Çdo i gjallë do ta shijojë vdekjen.»¹⁴⁶

Edhe i dërguari i Allahut Muhamedi -alejhi selam- vdiq dhe Allahu i madhëruar i kishte thënë atij që kur ishte gjallë:

«Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin.»¹⁴⁷

Ndërsa Zoti i botëve (*nuk vdes kurrë, por*) i mposht robtë e tij me vdekjen siç ka thënë i madhëruari:

«Çdo gjë që është mbi të (d.m.th. mbi tokë) do të zhduket. Dhe do të mbetet fytyra e Zotit tënd plot madhësi dhe nderim.»¹⁴⁸

Prandaj myslimanit gjatë jetës së tij i kërkohet të kryejë adhurimet, urdhrat dhe veprat e mira, që vdekja ta gjejë me to dhe përfundimi i tij të jetë në to.

Allahu i madhëruar thotë:

«O ju që besuat frikësojuni Allahut, ashtu siç i takon dhe mos vdisni vetëm se duke qenë myslimanë!»¹⁴⁹

¹⁴⁶ Suretu El-Ankebut: 57.

¹⁴⁷ Suretu Ez-Zumer: 30.

¹⁴⁸ Suretu Er-Rahman: 26-27.

¹⁴⁹ Suretu Ali Imran: 102.



Përkujtimi i vdekjes -d.m.th. që të mos e harrojë atë myslimani dhe as të shkujdeset ndaj saj- është çështje mjaft e rëndësishme, sepse:

- Me të arrihet kënaqja e zemrës (*mjaftimi*).
- Me të arrihet qetësia e shpirtit (*stabiliteti*).
- Dhe me të arrihet siguria e besimit.

Profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Përmendeni shpesh atë që jua prish qejfet, sepse nuk e kujton atë ndonjë që është në vështirësi, vetëm se ajo ia lehtëson atë atij dhe nuk e kujton atë njeri që është në begati vetëm se ajo e ngushton atë.»¹⁵⁰

Ai që është në vështirësi në këtë botë, nëse është nga vepërmirët, kujtohet se vdekja është afër dhe se gjerësia e xhenetit është afër dhe kështu lehtësohet.

Ndërsa ai që është në begati, nëse është nga mëkatarët apo të shtururit, kujtohet se vdekja është afër dhe se llogaria e dënimi e presin atë dhe kështu ngushtohet.



Kur njeriu vdes, nuk merr gjë nga kjo botë: as pasuri, as shtëpi, as grua, as fëmijë, as famë, dhe as pozitë, por me të do të jetë vepra e tij që ka vepruar në këtë botë, e cila sado që të zgjasë papë është e shkurtër.

Ai nëse ka vepruar mirë do shpërblehet me të mira e nëse ka vepruar keq do të shpërblehet me të këqija.

Enes bin Maliku -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

¹⁵⁰ E transmeton Taberiu.

«E ndjekin të vdekurin tri gjëra, kthehen dy dhe një mbetet me të. E ndjekin atë të afërmit, pasuria dhe vepra e tij. Të afërmit dhe pasuria kthehen, ndërsa vepra e tij mbetet.»¹⁵¹

Allahu i madhëruar thotë:

«Çfarëdo mirësie që bëni për veten tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Ajo do të jetë më e mirë dhe më e shpërblyer.»¹⁵²



Kur myslimanit t'i vijë vdekja, duhet të ketë mendim të mirë për Allahun dhe të besojë me siguri se Allahu është falës dhe mëshirues.

Profeti -alejhi salam- ka thënë:

«**Të mos vdesë ndonjëri nga ju, veçse duke menduar mirë për Allahun!**»¹⁵³

Ai gjithashtu duhet ta shtojë përmendjen e Allahut (*dhikrin*), ta falënderojë Atë (*me fjalën El-Hamdulillah*) dhe të bjerë në shehadet (*me fjalën: La ilahe ilallah*), sepse Profeti -alejhi salam- ka thënë:

«**Ai që fjalën e tij të fundit e ka “La ilahe ilallah”, hyn në xhenet.**»¹⁵⁴

Nëse pranë atij që i vjen vdekja janë të afërmit ose shokët, le t'ia kujtojnë fjalën e teuhidit dhe ta nxisin të thotë: **La ilahe ilallah.**

Profeti -alejhi salam- ka thënë:

«**Kujtojuani atyre që janë duke vdekur fjalën: La ilahe ilallah!**»¹⁵⁵



Është sunet që myslimani t'i vizitojë varret, për të kujtuar vdekjen dhe ahiretin.

¹⁵¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹⁵² Suretu El-Muzemmil: 20.

¹⁵³ E transmeton Buhariu.

¹⁵⁴ E transmeton Ebu Daudi, Ahmedi etj.

¹⁵⁵ E transmeton Muslimi.

Profeti -alejhi salam- thotë:

«Ju pata ndaluar nga vizita e varreve; tani vizitohuni, sepse ato ju kujtojnë juve ahiretin.»¹⁵⁶

Kur të vizitohet varrezën -lejohet që të ketë për qëllim vizitën e vetëm një varri të një të afërmi apo shoku-, të thotë këtë dua:

«Es-Selamu ala ehlid-dijari minel-mu'minijne uel-muslimijne. Ue jerhamullahu el-mustekdimijne mina uel-muste'khirijne. Ue inna in sha Allahu bikum lahikune. *(Paqja qoftë mbi këta banorë besimtarë dhe myslimanë! I mëshiroftë Allahu ata që kanë vdekur përpara prej nesh dhe ata që do të vdesin më vonë! Edhe ne -në dashtë Allahu- juve do t'ju pasojmë).*»¹⁵⁷

Nuk i kërkohet atij që viziton varret të lexojë Kuranin, apo ndonjë pjesë prej tij si surja Fatiha, apo surja Jasin, apo ndonjë sure tjetër, sepse këtë gjë nuk e ka bërë Profeti -alejhi salam-, ndërkohë që ai është shembulli ynë më i mirë dhe më i plotë.



Çdo njeri që vdes mund të jetë:

- Ose njeri i mirë i bindur ndaj Allahut.
- Ose larg bindjes ndaj Allahut si i shtururi dhe qafiri.

I pari, kur vdes rehatohet për shkak të mirësive dhe shpërblimit të mirë që e pret.

Ndërsa i dyti, me vdekjen e tij rehatohen të tjerët prej tij, për shkak të të këqijave që vepronte dhe për shpërblimin që do të marrë me ndëshkime dhe dënime.

Ebu Katade -radiallahu anhu- tregon se, kur pranë profetit -alejhi salam- kaloi një xhenaze, tha:

«Ai, ose do të rehatohet, ose të tjerët do të rehatohen prej tij.

¹⁵⁶ E transmeton Muslimi, Tirmidhiu etj.

¹⁵⁷ E transmeton Muslimi.

E pyetën: O i dërguar i Allahut, kush është ai që do të rehatohet dhe kush është ai që të tjerët do të rehatohen prej tij?

Ai u përgjigj: Njeriu besimtar rehatohet nga problemet e dynjasë ndërsa njeriu i shthurur rehatohen prej tij njerëzit, vendet, pemët dhe kafshët.»¹⁵⁸

Ebu Hurejra -radiallahu anhu- tregon se profeti -alejhi selam- ka thënë:

«Nxitoni me xhenazen, sepse nëse është njeri i mirë, për në mirësi do ta çoni dhe nëse është ndryshe, një të keqe nga qafat tuaja do të largoni!»¹⁵⁹



Myslimani i vërtetë, marrëdhëniet e tij me këtë botë i ndërton me maturi, në mënyrë të atillë që të mos e konsiderojë atë preokupimin e tij më të rëndësishëm dhe as fatin e tij më të madh, por e konsideron atë rrugë kalimi për në ahiret dhe portë për të hyrë te veprat e mira, sepse ai mund të vdesë papritur.

Prandaj le të shikojë se çfarë ka përgatitur për pas vdekjes dhe se çfarë ka përfutuar nga kjo botë që e preokupoi atë nga Ahireti.

Abdullah bin Umeri -radiallahu anhuma- tregon: *«Më mori profeti -alejhi selam- për supi dhe më tha: Ji në këtë botë si i huaj, ose si kalimtar!»¹⁶⁰*

Ibën Umeri -pas kësaj porosie- thoshte: *«Kur të ngrysësh mos e prit mëngjesin dhe kur të gdhish mos e prit mbrëmjen! Shfrytëzoje kohën e shëndetit para sëmundjes dhe atë të jetës para vdekjes!»*



Përkujtimi i vdekjes ka shumë dobi në këtë botë dhe në tjetrën, prej tyre janë:

¹⁵⁸ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹⁵⁹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹⁶⁰ E transmeton Buhariu.

- I jep vlerë dhe rëndësi të madhe kohës, çfarë e bën myslimanin të njohë detyrat shariatike me të cilat është ngarkuar.

- E bën myslimanin këmbëngulës në distancimin nga harami dhe largimin nga gjynahet dhe mëkatet.

- E bën myslimanin të butë e të mëshirshëm, as nuk dhunon e as tregohet arrogant.

- E bën myslimanin të ketë turp prej Zotit të tij, i Cili i bën mirë atij dhe e nderon, ndërsa ai mëkaton dhe kundërshton urdhrin e Tij!

Ku është turpi nga Allahu prej këtij lloj njeriu?!

Turpi i njeriut prej Zotit të tij të lartmadhëruar duhet ta pengojë atë nga gjynahet dhe veprat e këqija dhe ta nxisë atë për vepra të mira.

O Allah na ndihmo ne në bindjen tënde, na jep Xhenetin dhe na mundëso të vdesim me fjalën e teuhidit (*La ilahe ilallah*)!



Përmbajtja

LIBRI 1



Parathënie	3
Besimi në Allahun e Lartmadhëruar	5
Profeti Muhamed -alejhi selam-	10
Islami	16
Adhurimi	20
Engjëjt (Melaiket)	25
Kurani famëlartë	30
Të dërguarit dhe profetët	35
Dita e Fundit	41
Xheneti (Parajsa)	47
Zjarri (Xhehenemi)	52
Abdesi	58
Namazi	64

LIBRI 2



Parathënie	75
Dija (Ilmi)	77
Agjërimi i Ramazanit	86
Zekati	91
Haxhi (Vizita e Qabesë)	98
Mirënjohja e prindërve (Birri)	104
Shokët e Profetit -alejhi selam- (Sahabët)	110
Edukata	116
Xhamia (Mesxhidi)	121
Lutja (Duaja)	126
Veshja	135
Vdekja	141

NJOHURI ISLAME

PËR TË RINJTË MYSLIMANË



 **Udha e
BESIMTARËVE**

| 32

www.udhaebesimtareve.com